

EKONOMI DHE FINANCA

# PERSPEKTIVA E PËRGJITHSHME: AGJENDA EKONOMIKE PROGRESIVE PËR KOSOVËN

**Edison Jakurti, Dita Dobranja, Dina Vllasaliu,  
Lule Bahtiri, Mimosë Veliu**

Dhjetor 2021



Inkorporimi i masave për të siguruar një shoqëri të drejtë përmes mekanizmave mbrojtës për grupet e cenueshme, meqë këto të fundit tentojnë të ikin nga rreziku i varfërisë dhe të shfrytëzojnë mundësitë.



Përdorimi i një formule matematikore dinamike për përcaktimin e pagës minimale bazuar në pagat tjera në ekonomi, inflacion dhe shkallën e rritjes ekonomike.



Hartimi i një politike të re për industrinë e cila i merr parasysh faktorët siç është Përparësia Krahasuese e Zbuluar dhe produktiviteti



PERSPEKTIVA E  
PËRGJITHSHME:  
AGJENDA EKONOMIKE  
PROGRESIVE  
PËR KOSOVËN

Botuesi: Friedrich-Ebert-Stiftung Kosovo, Rr. Pashko Vasa 23,  
10000 Prishtina, Republic of Kosovo

Përgjegjës: Renè Schlee

Koordinatorë e projektit: Rudina Nallbani Hoxha

Autoret: Edison Jakurti, Dita Dobranja, Dina Vllasaliu, Lule Bahtiri, Mimozë Veliu

Rishikues: Besnik Pula

Data: 2022

Dizajni: Milky Way Creative

Printimi: Studio Forma

Autorët e seksioneve individuale marrin përgjegjësinë e plotë për përmbajtjen e botimit.  
Mendimet e shprehura nuk janë domosdoshmërisht ato të Friedrich Ebert Stiftung.

# PËRMBAJTJE

Parathënie .....	7
Përmbledhje ekzekutive .....	9
<b>PJESA I. ANALIZA E TREGUT TË PUNËS DHE POLITIKAT</b>	
<b>KAPITULLI 1. ANALIZA E TREGUT TË PUNËS</b>	
Dita Dobranja .....	11
<b>KAPITULLI 2. NJË MËNYRË E RE PËR PËRCAKTIMIN E PAGËS MINIMALE NË KOSOVË</b>	
Dita Dobranja & Edison Jakurti .....	24
<b>PJESA II: MBROJTJA SOCIALE DHE POLITIKAT FISKALE</b>	
<b>KAPITULLI 3. ASISTENCA SOCIALE DHE PËRFITIMET NGA PAPUNËSIA</b>	
Dina Vllasaliu .....	32
<b>KAPITULLI 4. PABARAZIA NË TË ARDHURA DHE POLITIKAT FISKALE</b>	
Edison Jakurti .....	42
<b>PJESA III: STRUKTURA EKONOMIKE DHE POLITIKAT INDUSTRIALE</b>	
<b>KAPITULLI 5. BPV DHE PASQYRA E STRUKTURËS SË BILANCIT TREGTAR</b>	
Lule Bahtiri .....	56
<b>KAPITULLI 6. FILLET E NJË POLITIKE TË RE INDUSTRIALE</b>	
Edison Jakurti .....	62
<b>PJESA IV: TRANZICIONI I DREJTË ENERGJETIK</b>	
<b>KAPITULLI 7. TRANZICIONI I DREJTË ENERGJETIK</b>	
Mimozë Veliu & Dina Vllasaliu .....	72



# PARATHËNIE

“Vështirësia nuk qëndron aq shumë në zhvillimin e ideve të reja, por në largimin nga të vjetrat”  
– **John Maynard Keynes**

Pandemia me Covid-19 e ekspozoi brishtësinë e ekonomisë së varur kryesisht nga konsumi, eksporti i shërbimeve dhe remitancat nga diaspora. Kosova, si shumë vende të tjera në zhvillim, duhet të mbështetet në ndihmën e huaj dhe borxhin (ndërhyrjet në politika fiskale) si një mënyrë për të financuar kërkesat urgjente.

Ndonëse disa nga pasojat ekonomike janë korigjuar në vitin 2021 – duke theksuar sërish ndikimin e faktorëve të jashtëm – nevoja për reforma strukturore dhe politika inovative duhet të mbetet një pikë qendrore në agjendën zhvillimore të Kosovës. Shtrohet pyetja “Çfarë duhet të bëhet?”

Për këtë qëllim, Zyra e Friedrich-Ebert Stiftung (FES) në Kosovë, ka kërkuar nga një panel ekspertësh që të përgatitin “Perspektivën e Përgjithshme” për një agjendë ekonomike progresive që do të ofrojë një perspektivë social-demokratike për zhvillimin e ardhshëm ekonomik të Kosovës. Këto propozime të ekspertëve tanë janë të qarta, si në aspektin e meritave shkencore, ashtu edhe në busullën e tyre normative: Të çojnë në një shoqëri më të drejtë duke avancuar politika nga të cilat përfitojnë shumica e qytetarëve kosovarë.

**Si të ngushtohet hendeku mes tregut të punës dhe arsimit? Si të gjenerohen të ardhura të qëndrueshme për një shtet të mirëqenies sociale? Cilat janë industritë me potencialin më të madh eksportues? Si të kalojmë nga prodhimi i energjisë së varur nga karboni në atë të pastër?**

Studimi i Perspektivës së Përgjithshme i ofron përgjigjet në pyetjet kryesore dhe ofron propozime të rëndësishme nga ekspertët në lidhje me pagën minimale, kalimin në skemat e politikave sociale dhe indeksin e përparësive krahasuese. Studimi fokusohet në ofrimin e rekomandimeve specifike për fushat vitale të ekonomisë së Kosovës, siç janë politikat e tregut të punës, mbrojtja sociale dhe politikat fiskale, tregtia ndërkombëtare dhe politikat industriale duke përfshirë sigurinë energjetike dhe ekonominë e gjelbër.

Rezultatet dhe propozimet e politikave në këtë studim janë interesante, stimuluese, e në të një-

jtën kohë sfiduese për politikëbërësit, pasi ato kontribuojnë në zgjerimin e debatit për politika efektive socio-ekonomike.

Ekonomia e vogël dhe e hapur e Kosovës ndikohet shumë nga kushtet dhe paqëndrueshmëria në tregjet kryesore dhe ato ndërkombëtare. Efektet e përhapura të krizave të ndryshme e bëjnë të vështirë për ekonominë e vogla gjetjen e një hapësire manovrimi për të reduktuar pasojat e pengesave ekonomike. Megjithatë, një vend duhet të përfshihet në një kombinim të politikave të reformës makro dhe strukturore, të cilat mundësojnë transformimin ekonomik në afat të gjatë. Politikatat përkatëse janë veçanërisht të rëndësishme në sektorin e energjisë, pasi varësia aktuale e Kosovës nga thëngjilli e bën të ndërlikuar zëvendësimin me burime të ripërtrishme të energjisë në një afat të shkurtër. Dekarbonizimi dhe energjia e pastër nuk janë thjesht detyrime që rrjedhin nga procesi i integritimit evropian, por janë të peshës që gjeneratat tona mbajnë për mbrojtjen e mjedisit dhe ndryshimin e tendencave të ndotjes së ajrit. Duhet theksuar se një faktor vendimtar në zbatimin e politikave progresive ekonomike është një mjedis politik i qëndrueshëm dhe i vullnetshëm.

Qëllimi i “Perspektivës së Përgjithshme” është të prodhojë rekomandime specifike të politikave të orientuara kah sektoret për të lehtësuar debatin publik dhe politikëbërjen demokratike mbi orientimin e duhur se si të rindërtohet më mirë pas pandemisë. Shijojeni leximin!

**Rudina Nallbani Hoxha**  
Friedrich Ebert Stiftung





# PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ekonomia e Kosovës përballlet me shumë sfida, por me qeverinë e re, shihen edhe shumë mundësi. Fitorja e paparë me një mbështetje dërrmuese me mbi 50% ia mundëson qeverisë aktuale të nisë projekte të guximshme, që jo vetëm synojnë të reformojnë, por më tepër të transformojnë ekonominë. Orientimi i saj social-demokratik i shpallur, hap rrugën për përparimin e politikave progresive. Duke pasur parasysh këtë, ne kemi synuar të japim një pasqyrë të gjerë të ekonomisë së Kosovës duke trajtuar disa nga çështjet kryesore të saj dhe duke u përpjekur të ofrojmë politika progresive që rrjedhin nga analizat rigorozë ekonomike.

Së pari analizojmë disa çështje të mëdha në tregun e punës, duke përfshirë shkallën e lartë të papunësisë, shkallën e ulët të pjesëmarrjes në fuqinë punëtore, të rinjtë joaktivë dhe gratë e diskriminuara. Më tej, ne e kuptojmë se jo vetëm që ka probleme me të papunët, por ka shumë edhe për punëtorët e punësuar. Prandaj, ne bëjmë tre propozime të politikave. Për të ngushtuar zbrastirën e aftësive, si një shkak i identifikuar për papunësinë e lartë sidomos tek të rinjtë, ne propozojmë hapa specifikë për krijimin e një sistemi dual të Arsimit dhe Aftësisimit Profesional (AAP), i cili karakterizohet me një ndarje prej 60-70% arsim dhe 30-40% trajnim në punë për nxënësit. Për të përmirësuar kushtet e punëtorëve, ne sugjerojmë mbështetjen e fuqishme dhe ndërmjetësimin aktiv të sindikatave të reja, veçanërisht në sektorin privat. Një mënyrë për ta arritur këtë është duke i kushtëzuar përfitimet nga qeveria për sektorin privat me kushtet e punës dhe nivelin e organizimit të punëtorëve. Së fundi, pasi kemi treguar se rritja e pagës minimale në Kosovë nuk ka gjasa të ketë efekte negative në papunësi, ne ofrojmë një formulë dinamike, matematikore për përcaktimin e pagës minimale në Kosovë. Formula jonë i merr parasysh pagat e tjera në ekonomi, inflacionin dhe shkallën vjetore të rritjes.

Një zinxhir është po aq i fortë sa edhe hallka e tij më e dobët. Prandaj, ne fokusohemi në mbrojtjen sociale me synimin për të reduktuar varfërinë dhe pabarazinë. Ne analizojmë skemën aktuale të asistencës sociale në Kosovë, shfaqim pikat e saj më të dobëta dhe propozojmë mënyra për ta përmirësuar atë, duke përfshirë një ndryshim në shumën e ndarë, një rritje të shkallës së mbulimit dhe një transferim të "pronësisë" së asistencës nga meshkujt tek femrat. Në vend që ajo të jetë një strehë e përhershme, ne përiqemi ta bëjmë atë një stacion të përkohshëm që mund të lidhet me anët më të begatshme të ekonomisë. Për të mos rënë në rrezikun e varfërisë, ne propozojmë krijimin e një fondi të solidaritetit dhe vendosjen e përfitimeve të papunësisë për të ndihmuar punëtorët në ditët e tyre më të vështira.

Më pas, ne ofrojmë analizën e parë të zhvilluar ndonjëherë të pabarazisë dhe shpërndarjes së të ardhurave nga puna në Kosovë. Njëkohësisht, vlerësojmë tatimin aktual mbi të ardhurat personale, shkallën e progresivitetit dhe fuqinë e tij rishpërndarëse. Për shkak se shkalla e progresivitetit dhe fuqia e rishpërndarjes janë të ulëta, ne propozojmë një taksë të re mbi të ardhurat personale, e cila është rreth tre herë më progresive, rishpërndarëse dhe efektive në reduktimin e pabarazisë. Ne e bëjmë këtë duke hequr plotësisht barrën tatimore nga 50% e "më të varfërve" dhe duke rritur barrën për 8% të "më të pasurve". Sistemi ynë ka një normë më të lartë marzhinale prej 38%, dhe megjithatë ai mundëson që 92% e pagafituesve të marrin një pagë neto më të lartë se sa marrin aktualisht – ndërsa qeverisë i mundëson të gjenerojë më shumë të ardhura sesa aktualisht. Së bashku me këtë taksë, ne propozojmë një rritje prej 100% të tatimit mbi të ardhurat e korporatave – nga 10% në 20%; dhe, vendosjen e taksës së dividendës prej 30% – e cila aktualisht mungon në Kosovë, por është e pranishme pothuajse në të gjitha vendet e Evropës.

Më pas i drejtohem aspektëve makroekonomike të ekonomisë së Kosovës duke e zbërthyer Bruto Produktin Vendor (BPV). Ne analizojmë faktorët që ndihmojnë në rritjen e ekonomisë dhe në ngecjen e saj dhe identifikojmë deficitin tregtar si një çështje kryesore. Për të adresuar këtë, ne propozojmë fillimin e një politike të re industriale që bazohet në analiza ekonomike, dhe jo në disa masa ad hoc që janë të pa fokusuara dhe joefektive. Prandaj, për herë të parë vlerësojmë përparësinë krahasuese të zbuluar për eksportet e Kosovës. Më pas, ne analizojmë produktivitetin e sektorëve të ndryshëm për të përcaktuar industritë që mund të përparojnë dhe modelet që mund të informojnë politikat e mëtejshme në lidhje me potencialet industriale të vendit.

E fundit, por gjithashtu e rëndësishme, ne e kuptojmë që pandemia me COVID-19 ka kushtuar me humbjen e shumë jetëve dhe ka shkaktuar çrregullime të shumta. Njerëzimi po përballlet me një krizë edhe më ekzistenciale - krizën klimatike. Për këtë, çdo shtet duhet të bëjë pjesën e vet dhe Kosova të marrë pjesën e saj të përgjegjësive. Prandaj, ne analizojmë tranzicionin energjetik me synimin për të vlerësuar kushtet aktuale, duke mësuar nga praktikat më të mira dhe duke propozuar hapa të mëdhenj për një dekarbonizim të drejtë për punëtorët, në veçanti dhe për shoqërinë në përgjithësi.

**Edison Jakurti**

Kandidat për doktoraturë në ekonomi  
Universiteti i Leipzigit  
Gjermani



# PJESA I. ANALIZA E TREGUT TË PUNËS DHE POLITIKAT

## KAPITULLI 1. ANALIZA E TREGUT TË PUNËS

Dita Dobranja

### 1. HYRJE

Ky kapitull ofron një analizë të përgjithshme të tregut të punës në Kosovë, me fokus të veçantë tek të rinjtë dhe gratë, si grupe që përballen me kushtet më të vështira në tregun e punës. Pjesa e parë synon të ofrojë një pasqyrë të përgjithshme të tendencave kryesore të tregut të punës, përmes prizmës së treguesve më problematikë si- papunësia dhe përqindjet e pjesëmarrjes në tregun e punës. Duke u ndalur te të rinjtë, veçanërisht të rinjtë që aktualisht nuk janë në arsim, punësim apo trajnim, këta sektorë tregojnë nevojën për një ndërhyrje me qëllim të adresimit të një sfide në rritje, e që është aktivizimi i të rinjve në tregun e punës. Në anën tjetër, pjesëmarrja e ulët e grave në fuqinë punëtore, që rrjedh nga kufizimet e shumta socio-ekonomike, kulturore dhe legjislativë, është elaboruar gjithashtu në nevojën për një qasje shumëdimensionale për zgjidhjen e problemeve të tregut të punës në Kosovë.

Pjesët e mëposhtme fokusohen në analizën sektoriale të fuqisë punëtore, duke treguar përqendrimin e fuqisë punëtore në sektorë më pak produktivë, ndërsa sektorët më produktivë pretendojnë se përballen me mungesë të fuqisë punëtore të kualifikuar. Gjithashtu, ofrohet një analizë e mangësive të aftësive, si një nga shkaqet kryesore të stagnimit aktual të punësimit dhe zhvillimit të tregut të punës.

Së fundi, dy pjesët e fundit të kapitullit ofrojnë rekomandime të politikave për zhvillimin e arsimit profesional dhe për fuqizimin e sindikatave. Krijimi i sistemit dual të arsimit dhe aftësimit profesional (AFP) dhe krijimi i këshillave të aftësive sektoriale mund të përmirësojë mospërshtatjet aktuale në tregun e punës dhe mungesën e bashkëpunimit ndërmjet sektorit privat dhe atij publik për adresimin e këtyre mangësive.


Përmirësimi i kushteve për sindikalizimin e fuqisë punëtore, veçanërisht në nivel sektorial, përmes angazhimit të kushtëzuar dhe të drejtpërdrejtë të sindikatave në modalitete të ndryshme, si përfshirja e organizatave të punëtorëve, si mundësi për investime dhe si kriterë të pranueshmërisë për programet stimuluese të qeverisë.

## 2. TRENDET E PAPUNËSISË

Treguesi më shqetësues i tregut të punës në Kosovë është shkalla e papunësisë, e cila nuk ka shënuar përmirësime të dukshme, veçanërisht kur nuk korrespondon me nivelet e rritjes ekonomike të regjistruar ndër vite. Rritja e shpejtë ekonomike që e shënoi Kosova në fillim të viteve 2000 është përshpejtuar në masë të konsiderueshme nga ndihma ndërkombëtare (duke përfshirë shpenzimet dhe të ardhurat e pranisë ndërkombëtare në Kosovë), si dhe dërgimi i qëndrueshëm i remitancave, të cilat llogariten të

jenë më shumë se 10 % e BPV që nga vitet 2000.<sup>1</sup> Kjo e fundit konsiderohet të ketë pasur ndikimin më të madh në rezultatet e tregut të punës në Kosovë.

Nivelet e përgjithshme të papunësisë kanë qëndruar vazhdimisht mbi 25%, edhe në periudha të rritjes ekonomike. Nivelet e papunësisë janë dukshëm më të larta për të rinjtë (vazhdimisht rreth 50%) dhe për gratë (vazhdimisht mbi 32%).<sup>2</sup> Trendet e papunësisë në pesë vitet e fundit për të rinjtë dhe gratë janë dhënë në figurën e mëposhtme.



Studimet nga vendet në zhvillim tregojnë se prurjet e larta dhe veçanërisht të qëndrueshme të remitancave ndikojnë negativisht për pjesëmarrje në fuqinë punëtore, veçanërisht për gratë.<sup>3</sup> Duke i konsideruar remitancat si transfertat të drejtpërdrejta dhe të thjeshta të të ardhurave, familjet që marrin remitanca (dhe presin të vazhdojnë të marrin remitanca) kanë më shumë gjasa t'i zëvendësojnë të ardhurat nga remitancat me të ardhurat e pafituara nga tregu i punës, duke rritur kështu kohën e lirë dhe duke reduktuar pjesëmarrjen aktive në tregun e punës.

Për më tepër, analizat empirike nga Kosova, tregojnë se nivelet më të larta të të ardhurave nga remitancat, siç edhe pritej, e rrisin pagën e rezervuar të anëtarëve të familjes, duke ndikuar negativisht në mundësinë e punësimit.<sup>4</sup>

Megjithatë, nivelet më të larta të remitancave lidhen gjithashtu me rritjen e investimeve në kapitalin njerëzor, veçanërisht në shëndetësi dhe arsim.<sup>5</sup> Teorikisht, investimi në kapitalin njerëzor pritet të rrisë pjesëmarrjen në fuqinë punëtore. Mirëpo Azizi, duke studiuar ndikimin e remitancave në vendet në zhvillim, përfshirë Kosovën, konstaton se pavarësisht ndikimit pozitiv që kanë remitancat në investimet në kapitalin njerëzor, ai kompensohet nga rritja e pagës së rezervuar, e rrjedhimisht edhe gatishmëria për të marrë pjesë në fuqinë punëtore, sidomos për femrat.<sup>6</sup> Kjo gjetje është e rëndësishme veçanërisht në ekonominë si ajo e Kosovës, duke pasur parasysh bazën e ulët të pjesëmarrjes së grave në fuqinë punëtore.

<sup>1</sup> Banka Qendrore e Kosovës, Remitancat sipas kanalit, 2021.

<sup>2</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës, Hulumtimi i Tregut të Punës, 2016-2021

<sup>3</sup> Valerie Kozel and Harold Alderman, Factors Determining Work Participation and Labor Supply Decisions in Pakistan's Urban Areas, The Pakistan Development Review, 1990, vol. 29, issue 1, 1-18

<sup>4</sup> Jeta Rudi, Remittances and Labour Supply: The Case of Kosovo, 2014, Working Paper

<sup>5</sup> Seyed Soroosh Azizi, The impacts of workers' remittances on human capital and labour supply in developing countries, 2018, Economic Modelling, 75 (2018) 377-396

<sup>6</sup> SeyedSoroosh Azizi, The impacts of workers' remittances on human capital and labour supply in developing countries, 2018, Economic Modelling, 75 (2018) 377-396

## 2.1. PAPUNËSIA E TË RINJVE DHE NAPT-JA


Ndonëse të rinjtë në Kosovë përbëjnë numrin më të madh të popullsisë, ata përbëjnë numrin më të vogël të të punësuarve. Mungesa e vendeve të lira të punës së bashku me mospërshtatjen e shkathtësive mes të arsimit dhe nevojave të tregut të punës, i lë të rinjtë kosovarë në udhëkryq sa i përket aktiviteteve të tyre në tregun e punës. Për të rinjtë prej 15-24 vjeç, vetëm rreth një e katërta janë aktivë në tregun e punës (22.5%, dhe vetëm 15.3% për gratë) dhe rreth 50% janë të papunë (65.4% për gratë).

Një problem edhe më shqetësues është pjesa e madhe e të rinjve që aktualisht nuk janë në arsim, punësim ose trajnim (NAPT), rreth 35% e të gjithë të rinjve të moshës 15-24 vjeç.<sup>7</sup> Një e treta e të rinjve nuk janë aktivë në tregun e punës, implikimet e çfarëdo lloj aktiviteti të ndërtimit të aftësive shtrihen përtej

rezultateve aktuale të tregut të punës. Bazuar në nivelin e lartë të mospërshtatjes së aftësive që vërehet në tregun e punës në Kosovë, mungesa e përfshirjes në ndonjë program për ndërtimin e aftësive do të bëjë që hendeku që duhet adresuar të rritet edhe më shumë në të ardhmen.

Të dhënat nga anketa për fuqinë punëtore tregojnë se shkalla e papunësisë është më e lartë për ata që nuk kanë arsim të përfunduar, të ndjekur nga ata që kanë përfunduar vetëm arsimin fillor, siç e tregon edhe figura. Megjithatë, për ata me arsim profesional, niveli i papunësisë qëndron në nivele të ngjashme me papunësinë për mbarë Kosovën, në 26.5%. Nivelet më të ulëta të papunësisë janë regjistruar për personat që kanë përfunduar nivelin terciar të arsimit.

Figura 2. Shkalla e papunësisë sipas niveleve të arsimit



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2021


<sup>7</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës, Hulumtimi i Tregut të Punës, 2016-2021

### 3. PUNËSIMI DHE SHKALLA E PJESËMARRJES NË FUQINË PUNËTORE

Rritja ekonomike e Kosovës në dy dekadat e fundit, duke filluar nga rindërtimi në fillim të viteve 2000 deri tek zhvillimi ekonomik më i nuancuar, përmes bashkëpunimit ndërkombëtar dhe respektimit të standardeve të BE-së në vitet 2010, nuk është përkthyer në një përmirësim të barabartë të kushteve të tregut të punës. Pavarësisht rritjes nëpër sektorë, në Kosovë shkalla e punësimit ka mbetur e ulët, me më pak se 1/3 e popullsisë në moshë pune, të punësuar gjatë 5 viteve të fundit.

Shkalla e ulët e punësimit, e kombinuar me një nivel të lartë të pasivitetit në mesin e popullsisë në moshë pune, tregon qartazi për nevojën e transformimit të tregut të punës në Kosovë. Aktualisht, vetëm 38.3% e popullsisë në moshë pune janë aktivë në kuadër të fuqisë punëtore. Kjo shifër është jashtëzakonisht më e ulët për gratë, me vetëm 20.8%.<sup>8</sup> Dallimet gjinore në tregun e punës kanë pasoja të konsiderueshme në orientimin e përgjithshëm të ekonomisë së Kosovës dhe veçanërisht në shfrytëzimin e potencialit për rritje gjithëpërfshirëse.

Figura 3. Pjesëmarrja e fuqisë punëtore dhe trendet e shkallës së punësimit në Kosovë



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2020

Pandemia me COVID-19, e gjeti Kosovën në një trend të përmirësimit ekonomik, megjithatë, nivelet e papunësisë vazhduan të jenë të larta, veçanërisht tek të rinjtë dhe gratë. Rënia e qëndrueshme e shkallës së papunësisë, edhe pse jo shumë domethënëse, u ndryshua nga pandemia. Shkalla e përgjithshme e papunësisë në vitin 2019 ishte 25.7%, duke u rritur në rreth 27% në tremujorin e dytë të vitit 2020, por duke u ulur përsëri në 25.9% deri në fund të vitit 2020.

Sektorët specifikë pësuan humbje më të mëdha, duke pasur parasysh ndikimin e ndryshëm që pati pandemia si dhe masat kufizuese në këta sektorë. Megjithatë, në gjysmën e dytë të vitit 2020 dhe në fillim të vitit 2021, indikatorët e tregut të punës për gratë dhe të rinjtë kanë shënuar përmirësime të ndjeshme, si në nivelet e aktivitetit, ashtu edhe në aspektin e punësimit.

Tabela 1. Treguesit kryesor nga tregu i punës

	2016	2017	2018	2019	2020
Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore	38.7%	42.8%	40.9%	40.5%	38.3%
Shkalla punësim-popullësi (shkalla e punësimit)	28.0%	29.8%	28.8%	30.1%	28.4%
Shkalla e papunësisë	27.5%	30.5%	29.6%	25.7%	25.9%
Shkalla e papunësisë e të rinjve (15-24 vjeç)	52.4%	52.7%	55.4%	49.4%	49.1%
Shkalla NAPT te të rinjtë (15-24 vjeç)	30.1%	27.4%	30.1%	32.7%	33.6%
Shkalla e punësimit të paqëndrueshëm ndaj punësimit të përgjithshëm	22.9%	23.1%	19.6%	18.8%	17.0%

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2021

<sup>8</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës, Hulumtimi i Tregut të Punës, 2016-2020


### 3.1. ANALIZA SEKTORIALE E PUNËSIMIT

Sektorët ekonomikë në të cilët është i përqendruar punësimi tregojnë një aspekt tjetër të rëndësishëm të tregut të punës në Kosovë. Tregtia me shumicë dhe pakicë kanë qenë vazhdimisht punëdhënësi më i madh si sektor, duke punësuar aktualisht rreth 17% të të gjithë të punësuarve. Në vitin 2020, për herë të parë që nga viti 2017, prodhimi ia ka kaluar ndërtimtarisë, si punëdhënësi i dytë më i madh, duke punësuar 12% të atyre që aktualisht janë të punësuar. Ndërtimtaria punëson 11%, pasuar nga arsimi me 10% dhe administrata publike me 7%. Për sa i përket kontributit në Bruto Prodhimin Vendor (BPV), megjithatë, ka mospërputhje ndërmjet peshës së punësimit dhe peshës së kontributit të BPV-së për shumicën e këtyre sektorëve.

Siç është paraqitur Figurën 4, prodhimi dhe bujqësia kanë një kontribut dukshëm më të lartë në BPV-në vjetore të Kosovës, krahasuar me pjesën e tyre të punësimit. Kontributi i arsimit në mirëqenien e shoqërisë është më i madh se kontributi i tij në BPV, prandaj mospërputhja midis pjesës së punësimit dhe masave tradicionale të kontribuimit në ekonomi nuk është një befasi.

Mirëpo, industria e akomodimit dhe e shërbimeve ushqimore, si një nga sektorët me qarkullimin më të madh të fuqisë punëtore dhe me një diferencë ndërmjet punësimit (6%) dhe kontributit në BPV (2%), është një sektor i rëndësishëm për t'u shqyrtuar për sa i përket gjasave për informalitet.

Figura 4. Sektorët ekonomikë sipas shkallës së punësimit dhe kontributit në BPV



Duke pasur parasysh ndikimin e pandemisë me COVID-19, të dhënat e Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) tregojnë se, përderisa ka pasur shkurtime të punësimit në përgjithësi, në sektorët që punësojnë numrin më të madh të njerëzve kjo ka qenë më e evidente. Tre sektorët që punësojnë numrin më të madh të punëtorëve si, tregtia me shumicë dhe pakicë, prodhimi dhe ndërtimtaria kanë pësuar rënien më të ndjeshme të të punësuarve midis marsit

2019 dhe marsit 2020, ku niveli i të punësuarve në tregtinë me shumicë dhe pakicë ka rënë për 45% , prodhim 36% dhe ndërtim për 50%.<sup>9</sup> Këto shifra janë përmirësuar në tremujorët në vijim, megjithatë, masat e mbylljes kanë treguar një nivel të lartë të paqëndrueshmërisë së punësimit në këta sektorë, një vëzhgim ky shqetësues që ka implikime për zhvillimin e politikave dhe prioritizimin e sektorit.

<sup>9</sup> Kosovo Tax Administration, Employment Data, April 2020

### 3.2. MUNGESA E SHKATHTËSIVE

Një nga gjetjet kryesore të analizës së vazhdueshme për tregun e punës në Kosovë mbetet mospërshtatja e shkathtësive me tregun e punës. Sipas anketës STEP të Bankës Botërore 2019, mospërshtatja e shkathtësive është e përhapur në Kosovë, veçanërisht për firmat që kanë zbatuar qasje inovative dhe të përmirësuar ndaj shërbimeve, prodhimit ose çfarëdo forme të ofrimit të aktiviteteve.<sup>10</sup> Edhe pse prodhimi dhe ndërtimi janë dy nga tre sektorët më të mëdhenj të punësimit, këta sektorë pretendojnë gjithashtu se po përballen me vështirësitë më të mëdha në gjetjen e punëtorëve që janë të aftësuar në mënyrë adekuate për nevojat e tyre.<sup>11</sup> Sipas këtij studimi të UNDP-së, shumica e firmave (65%) përfundojnë duke punësuar staf më pak të kualifikuar, ndërsa të tjerat (19%) u caktojnë detyra stafit ekzistues.

Për më tepër, bazuar në të dhënat e Agjencisë së Punësimit në Kosovë, vendet e lira të punës të plotësuar përmes programit të papunësisë të drejtuar nga Agjencia kanë qenë mesatarisht 30% në pesë vitet e fundit, krahasuar me nivelin më të lartë të vendeve të lira të plotësuar në vitin 2019, me 44%.<sup>12</sup> Niveli i lartë i vendeve të lira të punës që mbeten të paplotësuar është një tregues i rëndësishëm për një mospërshtatje me tregun e punës.

Mospërshtatja në shkathtësi buron nga mungesa e një analize thelbësore të nevojave të tregut të punës në Kosovë dhe mungesa e strategjive dhe planeve të qarta të veprimit për të sendërtuar rrugën për rezultatet e tregut të punës në ardhmen, në Kosovë. Neglizhenca e vazhdueshme e shkathtësive dhe e parashikimit të vendeve të punës, e kombinuar me mungesën e reformave në sektorin e arsimit, e kanë dëmtuar rëndë tregun e punës në Kosovë. Në mungesë të një vizioni të qartë të nevojave të ardhshme të tregut të punës, institucionet arsimore në Kosovë vazhdojnë të ofrojnë përqendrim dhe specializime në fusha të cilat janë gjithnjë e më pak të nevojshme për punëdhënësit, jo vetëm në Kosovë, por edhe globalisht.

Një përpjekje për të kapërcyer zbrazëtirën e shkathtësive ka ardhur në formën e arsimit dhe aftësimit profesional. Megjithatë, futja e një niveli tjetër të arsimit nuk kishte adresuar nevojat e tregut të punës. Bazuar në të dhënat e nxënësve me diplomë të arsimit profesional, një e treta (33%) janë specializuar në ekonomi, rreth 17% në mjekësi dhe më pak se 10% kanë kryer arsimin profesional në shkollat teknike.<sup>13</sup>

Efekti i mbipopullimit në shkencat sociale, i cili është i përhapur në arsimin terciar është gjithashtu i zakonshëm edhe në arsimin profesional. Përveç një tendence të përgjithshme që shkencat sociale të dominojnë sistemin arsimor, fakti që shkollat profesionale dhe qendrat e kompetencës i janë nënshtruar pak ose aspak reformave që nga krijimi i tyre, ka ndikuar në zgjedhjet e karrierës së të rinjve. Aktualisht në Kosovë funksionojnë 60 shkolla profesionale dhe 4 qendra të kompetencës, të cilat ofrojnë 33 standarde profesionale, 140 profile dhe 60 kualifikime modulare.<sup>14</sup> Kompanitë e sektorit privat, veçanërisht ato që operojnë në industrinë e prodhimit i kushtojnë rëndësi arsimit profesional.

### 3.3. POZITA E GRAVE NË TREGUN E PUNËS

Zvoglimi i pabarazive ekonomike shtrihet përtej tejkalimit të hendekut midis ndarjes së të ardhurave rurale e urbane, duke tejkaluar kështu dallimet në rezultatet ekonomike që varen nga niveli i arsimit. Në tregun e punës në Kosovë, një nga zbrazëtirat më të mëdha është ajo e aspektit gjinor. Pjesëmarrja e grave në fuqinë punëtore është më e ulëta në rajonin e Ballkanit Perëndimor, me vetëm 20.8%, krahasuar me 56% për burrat.

Sipas një studimi të vitit 2018 nga Instituti Riinvest, më shumë se gjysma e grave e përmendin pamundësinë për të gjetur një punë të përshtatshme, pastaj mungesën e punës së përshtatshme dhe kualifikimet e tyre joadekuate, si një nga arsyt kryesore për të mbetur të papuna/joaktive.<sup>15</sup> Mirëpo, 1 në 4 gra deklarohen se obligimet e përkujdesit, si përkujdesja ndaj fëmijëve, të moshuarëve, si dhe punët e shtëpisë, janë arsyt kryesore që ato të mos punojnë.<sup>16</sup>

Ngjashëm, pamundësia për të gjetur një punë të përshtatshme (me orar të plotë) si dhe arsyt personale dhe familjare janë po ashtu arsyt kryesore të deklaruara nga gratë të cilat aktualisht punojnë me orar jo të plotë.<sup>17</sup> Vërehet që edhe pse remitancat ndikojnë në vendimet e përgjithshme për të hyrë në tregun e punës, studimet empirike nuk tregojnë për asnjë ndikim të remitancave për sa i përket numrit të orëve të punës së kryer. Kjo mund të jetë rezultat i mungesës së punësimit me orar të pjesshëm në Kosovë, ku vetëm 7% e të punësuarve punojnë më pak se 40 orë në javë.

<sup>10</sup> World Bank, Kosovo country report: Findings from the Skills towards Employment and Productivity Survey, World Bank, Washington, DC, 2019.

<sup>11</sup> UNDP Kosovo, Public pulse analysis: Correlation between labour market of Kosovo and outmigration, 2020

<sup>12</sup> Employment Agency of the Republic of Kosovo: Work and labour, 2019

<sup>13</sup> LMIS data on supply and demand in the labour market: <http://sitp.rks-gov.net>

<sup>14</sup> Kosovo National Qualifications Authority, Accessed October 2020,

<sup>15</sup> <https://akkks.rks-gov.net/en/nqa/about-us>

Riinvest Institute, Facilitating Empowerment: Factors Influencing Women's Economic Decisions in Kosovo, 2018


<sup>16</sup> Ibid.

<sup>17</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës, Hulumtimi i Tregut të Punës, 2016-2021




Dallimet e theksuara në pjesëmarrjen e fuqisë punëtore, të cilat shfaqen grafikisht në Figurën 6, të kombinuara me pritshmëritë shoqërore që gratë të përmbushin pjesën më të madhe të detyrimeve të kujdesit, ndikojnë në vendimet me të cilat përbalLEN

gratë në lidhje me aktivitetin e tyre në tregun e punës. Këto shifra tregojnë nevojën për një mbështetje institucionale për gratë, përmes alternativave të kujdesit ndaj fëmijëve, si dhe ndërhyrje për të mbështetur skemat e ndërtimit të aftësive me synim grupet e marginalizuara, e veçanërisht gratë.



Pjesëmarrja në fuqinë punëtore arrin kulmin për gratë e grupmoshës 25-29 vjeç, duke rënë në mënyrë të vazhdueshme me moshën e tyre, siç tregohet në Figurën 6. Për burrat, pjesëmarrja në fuqinë punëtore rritet në mënyrë të qëndrueshme deri në grupmoshën 45-49 vjeç, ku arrin kulmin, që është dyfishi i nivelit

të kulmit për gratë. Kjo thekson më tej problemet për rolin e grave në tregun e punës, duke pasur parasysh se pjesëmarrja e tyre në fuqinë punëtore e arrin kulmin e vetëm në dy vitet e para pas diplomimit universitar dhe vetëm dhjetë vjet pas përmbushjes së kriterëve për të hyrë në tregun e punës.



Një prej pengesave kryesore me të cilat ballafaqohen gratë në punësim ka të bëjë me dispozitat e Ligjit mbi Punën lidhur me pushimin e lehonisë dhe të atësisë, të cilat sigurojnë pushim vetëm për gratë. Kjo pastaj, ndikon në vendimet e punëdhënësve për të pranuar punëtorë, që krijon një mundësi për një dozë diskri-

minimi. Korniza ligjore duhet të sigurojë një model të balancuar të pushimit familjar, në përputhje me Direktivën 2010/18 të BE-së. Sipas kësaj Direktive, nënave u garantohej pushim i paguar në kohëzgjatje prej 8 muajve, ndërsa baballarëve pushim i paguar në kohëzgjatje prej 5 muajve.

Dispozitat për kompensimin duhet të zhvillohen nëpër faza, me tranzicion dhe në bashkëpunim me punëdhënësit, dhe gradualisht të transferohen në mënyrë që të mbulojnë nga ndonjë tatim ose nga fondi për mbrojtjen sociale.

Shkalla e pasivitetit ndikohet gjithashtu nga një nivel i lartë i punëtorëve të dekurajuar, të cilët mbeten të papunë për periudha zakonisht më të gjata se një vit. Në Kosovë, përqindja e atyre që janë të papunë për më shumë se një vit, në kuadër të të papunëve është rritur nga rreth 64% në vitin 2019, në rreth 72% në vitin 2020.<sup>18</sup> Megjithatë, rritja është më e rëndësishme tek meshkujt sesa tek femrat, dhe për femrat e moshës 40 deri në 44 vjeç, përqindja e të papunëve për më shumë se një vit është ulur. Një ndarje më e detajuar mund të gjendet në Aneksin 1.

Megjithatë, për shkak të pandemisë me COVID-19, ndryshimet në kohëzgjatjen e papunësisë mbeten të ndikuara nga mbyllja dhe masat e tjera kufizuese, kështu që mund të analizohen qartë me të dhënat nga viti 2021 e tutje.

### 3.4. PROPOZIM PËR KOSOVËN NË QASJEN NDAJ ARSIMIT DHE AFTËSIMIT PROFESIONAL

Programet e Arsimit dhe Arsimit Profesional (AAP) shpesh konsiderohen si sisteme që luajnë rolin e zhvillimit të aftësive të nevojshme për tregun e punës. Megjithatë, mënyra se si organizohen programet e AAP-së ndryshon nga vendi në vend dhe këto dallime i përcaktojnë edhe programet më të forta. Dallimi kryesor është gjetur të jetë "niveli i lidhjes ndërmjet akterëve nga sistemet e arsimit dhe punësimit."<sup>19</sup>

Veçoritë e tregut të punës janë përcaktuesit kryesorë të sistemeve të AAP-së, prandaj modelet ose kurrikulat specifike që kanë qenë të suksesshme në vende të caktuara nuk janë domosdoshmërisht modele suksesi për vendet tjera. Për më tepër, duke marrë parasysh aspektin më të rëndësishëm të programeve të AAP-së, që është lidhja e punëtorëve me tregun e punës, përvoja e punës dhe përvoja praktike e ofruar përmes programeve të AAP-së është vendimtare për suksesin.

Renold et. al. në analizën e kryer për të krahasuar programet e AAP-së kanë gjetur se programet më të suksesshme të AAP-së janë ato që përfshijnë arsimin klasik dhe trajnimet në vendin e punës.<sup>20</sup>

Në rastet kur akterët e sistemit arsimor janë dominues, siç është rasti aktual në Kosovë, programi i AAP-së është një arsimim i bazuar në shkollë për shkathtësi dhe karrierë. Në ekstremin tjetër, kur aktorët e sistemeve të punësimit dominojnë mbi programin, atëherë programi i AAP-së është program trajnimi në vendin e punës që ofrohet nga punëdhënësi. Një kombinim i të dyjave ka qenë modeli më i suksesshëm, megjithatë, nuk është e lehtë për të gjetur një ekuilibër. Indeksi KOF i Lidhjes Arsimit-Punësimit, bën matjen e lidhjes ndërmjet sistemit arsimor dhe sistemit të punësimit, përgjatë tri fazave të zinxhirit të vlerave të kurrikulës – hartimi, aplikimi dhe përditësimi.<sup>21</sup> Analiza ka dhënë rezultate që tregojnë se sistemet duale të AAP-së kanë rezultate më të mira në të gjitha aspektet e kësaj analize.

Rishikimi i përqendrimeve dhe specializimeve të ofruara nga sistemi arsimor i Kosovës, si në nivelin e arsimit profesional ashtu edhe në nivelin e arsimit terciar është thelbësor për të siguruar arritje të përmirësuar të aftësive që iu përshtaten nevojave të tregut të punës. Për më tepër, bashkëpunimi i ngushtë i institucioneve të Kosovës me punëdhënësit për të përcaktuar nevojat e tregut të punës, jo vetëm për tani, por edhe më shumë për të ardhmen, është i pashmangshëm dhe për të ikur nga mospërshtatja e vazhdueshme e aftësive, e cila nga ana tjetër ndikon në nivelet e larta të papunësisë dhe pasivitetit.

Sistemi aktual i AAP-së në Kosovë nuk e ka kaluar me sukses hendekun e aftësive në tregun e punës. Kjo veçanërisht për shkak të një lidhjeje të dobët ndërmjet punëdhënësve dhe sistemit arsimor. Ri-dizajnimi i programeve të AAP-së për t'iu përshtatur më mirë arsimit dhe trajnimeve të praktikës/në vendin e punës si aspekt, është po aq i rëndësishëm sa edhe arsimit për AAP-së.

Ndërkohë që një sistem dual i AAP-së kërkon kohë për t'u zhvilluar dhe zbatuar, është thelbësore që ky model të ndiqet. Përdorimi i modeleve ekzistuese si korniza për zhvillimin e sistemit të Kosovës, që i përshtatet më së miri karakteristikave tona të tregut të punës, rezultojnë në një sistem dual të AAP-së, i cili karakterizohet me 60-70% arsim dhe 30-40% trajnim në vendin e punës për nxënësit. Sistemi, megjithatë, duhet të planifikojë për një lëvizje graduale drejt përqindjes më të lartë të trajnimeve në vendin e punës dhe përqindjes më të ulët në arsimin klasik.

<sup>18</sup> Data for 2020 are only available until Q3.

<sup>19</sup> Ursula Renold, Thomas Bolli, Katherine Caves, Jutta Bürgi, Maria Esther Egg, Johanna Kemper and Ladina Raeth, "Comparing International Vocational Education and Training Programs: The KOF Education-Employment Linkage Index" (Washington, DC: National Center on Education and the Economy, 2018).

<sup>20</sup> Ibid.

<sup>21</sup> Në fazën e parë zhvillohen standardet e kualifikimit dhe vlerësim-it, së bashku me identifikimin e fushave kryesore të fokusit të nevojshëm. Në fazën e dytë trajtohen çështje praktike dhe të nivelit të aplikimit, duke përfshirë provimet. Në fazën e tretë, punëdhënësit japin komente për të diplomuarit, por edhe për kërkesën aktuale, për t'u përdorur si informacion për ndryshimet e mundshme të kurrikulës.

Hapi i parë për të arritur këtë është identifikimi i sektorëve me prioritet për rritjen e punësimit. Institucionet e Kosovës duhet të identifikojnë sektorët kryesorë të interesit në të cilët dëshirojnë të orientojnë burimet, veçanërisht të orientojnë përpjekjet për punësim. Përmes analizës së përparësive krahasuese të zbuluara ose duke synuar sektorët me produktivitetin më të lartë të eksportit, ose duke përzgjedhur sektorët bazuar në një vizion specifik politik dhe ekonomik të qeverisë, qeveria e Kosovës duhet të identifikojë 3-5 sektorë prioritarë, si për rritje ashtu edhe për punësim. Këta sektorë mund të jenë ata që premtojnë më shumë në eksport, sektorë që lidhen me tregjet ndërkombëtare, ose sektorë me koston më të ulët të trajnimit dhe përmirësimit të fuqisë punëtore.

Pas identifikimit të këtyre sektorëve, ministria përgjegjëse për zhvillimin e industrisë dhe sektorit privat, përmes angazhimit të përfaqësuesve të sektorit privat, do të identifikonte ndërmarrjet e sektorit privat brenda atyre sektorëve që janë të gatshëm të marrin pjesë në programet e AAP-së. Ky është hapi më i vështirë, duke pasur parasysh se shumica e ndërmarrjeve në Kosovë janë ndërmarrje të vogla dhe të mesme, për të cilat është e vështirë të angazhohen në planifikim afatgjatë të stafit. Megjithatë, varësisht nga niveli i gatishmërisë për t'u angazhuar, mund të zhvillohen stimuj nga institucionet e Kosovës, për të filluar me angazhimin e ndërmarrjeve në program.<sup>22</sup>

Hapi i tretë është krijimi i këshillave për aftësim sektorial, në çdo sektor, që shërbejnë si mekanizëm për bashkëpunimin e sektorit publik (veçanërisht të arsimit) dhe sektorit privat. Këshillat për aftësim sektorial do të shërbenin jo vetëm për identifikimin e aftësive të nevojshme në treg, por edhe për të kontribuar në zhvillimin e kurrikulës, zgjedhjen e moduleve të trajnimit dhe më e rëndësishmja për të ofruar mundësi për trajnime dhe punë praktike në vendin e punës.

Këshillat për aftësim sektorial do të shërbenin si organe këshillimore dhe do të kishin anëtarë përfaqësues: (1) punëdhënësit kryesorë të sektorit (firmat e sektorit privat me kapacitete më të larta të punësimit); (2) institucionet përkatëse qeveritare (ministria përgjegjëse për punën, ministria përgjegjëse për arsimin, ministria përgjegjëse për zhvillimin e industrisë, agjencinë e punësimit); dhe (3) sindikatat ose organizatat profesionale të punëtorëve të sektorit përkatës.

Si një organ trepalësh, këshillat për aftësim sektorial do t'u mundësojnë punëdhënësit të sektorit përkatës të luajnë një rol kyç në ofrimin e rekomandimeve specifike për kërkesat e aftësimit në sektorin e tyre, do t'u ofrojnë institucioneve qeveritare njohuri të drejtpërdrejta mbi nevojat e tregut të punës dhe do të fuqizojnë organizatat e punëtorëve që të përfaqësojnë nevojat dhe pritshmëritë e fuqisë punëtore nëpër sektore.

Së fundi, të zhvillohet një sistem i rreptë monitorimi, i cili mundëson rishikimin e kurrikulave dhe mundësitë e orientimit në karrierë sipas ciklit trevjeçar. Sistemi i monitorimit duhet të ketë instrumente për mbledhjen e të dhënave të performancës në sistemin e arsimit profesional, instrumente për mbledhjen e të dhënave për gjurmimin e të diplomuarve dhe vlerësimin e performancës së tyre në vendin e punës dhe krahasimin e pikëve për të identifikuar mangësitë dhe sukseset në sistem. Instrumentet e reja për mbledhjen e të dhënave duhet të integrohen në sistemin statistikor të sektorit të arsimit në Kosovë dhe këto të dhëna të publikohen për çdo vit. Megjithatë, anketat e gjurmimit dhe të dhënat e performancës në vendin e punës duhet të sigurohen nga këshillat për aftësim sektorial.

Analiza e të dhënave do t'i lejojë institucionet të gjurmojnë progresin, të identifikojnë mangësitë dhe zbrazëtitrat që duhen adresuar dhe të identifikojnë aspektet e forta të sistemit.

<sup>22</sup> Stimujt mund të ndryshojnë sipas ofrimit të praktikave të paguara nga qeveria/donatorët, deri te lehtësimet tatimore me kohë të kufizuar për përfshirjen në programet e AAP-së dhe punësimin nga këto programe.


### 3.5. PROPOZIMET PËR SINDIKATAT

Sistemi i negocimit të marrëveshjes kolektive në Kosovë mbetet i brishtë, veçanërisht për punëtorët në sektorin privat. Në Kosovë, veprojnë një numër sindikatash, të cilat i përfaqësojnë punëtorët në sektorin publik apo ndërmarrjet publike. Punëtorët në sektorin publik përfaqësohen përmes Unionit të Sindikatave të Pavarura, organizatë ombrellë, e lidhur me Konfederatën Ndërkombëtare të Sindikatave (ITUC).

Sindikatat që përfaqësojnë punëtorët e NSH-ve të privatizuara kanë pësuar krizë për shkak të ndryshimit

të lidhshimit si dhe transformimit të pritshëm të vendeve të punës, i cili shpesh nuk u realizua kurrë. Por, në përgjithësi sindikatat në Kosovë janë shumë të politizuara, duke përdorur ndikimin e tyre për të ndikuar në vendimet e qeverisë, por aq më tepër për të siguruar premtime politike. Si rezultat, hendeku midis punëtorëve të sektorit privat dhe atij publik është zgjeruar, veçanërisht në kuptim të pagave.


Në vitin 2020, paga mesatare bruto në sektorin publik ishte 624€, krahasuar me vetëm 380€ në sektorin privat, siç shihet në Figurë.



Është shumë me rëndësi se tendenca e ndryshimeve në nivelet e pagave në sektorin privat dhe publik është zgjeruar në dekadën e fundit. Pagat e sektorit publik në vitin 2012 ishin rreth 20% më të larta, ndërsa në vitin 2014 u rritën për 43%, për shkak të një

vendimi të qeverisë për të rritur pagat në sektorin publik, siç është paraqitur në Figurën 8. Sektori privat nuk e ka ndjekur rritjen e pagave në sektorin publik dhe hendeku midis pagave në sektorin privat dhe atij publik është rreth 65% në vitin 2020.

Figura 8. Trendi i dallimeve në paga në sektorin publik dhe privat.



Mungesa e mbulimit sindikal në sektorin privat ka ndikuar jo vetëm në nivelet e pagave, por edhe në kushtet e punës. Punëtorët në sektorin privat punojnë me orë më të gjata, mesatarisht një ditë të plotë pune më shumë se punëtorët në sektorin publik (35 orë në sektorin publik krahasuar me 42 orë në sektorin privat). Vlerësohet se 30% e punëtorëve në sektorin privat punojnë pa kontratë, dhe si të tillë janë pa mbrojtje ligjore. Për gratë punëtore në sektorin privat, 1 në 3 nuk kanë kontratë, ndërsa numri është 1 në 2 për ato që punësohen për herë të parë.<sup>23</sup> Aq më tepër, shumica e punëtorëve që kanë kontrata në sektorin privat, punojnë me kontrata afatshkurtëra, zakonisht për më pak se një vit.

Këto paqartësi nga punësimi në sektorin privat tregojnë për nevojën e qartë të njoftimit të sindikatave dhe të mbrojtjes nga sindikatat, në veçanti në industrinë me punësimin më të lartë dhe atë me nivelin më të lartë të rrezikut, siç është industria e ndërtimit.

Në mënyrë që sindikatat të kenë sukses, duhet të ekzistojnë kushte të shumta, duke përfshirë, por pa u kufizuar në mekanizma efektive të dialogut social, lidhje të forta institucionale për sindikatat, si dhe përfshirjen si partnerë strategjikë. Institucionet e Kosovës duhet të krijojnë një kornizë të fortë legjislative që mbron punëtorët dhe të drejtën e tyre për të themeluar dhe për të qenë pjesë e sindikatave, qoftë brenda firmave apo industrisë.

Përfshirja e përfaqësuesve të punëtorëve, me përcaktim specifik të përfaqësimit të organizuar, në dialogun publiko-privat për kushtet e punës, duke përfshirë orarin e punës, pagesën për punën shtesë dhe të pushimit, sigurimin shëndetësor dhe sigurinë në vendin e punës, mund të rrisë në mënyrë dramatike fuqinë e përfaqësuesve të punëtorëve dhe interesin e punëtorëve për t'u organizuar.

Për të përmirësuar anëtarësimin në sindikata dhe përfaqësimin e punëtorëve në dialogjet e punës, institucionet e Kosovës duhet të hartojnë dispozita ligjore të cilat e fuqizojnë rolin e sindikatave në përmirësimin e rezultateve të punës.

Ligji për Investimet, përderisa ofron stimuj për investitorët e huaj të drejtpërdrejtë, duhet gjithashtu të mbrojë të drejtat e punëtorëve dhe kushtet e punës. Legjislacioni për investimet duhet të ketë dispozita që kërkojnë nga investitorët të garantojnë të drejtat e punëtorëve përmes organizatave të punëtorëve dhe sindikatave. Për më tepër, organizatat e punëtorëve duhet të përfshihen në negociatat për çdo ndryshim të kushteve të investimit. Legjislacioni më tej duhet të parandalojë marrëveshjet e kompanive që nënvlerësojnë sindikatat sektoriale dhe çdo marrëveshje nga negociimet kolektive të arritura nga organizatat e punëtorëve sektoriale.

Të gjitha përfitimet e firmave të sektorit privat nga qeveria e Kosovës duhet të jenë të kushtëzuara nga organizatat e punëtorëve përmes sindikatave, qoftë në nivel kompanie apo atë sektorial.

<sup>23</sup> Riinvest Institute, Facilitating Empowerment: Factors Influencing Women's Economic Decisions in Kosovo, 2018

Nëpërmjet dispozitave të tilla i kushtohet rëndësi punëtorëve dhe kushteve të punës si kyçe për zhvillimin e sektorit privat. Për më tepër, kushtëzimet e tilla mund të ndikojnë tek firmat në zhvillimin e udhëzimeve të standardeve sociale, veçanërisht kur kanë të bëjnë me furnitorët ose kur ato janë pjesë e zinxhirëve të vlerës.<sup>24</sup>

Në sektorë të veçantë, si bujqësia, ku ministria përgjegjëse për zhvillimin e bujqësisë mbështet prodhuesit përmes granteve dhe subvencioneve të vazhdueshme, përshtatshmëria për programe të tilla mund të kushtëzohet nga organizatat e punëtorëve.

Së fundi, Ligji i Punës, specifikon lirinë e organizimit të punëtorëve dhe të sindikatave, me specifikat e sindikatave dhe organizimit të tyre, të përcaktuara në Ligjin për Organizimin e Sindikatave në Kosovë. Asnjë nga ligjet nuk i kushtëzon sindikatat në sektorë të caktuar. Krijimi i organeve sektoriale, si këshilli për aftësim sektorial, për zhvillimin e kurrikulës së arsimit profesional, të cilat kërkojnë përfaqësim nga ana e përfaqësuesve të sindikatave sektoriale, mund të shërbejnë si garanci për krijimin e sindikatave sektoriale. Këto dispozita mund të parashikohen në Ligjin e Punës ose në legjislacionin tjetër që themelon organe të tilla të bashkëpunimit sektorial.

Negociatat kolektive dhe dialogjet tjera të negociatave sektoriale duhet të përcaktohen në kuptimin e pjesëmarrjes dhe legjitimitetit të përfaqësimit. Aktualisht, marrëveshja kolektive është arritur ndërmjet Unionit të Sindikatave të Pavarura, si organ përfaqësues i punëtorëve të sektorit privat dhe organeve përfaqësuese të punëdhënësve dhe qeverisë. Sidoqoftë, struktura e tregut, me një numër të kufizuar të punëdhënësve të mëdhenj, po ashtu ndikon në numrin e punëtorëve të cilët mbulohen nga marrëveshja kolektive, duke e lënë kështu potencialisht një numër të konsiderueshëm të punëtorëve të pambluar me këtë marrëveshje. Megjithatë, rregullimi i përfaqësimit të punëtorëve në aspektin e industrive dhe sektorëve është një mënyrë e rëndësishme për të inkurajuar qartë organizimin e punëtorëve në sindikatat sektoriale ose të industrisë.

Kështu, rregullimi i përfaqësimit të punëtorëve në kuptim të industrive dhe sektorëve paraqet një mënyrë të rëndësishme për inkurajimin e organizatave të punëtorëve që të jenë pjesë e sindikatave sektoriale dhe të industrisë. Për më tepër, në nivel të kompanive, kushti për formimin e këshillit të punëtorëve në mungesë të sindikatave siguron një bazë të fortë për organizimin e punëtorëve në këtë nivel.

## 4. KONKLUZIONE

Tregu i punës në Kosovës është ende në një gjendje të brishtë për shkak të problemeve që dalin nga nivelet e larta të papunësisë, nivelet e larta të pasivitetit, si dhe hendekut të mospërshtatjes së aftësive, që ka qenë arsye për shqetësim gjatë dekadës së fundit. Mirëpo, deri më sot, pak veprime reale janë ndërmarrë për t'i kapërcyer këto probleme. Preferencat e qarta për punësimin në sektorin publik, një sektor tashmë i ngopur, kanë ardhur si rezultat i kushteve superiore të punës në sektorin publik, ndërsa në të njëjtën kohë ka përballje me pabarazi të konsiderueshme në sektorin privat.

Për të adresuar këto çështje, ekziston nevoja për të nxitur themelimin e sindikatave të punës dhe sindikatave të punëtorëve në sektorin privat, për të përmirësuar dialogun social dhe për të përmirësuar të drejtat e punëtorëve. Për më tepër, është thelbësore të përmirësohet efektiviteti i inspektoratit të punës, përmes inspektimeve më të plota dhe një numri më të madh të inspektorëve, për t'u përshtatur me nevojat e tregut të punës.

Për më tepër, kadri ligjor që rregullon tregun e punës duhet të sigurojë punë fleksibile, punë me orar jo të plotë, si dhe punë të përbashkët, në profesionet ku kjo është e mundur, si skema për rritjen e punësimit dhe përmirësimin e pjesëmarrjes, sidomos të të rinjve dhe grave në tregun e punës. Në mënyrë të ngjashme, duhet të miratohen dispozita ligjore që rregullojnë punën nga shtëpia, veçanërisht duke pasur parasysh pandeminë me COVID-19. Orientimi strategjik i ekonomisë së bashku me tregun e punës duhet të përkthehet në një plan të qartë veprimi që parashikon orientimin e ardhshëm të punës.

Kjo duhet të përfshij reformën e arsimit dhe trajnimin, bashkëpunimin me sektorin privat në përcaktimin e nevojave të tregut dhe sigurimin që tejkalimi i hendekut të aftësive të bëhet përmes zhvillimit të ndërsjellë të ekonomisë dhe tregut të punës.

Nëpërmjet mbledhjes periodike të të dhënave të synuara, qeveria mund të identifikojë sektorët me potencial zhvillimi dhe ata me potencial për krijimin e vendeve të punës. Stimulimi i sektorëve me potencial për krijimin e vendeve të punës mund të informojë politikat fiskale, si p.sh. lehtësimet tatimore për kompanitë që krijojnë vende të reja pune - jo vetëm duke mbajtur ato ekzistuese, në sektorë të veçantë me potencial për zhvillim.

Të dhënat e tregut të punës duhet të mblidhen dhe publikohen sipas ndarjeve sektoriale, gjinore dhe të moshës, për të bërë të mundur kryerjen e analizave të duhura që mundësojnë orientimin e detajuar strategjik të ekonomisë, që synon përmirësimin e mundësive ekonomike për të gjitha grupet e shoqërisë.

<sup>24</sup> Në Itali, shtëpia e dizajnit të modës Gucci, si mjet për ruajtjen e kontrollit të cilësisë, kërkon që furnitorët të respektojnë standardet sociale – duke përfshirë marrëveshjet kolektive.

## REFERENCAT

- Azizi, SeyedSoroosh**, (2018), The impacts of workers' remittances on human capital and labour supply in developing countries, *Economic Modelling*, 75 (2018) 377-396
- Central Bank of Kosovo**, (2021), Remittances by Channel, 2021
- Employment Agency of the Republic of Kosovo**, (2020), Work and labour
- Kosovo Agency of Statistics**, (2021), Labour Force Survey, 2016-2020
- Kosovo National Qualifications Authority**, (2020), Qualification Classification, <https://akkks.rks-gov.net/en/nqa/about-us>
- Kosovo Tax Administration**, (2020), Employment Data
- Kozel, Valerie & Alderman, Harold**, (1990), Factors Determining Work Participation and Labour Supply Decisions in Pakistan's Urban Areas, *The Pakistan Development Review*, vol. 29, issue 1, 1-18
- LMIS**, (2020), Data on supply and demand in the labour market: <http://sitp.rks-gov.net>
- Renold. U., Bolli. T., Caves, K., Bürgi, J., Egg, M.E., Kemper, J., & Rageth, L.**, (2018), Comparing International Vocational Education and Training Programs: The KOF Education-Employment Linkage Index, National Center on Education, and the Economy
- Riinvest Institute**, (2018), Facilitating Empowerment: Factors Influencing Women's Economic Decisions in Kosovo, Riinvest Institute
- Rudi, Jeta**, (2014), Remittances and Labour Supply: The Case of Kosovo, Working Paper
- UNDP Kosovo**, (2020), Public pulse analysis: Correlation between labour market of Kosovo and outmigration, 2020
- World Bank**, (2019), Kosovo country report: Findings from the Skills towards Employment and Productivity Survey, World Bank, Washington, DC

# KAPITULLI 2. NJË MËNYRË E RE PËR PËRCAKTIMIN E PAGËS MINIMALE NË KOSOVË

DITA DOBRANJA DHE EDISON JAKURTI

## 1. HYRJE

Përderisa papunësia e lartë mbetet problemi kryesor i tregut të punës në Kosovë, ka shumë çështje me të cilat ballafaqohen edhe të punësuarit. Një prej tyre është niveli i pagave, veçanërisht për ata me paga të ulëta. Për më se një dekadë ka pasur ndryshime në ekonomi, por një tregues nuk ka ndryshuar në terma nominalë – paga minimale. Duke qenë se është një mbrojtje për punëtorët më të varfër, niveli i pagës minimale është gjithashtu një pasqyrim i prioriteteve të një qeverie dhe busullës së saj ideologjike. Një stagnim i tillë në rritjen e pagës minimale ka pasur ndikime negative në tregun e punës dhe si i tillë duhet të adresohet. Qasja ndaj përcaktimit të pagës minimale duhet të pasqyrojë ndryshimet dinamike dhe të shpejta në ekonomi, nëpërmjet rregullimeve periodike dhe duke marrë parasysh aspekte të shumta të ekonomisë.

Meqenëse ka një debat të vazhdueshëm për efektet e mundshme negative të pagës minimale në faktorë të tjerë si papunësia dhe duke qenë se kjo është një çështje veçanërisht e rëndësishme në kontekstin e Kosovës, ne sjellim dëshmi të reja për këtë marrëdhënie. Megjithëse modeli ynë bazë është shumë i thjeshtë dhe i ndikuar nga disa kufizime, ai përsëri na mundëson të ofrojmë disa njohuri mbi efektet e mundshme të rritjes së pagës minimale ndaj papunësisë. Vendimi është i qartë: nuk ka asnjë efekt negativ.

Më tej, në këtë kapitull ne e paraqesim një qasje të re për përcaktimin e pagës minimale në Kosovë. Në mënyrë të veçantë, ne kemi zhvilluar një formulë të thjeshtë matematikore e cila është intuitive dhe e lehtë për t'u përdorur. Ekzistojnë tre tipare kryesore të modelit tonë. Së pari, ai llogarit pagat e tjera në ekonomi duke lidhur pagën minimale me pagën mesatare. Së dyti, ai llogarit "shëndetin" e përgjithshëm të ekonomisë duke e përshtatur atë për rritjen ekonomike në terma realë.

Dhe së treti, është dinamik duke qenë se mundëson pasqyrimin e ndryshimeve të këtyre faktorëve të lartpërmendur në 3 vitet e fundit.

## 2. KRITERET PËR PËRCAKTIMIN E PAGËS MINIMALE

Pagat minimale kanë qenë subjekt i diskutimeve në të gjithë botën, me mbështetësit dhe kundërshtarët që ofrojnë zgjidhje për çështjet. Në Kosovë, llogaritjet e pagës minimale bazohen në sa vijon: (1) Kostoja e jetesës; (2) Shkalla e papunësisë; (3) Situata e tregut të punës; (4) Niveli i konkurrencës dhe produktivitetit.<sup>25</sup> Ndërsa kostoja e jetesës, bazuar në Indeksin e Çmimeve të Konsumit (IÇK) dhe shkalla e papunësisë, bazuar në Anketat e Fuqisë Punëtore, përcaktohen lehtësisht, faktorët e parashikuar që ndikojnë në përcaktimin e pagës minimale lënë vend për interpretim.

Marrëveshja kolektive e rënë dakord në Këshillin Ekonomik Social<sup>26</sup>, vendos një grup të ndryshëm kriteresh, duke përfshirë koston e jetesës, nevojat e punëtorëve dhe familjeve të tyre, standardin e jetesës së punëtorëve, si dhe nivelin e zhvillimit ekonomik. Këto kriteret përsëri lejojnë interpretimin.

Në nivel global, ka shumë metoda që përdoren për të vendosur nivelin e pagës minimale. Në SHBA, Qeveria Federale përcakton pagën minimale, e cila aktualisht është vendosur në 7,25\$/ora, megjithatë, shumë shtete i kanë ligjet e tyre për pagën minimale. Në rastin kur punonjësit i nënshtrohen pagës minimale shtetërore dhe federale, ata kanë të drejtë për pagën minimale që është më e larta nga të dyja.<sup>27</sup>

<sup>25</sup> Administrative instruction no. 09/2017 on setting a minimum wage in the Republic of Kosovo

<sup>27</sup> US Department of Labor, Minimum Wage, Accessed October 2021, <https://www.dol.gov/general/topic/wages/minimumwage>


<sup>28</sup> Richard Dickens, How are Minimum Wages Set, IZA, World of Labour, 2015

<sup>25</sup> Udhëzimi Administrativ nr. 09/2017 për caktimin e pagës minimale në Republikën e Kosovës



Vende si Austria dhe Gjermania përcaktojnë pagën minimale bazuar në një sistem të negociatave kolektive. Rreth 6% e vendeve në botë nuk kanë fare një

sistem pagash minimale. Një përmbledhje më e detajuar e qasjeve të ndryshme për përcaktimin e pagës minimale mund të shihet në Figurën 1.



Përcaktimi i pagës minimale gjithashtu ndryshon midis vendeve dhe në varësi të faktit nëse ato përdorin një pagë minimale të vetme ose paga të ndryshme për grupe të ndryshme punëtorësh. Kosova ka një pagë minimale të ndryshme në varësi të moshës, të përcaktuar me një normë më të ulët për punëtorët nën 35 vjeç dhe më të lartë për ata që janë më në moshë. Qasje të tjera për të diferencuar punëtorët përfshijnë përcaktimin e pagave minimale sipas sektorit ose profesionit. Qëllimi kryesor i përcaktimit të pagave të ndryshme për grupe të ndryshme punëtorësh është që të lejojë qeverinë të përshtatë përgjigjet e politikave për këto grupe të ndryshme. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në kohë krizash ekonomike ose sociale, kur qeveria mund të zgjedhë të lehtësojë pagat minimale për grupe të caktuara (për shembull sektorë që nuk ndikohen nga rënia ekonomike) duke i mbajtur ato në vend për sektorë të tjerë. Megjithatë, pika negative e përcaktimit të pagave të ndryshme për grupe të ndryshme qëndron në rrezikun e mospërputhjes ose kompleksitetit për t'u administruar.

### 3. FORMA TË NDRYSHME TË PËRCAKTIMIT TË PAGËS MINIMALE

Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO) rekomandon një grup të përgjithshëm kriteresh dhe qasje që duhet ndjekur nga vendet që vendosin pagat minimale. Bazuar në Konventën e Fiksimit të Pagës Minimale, paga minimale duhet të përfshijë si aspektet sociale ashtu edhe ato ekonomike.<sup>29</sup>

Më së shumti, paga minimale, sipas konventës, duhet të sigurojë marrjen parasysh të kostos së jetesës, nivelet e përgjithshme të kompensimit të pagave, si dhe shkallën e rritjes ekonomike dhe produktivitetit.<sup>30</sup>

Sipas ILO, lista nuk është shteruese dhe niveli i përfshirjes së këtyre treguesve varet nga lloji i mekanizmave të përcaktimit të pagës minimale që përdor vendi. Përderisa nuk ka një qasje që i përshtatet të gjithëve, mekanizmat që përfshijnë një numër më të madh akterësh dhe ekspertësh në përcaktimin e pagës minimale, kanë gjasa më të larta për të përfshirë perspektivat e nevojshme në përcaktimin e pagës minimale.

#### 3.1 VETËM QEVERIA

Përcaktimi i pagave minimale përmes vendimeve për çështjet e qeverisë dhe i votuar në organet qeveritare, ndonëse konsiderohet më efikas, shpesh është i ekspozuar ndaj kritikave për mos marrjen parasysh të perspektivës së palëve të tjera të interesuara, veçanërisht të sindikatave. Në SHBA, përcaktimi i pagës minimale ka qenë në stagnim dhe subjekt i agjendave politike të dy partive kryesore. Problemet e lidhura me agjendat politike dominojnë në përcaktimin e pagave në vendet ku qeveria vetë e përcakton pagën minimale.

<sup>30</sup> IPër sa i përket aspekteve sociale, ILO përcakton se përcaktimi i pagës minimale duhet të paktën të merr parasysh: (1) nevojat e punëtorëve dhe familjeve të tyre, (2) nivelet e përgjithshme të pagave në ekonomi, (3) koston e jetesës, (4) përfitimet e sigurisë sociale, si dhe (5) standardet e jetesës së grupeve të tjera shoqërore. Faktorët ekonomikë që duhet të merren parasysh përfshijnë: (1) zhvillimin ekonomik, (2) nivelet e produktivitetit; si dhe (3) dëshirën për të arritur dhe mbajtur një nivel të lartë punësimi.

<sup>29</sup> ILO, Chapter 5 – Setting and adjusting minimum wage levels, 2015

### 3.2. ORGANI EKSPERT

Qasja më e zakonshme për përcaktimin e pagës minimale ka qenë ajo e përdorimit të organeve të ekspertëve për të vendosur nivelin e duhur. Mënyra se si rregullohet kjo varet nga vendi, por në shumicën e vendeve organet e ekspertëve përbëhen nga akterë dhe ekspertë përkatës të fushës, të cilët në dialog me organet qeveritare rekomandojnë nivelet e pagave minimale. Përbërja e organeve të ekspertëve është e rëndësishme për arsye të objektivitetit dhe për të mos i shërbyer asnjë interesi politik apo sindikal.

### 3.3. FORMULA MATEMATIKORE

Shumë vende përdorin formula matematikore për përcaktimin e nivelit të pagës minimale. Kjo metodë siguron ngurtësi në përcaktimin e pagave minimale dhe në shumicën e rasteve e kompenson automatikisht inflacionin, i cili nga ana tjetër siguron që pagat minimale të ruajnë fuqinë e tyre blerëse. Megjithatë, përshtatja vetëm për inflacionin nuk ofron një qasje gjithëpërfshirëse për përcaktimin e pagës minimale. Disa vende përdorin formula më të komplikuar matematikore, për të përshtatur rritjen ekonomike, pagat e sektorëve të tjerë, si dhe nivelet e varfërisë.

Malajzia<sup>31</sup> përdor një nga formulat matematikore më gjithëpërfshirëse dhe më të ndërlikuara për përcaktimin e pagave minimale. Duke pasur parasysh se Malajzia përcakton paga minimale të ndryshme bazuar në rajone, formula për përcaktimin e pagës minimale llogaritet sipas kësaj, si dhe për të ardhurat e kufirit të varfërisë, rritjen e produktivitetit, indeksin e çmimeve të konsumit dhe shkallën reale të papunësisë. Aktualisht, paga minimale në Malajzi llogaritet si mesatare e të ardhurave të vijës së varfërisë në termat e punëtorëve mesatarë për familje, duke shtuar pagën mesatare. E gjithë kjo më pas llogaritet në terma të rritjes së produktivitetit, indeksit të çmimeve të konsumit dhe shkallës reale të papunësisë, në rajone të ndryshme.

Nga ana tjetër, në Francë<sup>32</sup>, ndryshimi vjetor i pagës minimale lidhet drejtpërdrejt me inflacionin (llogaritur nëpërmjet indeksit të çmimit për konsumator (IÇK) nga viti në vit dhe me fuqinë blerëse të pagave të punëtorëve fizikë. Nëpërmjet kësaj, Franca synon të marrë në konsideratë, si koston e jetesës, por edhe të mbajë pagën minimale të lidhur me pagat e fuqisë punëtore më të paguar në ekonomi. Megjithatë, marrëveshjet kolektive në të kaluarën kanë ndikuar në pagat minimale sektoriale, duke i vendosur ato si më të larta se paga minimale e llogaritur.

Vende të ndryshme konsiderojnë aspekte të ndryshme për t'i përfshirë në llogaritjet e tyre të pagave minimale, megjithatë, përdorimi i formulave matematikore lë pak ose aspak fleksibilitet për përgjigjen e politikave ndaj ndryshimit të kushteve të tregut të punës. Për më tepër, edhe në vendet ku përdoren formula matematikore, gjatë përcaktimit të formulave për përcaktimin e pagave minimale duhet të konsultohen organet e ekspertëve.

### 3.4. NEGOCIATAT KOLEKTIVE

Përdorimi i marrëveshjeve kolektive si metodë e përcaktimit të pagës minimale varet nga ndikimi që kanë në vend sindikatat dhe organizatat e punëtorëve. Për më tepër, duke qenë se sindikatat shpesh veprojnë në nivel sektorial, marrëveshjet kolektive për përcaktimin e pagave minimale vendosen edhe në nivele sektoriale. Ndërsa kjo qasje garanton një qasje gjithëpërfshirëse, ajo është gjithashtu e vështirë për t'u zbatuar dhe kërkon nivele të larta të kapaciteteve institucionale. Vendet si Suedia, Finlanda dhe Danimarka, e zbatojnë këtë qasje, me paga minimale të përcaktuara sektoriale.

### 3.5. PËRCAKTIMI I PAGËS MINIMALE NË KOSOVË

Aktualisht, paga minimale në Kosovë është e vendosur përmes kornizës legjore, e cila është miratuar në vitin 2011. Në vitin 2011, Ligji për Pagën Minimale ka përcaktuar se paga minimale është e detyrueshme në tërë Kosovën, nuk ka dallim në mes të rajoneve apo profesioneve, me dallimin e vetëm në nivelin e pagës minimale sipas moshës. Paga minimale është 130 € për ata nën 35 vjeç; 170 € për ata mbi 35 vjeç.

Qasja e Kosovës për përcaktimin e pagës minimale ka nevojë për reforma, jo vetëm për shkak se paqartësitë që rrjedhin nga kriteret e përcaktuara dobët, të kombinuara me ndikimet nga marrëveshjet kolektive, paraqesin shkak për shqetësim. Për më tepër, stagnimi në përditësimin e pagës minimale në Kosovë ka shkaktuar pakënaqësi te punëtorët dhe përfaqësuesit e tyre. Megjithatë, duke pasur parasysh fuqinë e pabarabartë që ushtrojnë sindikatat që përfaqësojnë punëtorët në institucionet publike, krahasuar me organizimin e vogël ose aspak kolektiv të punëtorëve në sektorin privat, është thelbësore të zhvillohet një sistem i përcaktimit të pagave minimale që nuk lejon ndikim të padrejtë.

Përdorimi i një organi të ekspertëve për të zhvilluar një formulë matematikore për përcaktimin e pagës minimale, në mënyrë që përshtatjet të bëhen bazuar në tendencat ekonomike, sociale dhe të tregut të

<sup>31</sup> See International Labor Organization Website: [https://www.ilo.org/global/topics/wages/minimum-wages/setting-adjusting/WCMS\\_439264/lang-en/index.htm](https://www.ilo.org/global/topics/wages/minimum-wages/setting-adjusting/WCMS_439264/lang-en/index.htm)

<sup>32</sup> Ibid

punës, është qasja me gjasat më të larta për të pasur sukses. Megjithatë, treguesit që përfshihen në përcaktimin e pagës minimale duhet të përputhen me të dhënat që mbledhen vazhdimisht, në mënyrë që përcaktimi i pagës minimale të mos dështojë për shkak të mungesës së të dhënave.

Çështjet kryesore që duhet të adresojë përcaktimi i pagës minimale në Kosovë janë pabarazia ekzistuese e të ardhurave dhe pagave, të cilat mund të anojnë pagën minimale; rritja reale, e cila përshtatet me ndryshimet në çmimet dhe standardin e jetesës; si dhe rregullimi i periudhave të përshtatjes, për të siguruar që paga minimale të përshtatet dhe të reflektojë ndryshimet në ekonomi, në vend që të mbetet si vullnet institucional apo politik.

#### 4.1. EFEKTET E NDRYSHIMEVE TË PAGËS MINIMALE NË PAPUNËSI – NJË ANALIZË EMPIRIKE PËR KOSOVËN

Për të adresuar shqetësimet rreth ndikimit që ka paga minimale në papunësi, në mesin e faktorëve tjerë, është kryer një analizë e thjeshtë e regresionit me katrorin më të vogël të zakonshëm (OLS) ndërmjet pagës minimale dhe papunësisë, për tregun e punës

në Kosovë, duke filluar nga viti 2016, me të dhëna tremujore të raportuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës. Nivelet e pagës minimale, bazuar në legjislacionin, u raportuan në përputhje me kufijtë e moshës në grupin e të dhënave (130 € për personat nën 35 vjeç; 170 € për personat mbi moshën 35 vjeç).

Ndërveprimi i vetëm midis pagës minimale dhe papunësisë u vlerësua përmes një analize të thjeshtë të regresionit, sipas modelit të mëposhtëm:

$$\text{papunësia} = \beta_0 + \beta_1 (\text{pagaMin})$$

ku  $\beta_1$  është njësia proporcionale për ndryshimin e njësive midis pagës minimale dhe papunësisë.

Për këtë analizë të regresionit, hipoteza zero ishte se paga minimale nuk do të kishte efekt në shkallën e papunësisë.

$$\begin{aligned} H_0: \beta_1 &= 0 \\ H_A: \beta_1 &\neq 0 \end{aligned}$$

Sidoqoftë, hipoteza alternative thotë se  $\beta_1 \neq 0$ , që tregon një lidhje të drejtpërdrejtë midis pagës minimale dhe papunësisë. Tabela 1 përmban rezultatet e analizës së thjeshtë të regresionit linear, me gabime standarde të qëndrueshme.

Tabela 1. Rezultatet e modelit të thjeshtë të regresionit OLS

Variablat e pavarura	Rezultatet e modelit të përgjithshëm	Rezultatet e papunësisë së grave
Paga minimale	-717.8947** (40.96643)	-301.3377** (12.9006)
Ndërhyrja	137505.3** (6268.093)	54313.38** (2023.168)
Vëzhgimet	95	95
R-sq	0.7591	0.8587

Gabimet standarde të koeficientëve të vlerësuar janë raportuar në kllapa.  
 \* | rëndësishëm në nivelin 0.05  
 \*\* | rëndësishëm në nivelin 0.01  
 \*\*\* | rëndësishëm në nivelin 0.001

Për modelin e përgjithshëm, përcaktimi i ndikimit të pagës minimale në papunësinë e përgjithshme, koeficienti i përcaktimit, R-katror është 0.759, duke treguar se 76% e variacionit të papunësisë, që nga viti 2016, shpjegohet me pagën minimale. Rezultatet e vlerës- P tregojnë se rezultati i regresionit si një vlerë 0% të jetë në mënyrë të rastësishme, duke treguar kështu një rëndësi të lartë të rezultateve.

$$\text{papunësia(mijëra)} = 137505.3 - 717.8947(\text{pagaMin})$$

Do të thotë se, nëse vendi nuk ka pagë minimale të përcaktuar (pra paga minimale është 0 €), numri i të papunëve do të jetë 137,505; megjithatë, një rritje prej 1 € në pagën minimale pritet të ulë papunësinë për 718.

Duke pasur parasysh nivelin e lartë të papunësisë dhe pasivitetit të grave në tregun e punës në Kosovë, është gjithashtu e rëndësishme të përcaktohet nëse paga minimale ka ndikim në nivelin e papunësisë së grave.

R-katrori për regresionin e dytë është 0.8587, duke treguar se 86% e variacionit të papunësisë së grave, që nga viti 2016, shpjegohet me pagën minimale. Rezultatet e vlerës- P tregojnë se rezultati i regresionit si një vlerë 0% të jetë në mënyrë të rastësishme, duke treguar kështu një rëndësi të lartë të rezultateve.

papunësia gratë(mijëra) = 54313.38-301.3377(mijëra)

prej 1 € në pagën minimale, papunësia e grave pritet të ulet për 301.

Për më tepër, duke qenë se pandemia me COVID-19 e vitit 2020, ka shkaktuar një përçarje në ekonominë e përgjithshme dhe në tregun e punës, ky model e shikon marrëdhënien midis papunësisë dhe pagës minimale me të dhënat e para-COVID-19 dhe të dhënat gjatë pandemisë në vitin 2020. Rezultatet tregohen në Tabelën 2.

Tabela 2. Analizë e thjeshtë e regresionit OLS para pandemisë dhe gjatë pandemisë

Variablat e pavarura	Para pandemisë të COVID-19 (2016-2019)	Gjatë pandemisë me COVID-19 (Q1-Q3 2020)
Paga minimale	-745** (46.59796)	-573.333** (70.78996)
Ndërhyrja	142375** (7233.949)	111533** (10989.56)
Vëzhgimet	80	15
R-sq	0.7632	0.8219
Gabimet standarde të koeficientëve të vlerësuar janë raportuar në kllapa. * I rëndësishëm në nivelin 0.05 ** I rëndësishëm në nivelin 0.01 *** I rëndësishëm në nivelin 0.001		

Para pandemisë:

papunësia(mijëra)= 142375-745(pagaMin)

Para pandemisë me COVID-19, me një pagë minimale prej 0 €, nivelet e papunësisë në mijëra janë vlerësuar në 142,375; megjithatë, me një rritje prej 1 € në pagën minimale, papunësia pritet të ulet për 745.

Gjatë pandemisë:

papunësia(mijëra) = 111533-573.333(pagaMin)

Çrregullimi i shkaktuar nga pandemia COVID-19 në tregun e punës tregon se pa pagë minimale nivelet e papunësisë në mijëra llogariten në 111,533; megjithatë, me një rritje prej 1 € në pagën minimale, papunësia pritet të ulet për 573. Megjithatë, rezultatet e analizës gjatë pandemisë me COVID-19, përfshijnë vetëm 15 vëzhgime, duke e bërë të vështirë përgjithësimin bazuar vetëm në një mostër të vogël.

Megjithatë, është e rëndësishme që analiza të përfshijë çrregullimin në ekonomi dhe në tregjet e punës që ka ardhur nga pandemia me COVID-19, si pikë referimi, edhe nëse rezultatet nuk mund të përgjithësohen.

Kjo analizë tregon qartë se paga minimale aktualisht nuk ndikon negativisht në nivelin e papunësisë. Duke parë tregun e punës në Kosovë në pesë vitet e fundit, modelet e regresionit tregojnë se paga minimale ka një efekt negativ në papunësi. Ndikimi i pagës minimale në papunësi është i ndryshëm për variabla të ndryshëm të varur, fillimisht duke analizuar papunësinë në tërësi dhe më pas nga papunësia e grave. Për më tepër, gjatë vitit 2020, pandemia me COVID-19 ka ndikuar në tregun e punës dhe ajo reflektohet edhe në model, duke treguar se ulja e papunësisë nga paga minimale është bërë para pandemisë. Megjithatë, në të gjitha modelet e trajtuara, ndikimi i pagës minimale është identifikuar si ulje e papunësisë.

Mangësitë e modelit, që rrjedhin nga thjeshtësia e modelit, madhësia e vogël e mostrës dhe mungesa e më shumë variablave të përfshirë, mbeten të vlefshme. Modeli nuk trajton një aspekt të rëndësishëm të pagës minimale, atë të dallimeve midis të rinjve nën 35 vjeç dhe pjesës tjetër të popullsisë mbi 35 vjeç, i cili përfshihet si diferencë në vetë pagën minimale. Një model më i fortë do të kontrollonte për të rinjtë, ndërsa në të njëjtën kohë do të kontrollonte dallimet në rezultatet gjinore dhe shqetësimet tjera në treg. Mungesa e të dhënave për të dalluar ndikimin ndërmjet sektorit publik dhe atij privat i kufizon edhe opsionet për analizë.

## 4.2. NJË PROPOZIM PËR QASJEN E KOSOVËS NDAJ PAGËS MINIMALE

Një model i propozuar që mund t'i adresojë këto çështje dhe të shërbejë si formulë për përcaktimin e pagës minimale në Kosovë, është si vijon:

$$PM = \frac{4}{5} \times [(\text{Inflacioni Mesatar-Paga Mediane e Përshtatur}_{t,3}) \times (1 + \text{BPV Real Mesatar}_{t,3})]$$

$$\text{Inflacioni Mesatar - Paga Mediane e Përshtatur} = \frac{\text{PMPI}_{t,3} + \text{PMPI}_{t,2} + \text{PMPI}_{t,1}}{3}$$

ku

$$\text{PMPI} = \text{Inflacioni} - \text{Paga Mediane e Përshtatur}$$

dhe

$$\text{PMPI}_{t,3} = \frac{\text{Paga Mediane Nominale}_{t,3} \times \text{IÇK}_t}{\text{IÇK}_{t,3}}$$

$$\text{PMPI}_{t,2} = \frac{\text{Paga Mediane Nominale}_{t,2} \times \text{IÇK}_t}{\text{IÇK}_{t,2}}$$

$$\text{PMPI}_{t,1} = \frac{\text{Paga Mediane Nominale}_{t,1} \times \text{IÇK}_t}{\text{IÇK}_{t,1}}$$

dhe

$$\text{Norma Mesatare e Rritjes së BPV} = \frac{\text{NRRB}_{t,3} + \text{NRRB}_{t,2} + \text{NRRB}_{t,1}}{3}$$

$$\text{NRRB} = \text{Norma Reale e Rritjes së BPV-së}$$

dhe

$$\text{Norma Reale e Rritjes së BPV} = \frac{\text{BPV Real}_t - \text{BPV Real}_{t-1}}{\text{BPV Real}_{t-1}}$$

dhe

$$\text{BPV Real}_t = \frac{\text{BPV}_t \text{ Nominal}}{\frac{\text{IÇK}_t}{100}}$$

dhe

$$\text{IÇK}_t = \frac{K_t}{K_0} \times 100$$

Kjo pagë minimale përmbush kriteret kryesore të ILO-s për përcaktimin e pagës minimale, duke trajtuar çështjet e efikasitetit dhe barazisë, duke përdorur pagat e mesme, në vend të mesatares. Përdorimi i pagës mediane të përshtatur është një pikë referimi më e saktë për përcaktimin e pagës minimale në ekonomi, si ajo e Kosovës. Për më tepër, duke qenë se nivelet e pagave për gratë dhe të rinjtë janë më të ulëta, përdorimi i pagës mediane të përshtatur tenton të adresojë edhe pabarazitë që rrjedhin nga kjo.

Megjithatë, pengesa e rregullimit të pagave mesatare në çmimet e vitit aktual është se llogaritja do të përfundojë gjithmonë duke përdorur ose normën vjetore të inflacionit të një muaji të caktuar (p.sh. shtator 2021) ose normën mesatare të inflacionit midis muajit janari dhe shtator 2021). Duke e bërë të pamundur përdorimin e mesatares vjetore, thjesht sepse duam çmimet e vitit aktual.

Sipas ILO-s, për të marrë në konsideratë standardin e jetesës gjatë përcaktimit të pagës minimale, ky model e trajton si rritjen ekonomike ashtu edhe standardin e jetesës, nëpërmjet ndryshimeve të çmimeve, duke përdorur kështu rritjen reale të BPV-së dhe jo rritjen nominale.

Për më tepër, duke pasur parasysh situatën aktuale ku rregullimet e pagës minimale janë vonuar prej kohësh, një model dinamik që është vetërregullues është i rëndësishëm. Duke marrë parasysh dinamikën aktuale të tregut të punës, periudha e propozuar për përshtatje është 3 vjet. Megjithatë, kjo periudhë mund të zgjatet maksimalisht deri në 5 vjet, nëse ekonomia tregon një rritje të qëndrueshme dhe jo me shumë luhatje, në të ardhmen.

Së fundi, meqenëse ndryshimet janë të larta dhe numri i dhënë mund të përfshijë pikë decimale, përkatësisht euro cent, për arsye praktike, ne rekomandojmë që paga minimale përfundimtare të rrrumbullakohet deri në vlerën tjetër të shifrës së dytë para pikës decimale. Për shembull, nëse paga minimale e përcaktuar nga formula është € 218.52, ne rekomandojmë të bëhet € 220.

### 4.3. NJË SHEMBULL NUMERIK I KËTIJ MODELI

Për të treguar nivelin e saktë të pagës minimale që rrjedh nga ky model, ne ofrojmë një shembull numerik, siç tregohet në Tabelën 3. Të dhënat për pagën e mesme mesatare janë marrë nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) dhe përfshijnë të gjithë fituesit e pagës. Normat reale të rritjes së BPV-së, janë marrë nga baza e të dhënave të Bankës Botërore, të disponueshme publikisht.

Pra, nëse paga minimale do të ndryshonte këtë vit, bazuar në formulën tonë, ajoduhettëjetëtëpaktën €254.1.

Nëse rekomandimi ynë i fundit zbatohet, për arsye praktike, atëherë kjo do të rrumbullaksohet në €260. Korrigjimet e inflacionit janë bërë duke përdorur normën vjetore të IÇK-së të raportuar në shtator (2018, 2019, 2020 dhe 2021) pasi që e fundit e publikuar nga ASK-ja është nga shtatori i vitit 2021. Këtu, pagat e mesme në vitin 2018, 2019 dhe 2020, janë përshtatur sipas çmimeve në muajin shtator 2021.

Tabela 3. Përcaktimi i pagës minimale për vitin 2021 bazuar në modelin tonë

Koeficienti	Mesatarja e 2018, 2019, 2020		Paga minimale në 2021
	Mediane (e rregulluar për inflacion)	Norma e rritjes	
0.8	€315.6	0.62%	€254.1

Burimi: Llogaritjet e vetë autorëve bazuar në të dhënat e ATK-së dhe Bankës Botërore

## 5. KONKLUZIONE

Përderisa papunësia është një problem afatgjatë që duhet të adresohet vazhdimisht nga qeveria, përmirësimi i kushteve të punëtorëve të punësuar duhet të jetë gjithashtu një politikë e gjallë e çdo qeverie progresive. Paga minimale nominale në Kosovë ka stagnuar që kur është futur në zbatim dhe ne rekomandojmë që qeveria ta ngrëjë atë tani dhe periodikisht. Pas analizimit të kriterëve dhe qasjeve të ndryshme për përcaktimin e saj, ne kemi trajtuar edhe një pyetje të rëndësishme. Me një model të thjeshtë OLS, ne analizuam efektet e mundshme të rritjes së pagës

minimale në papunësi. Rezultatet tregojnë se rritja e pagës minimale në Kosovë nuk do të ketë ndikim negativ në papunësi. Prandaj, ne propozojmë një formulë specifike matematikore, e cila është dinamike dhe merr parasysh pagat e tjera dhe rritjen e përgjithshme ekonomike. Bazuar në formulën tonë dhe procedurën e rrumbullaksimit, paga minimale në vitin 2021 duhet të jetë € 260. Formula, siç shihet, merr në konsideratë pagat mediane të përshtatura për inflacion, si dhe rritjen ekonomike të përshtatur për inflacion.

## REFERENCAT

**Dickens, Richard**, (2015), How are Minimum Wages Set, IZA, World of Labour

**Ministry of Labour and Social Welfare**, (2017), Administrative instruction no. 09/2017 on setting a minimum wage in the Republic of Kosovo

**ILO**, (2015), Chapter 5: Setting and adjusting minimum wage levels

**US Department of Labor**, (2021), Minimum Wage, <https://www.dol.gov/general/topic/wages/minimumwage>

# PJESA II: MBROJTJA SOCIALE DHE POLITIKAT FISKALE

## KAPITULLI 3. ASISTENCA SOCIALE DHE PËRFITIMET NGA PAPUNËSIA

DINA VLLASALIU

### 1. HYRJE

Ky kapitull mbulon informacionin mbi skemat aktuale të asistencës sociale dhe përfitimet e papunësisë në Kosovë. Pjesa e parë fillon me shpjegimin se cilat janë skemat e asistencës sociale në përgjithësi, shtyllat e ndryshme të asistencës sociale, si dhe si janë ngritur ato në Kosovë, me theks të veçantë në Skemat e Asistencës Sociale (SAS), pavarësisht ekzistencës së skemave të tjera si, mbështetja për familjet kujdestare, subvencionet për energjinë elektrike, mbështetja për familjet me fëmijë me aftësi të kufizuara të përhershme, etj. Më tej, ai diskuton për kriteret për marrjen e ndihmës sociale në vend dhe rreziqeve që lidhen me kriteret aktuale në fuqi.

Studimi propozon një sërë rekomandimesh në lidhje me përmirësimin e ndihmës sociale:

- Rritja e mbulueshmërisë së personave që i plotësojnë kushtet përmes programeve të kontaktit dhe ulja e shpenzimeve administrative për aplikim;
- Krijimi i një fondi të solidaritetit përmes mekanizmave kontribues progresiv me punëdhënësin dhe punëtorin, si dy akterët kryesorë kontribuues, të ndjekur nga iniciativat bamirëse dhe ngritjes së fondeve nga një numër i madh i njerëzve, ku njerëzit/bizneset që kontribuojnë vullnetarisht në fondin e solidaritetit do të kualifikoheshin për skemat e uljes së taksave të biznesit ose për subvencionim të bizneseve të tyre nga ana e qeverisë.
- Krijimi i transfertave në mall ose në para për kryefamiljaren që kualifikohet për ndihmë sociale, pasi studimet kanë treguar se ndarja e fondeve për nënën mund të rrisë gjasat për shpërndarjen e duhur të fondeve, veçanërisht kur bëhet fjalë për mirëqenien e fëmijëve. Për më tepër, studimi sugjeron se mund të ndodhin transferta në mall të synuara drejt blerjes së produkteve vendore për të stimuluar njëkohësisht edhe prodhimin vendor.
- Paraqitja e një shume numerike të ndihmës sociale që u ndahet familjeve në varësi të faktit nëse familjet i përkasin Kategorisë I, ku të gjithë anëtarët konsiderohen të varur ose të paaftë për punë, ose Kategorisë II, ku të paktën një anëtar i familjes është i aftë për punë.

- Krijimi i mekanizmave për t'u larguar nga fondi i ndihmës sociale nëpërmjet programeve të rikualifikimit, krijimi i grupeve të fokusit për të identifikuar nevojat e tregut të punës në zonat rurale, subvencionet e qeverisë për punëdhënësit nëse punësojnë përfitues të ndihmës sociale dhe ofrimi i ndihmës së përshtatur për familjet nën asistencë.

Pjesa e dytë mbulon informacionin se çfarë janë përfitimet e papunësisë, si janë vendosur ato në vende të ndryshme, si dhe arsyetimin pse Kosova ka nevojë për vendosjen e përfitimeve të papunësisë, duke pasur parasysh se këto përfitime konsiderohen si një periudhë kalimtare nga papunësia në punësim. Për të siguruar këtë, studimi parashtron një sërë rekomandimesh:

- Për t'u kualifikuar për përfitimet e papunësisë, qytetarët duhet të aplikojnë për përfitime përmes agjencisë së punësimit dhe të jenë të gatshëm të marrin pjesë në trajnime profesionale për t'i ndihmuar ata në përputhjen e aftësive me kërkesën për punë.
- Studimi propozon që përfitimet e marra nuk duhet të kalojnë pagën minimale mujore në Kosovë, pasi kjo mund të shërbejë si një nxitje për të mbetur i papunë.
- Duke ndjekur praktikën më të mira nga vendet në zhvillim, kohëzgjatja e përfitimit duhet të jetë ndërmjet 5-7 muaj.
- Sanksionet duhet të zbatohen ndaj individëve shkathtësitë e të cilëve përputhen me një punë, por refuzojnë një të tillë. Për më tepër, dorëheqja vullnetare në përgjithësi nuk duhet të kualifikohet për përfitimet e papunësisë, pasi mund të shërbejë si një nxitje edhe për individët e tjerë që të largohen.



## 2. CILAT JANË SKEMAT E NDIHMËS SOCIALE? A JANË ATO EFEKTIVE NË SHËNJESTRIMIN E TË VARFËRVE?

Skemat e mbrojtjes sociale janë vendosur për të mbrojtur grupet e rrezikuara të shoqërive. Këto skema mund të ndryshojnë për nga natyra, nëse ato janë kontributdhënëse ose jokontributdhënëse. Qendra Burimore e Qeverisjes dhe Zhvillimit Social (QBQZHS) i ndan këto skema në asistencë sociale, kujdes social, sigurim social dhe politika dhe ndërhyrje në tregun e punës.<sup>33</sup> Skemat e asistencës sociale synojnë të arrijnë grupet më të varfra ose më të cenueshme të shoqërisë. Në të gjithë kombet, ndihma sociale raportohet të ketë nivelin më të lartë të mbulimit, duke mbuluar rreth 46% të popullsisë në vendet me të ardhura mesatare të ulëta dhe rreth 15% në vendet me të ardhura të ulëta. Sado ironike për qëllimin e saj, të dhënat tregojnë se më të varfërit e të varfërve nuk përfitojnë nga këto skema.

Për shembull, pasi të merren parasysh transfertat sociale, numri i përgjithshëm i njerëzve që jetojnë në varfëri është zvogluar për vetëm 3% në vendet me të ardhura të ulëta, ndërsa këto përqindje ishin 6%, 8% dhe 16% me të ardhura mesatare të ulëta, me të ardhura mesatare të sipërme, respektivisht vendet me të ardhura të larta.<sup>34</sup> International Growth Care, me informacionet e nxjerra nga disa vende, përcakton se kjo mund të jetë pjesërisht për shkak të cilësisë së dobët të të dhënave dhe informacionit të përditësuar mbi punësimin formal.<sup>35</sup>

## 3. SKEMAT E NDIHMËS SOCIALE NË KOSOVË: MËNYRA E ORGANIZIMIT

Në Kosovë, shtylla e Ndihmës Sociale është e ndarë në disa komponentë duke përfshirë a) asistencë sociale e mundësisë së fundit - Skema e Ndihmës Sociale (SNS), b) mbështetje materiale për familjet kujdestare, c) ndihmë për nevoja të jashtëzakonshme, d) subvencion për energjinë/energjinë elektrike, e) mbështetje materiale për familjet me fëmijë (të moshës 0-18 vjeç) me paaftësi të përhershme dhe f) shërbime sociale dhe familjare.<sup>36</sup> Në përgjithësi, vetëm Skema e Ndihmës Sociale (SAS) synon në mënyrë specifike uljen e varfërisë në vend, nëpërmjet transfertave në para, si dhe përfitimeve të tjera në mall dhe lirimi nga tarifatat (mbulimi i një sasi të caktuar të faturës së energjisë elektrike, lirimi nga pagesat për shërbimet

e kujdesit shëndetësor primar dhe sekondar, libra falas për arsimin fillor dhe të mesëm, lirimi nga tarifa e shkollimit për studentët, lirimi nga pagesa e taksave administrative komunale, dhe lirimi nga pagesa e shërbimeve tjera komunale),<sup>37,38</sup>.

Për t'i përmbush kriteret për ndihmë sociale në Kosovë, ekziston një procedurë e dyfishtë për secilën familje – një kriter i kategorive sipas të cilit çdo familje duhet të përmbush kriteret dhe nëse kjo arrihet, përdoret edhe testi i varfërisë, bazuar në një metodë ekonometrike, e njohur si testi i mjeteve të përafërta<sup>39</sup>.

### 3.1. EFEKTIVITETI I SNS NË KOSOVË, RREZIQET DHE PROGRESI AKTUAL

Skemat e ndihmës sociale, edhe pse të dizajnuara për të zbutur varfërinë, jo gjithmonë përfundojnë duke e bërë këtë, veçanërisht në vendet në zhvillim. Kosova nuk bën përjashtim nga ky rregull. Sipas Bankës Botërore, ka mospërputhje mes profilit të varfërisë në vend dhe familjeve që marrin ndihmë sociale. Siç thuhet në raport, rreth 20% e familjeve me më shumë se 5 anëtarë konsiderohen të varfra dhe megjithatë vetëm rreth 5%-8% e tyre marrin ndihmë sociale.

Raporti më tutje përcakton se ky mbulim i pashënjestruar mund të jetë për shkak të një morie arsyesh, disa prej tyre duke përfshirë a) kriterin e të pasurit një fëmijë më të vogël se 5 vjeç për t'u kualifikuar, përjashton shumë familje me fëmijë të moshës shkollore, b) punësimi i një familjari mund të rezultojë në përjashtim, mirëpo individ mund të mos fitoj mjaftueshëm për të kaluar pragun e varfërisë dhe c) testi i varfërisë nuk synon domosdoshmërisht familjet më të varfëra meqë formula e përdorur aktualisht mund të kërkojë saktësi statistikore<sup>40</sup>.

Që nga viti 2020, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (tani në kuadër të Ministrisë së Financave) e ka përditësuar "Koncept-dokumentin" me qëllim të riorganizimit të SAS në Kosovë. Nëse plani do të ecë

<sup>33</sup> Types of Social Protection. Governance and Social Development Resource Centre. <https://gsdrc.org/topic-guides/social-protection/types-of-social-protection/>

<sup>34</sup> Do Social Assistance Programs Reach the Poor? Micro-Evidence from 123 Countries. International Growth Care (2020). <https://www.theigc.org/reader/do-social-assistance-programmes-reach-the-poor-micro-evidence-from-123-countries/yes-the-poorest-are-left-behind/>

<sup>35</sup> Ibid.

<sup>36</sup> Legislation in the Official Gazette of the Republic of Kosovo

<sup>37</sup> Administrative Instruction No.15/2012 on the Calculation of Monthly Social Assistance Amount

<sup>38</sup> Kosovo Social Assistance Scheme Study. World Bank Group (2019) <https://documents1.worldbank.org/curated/en/994991557470271998/pdf/Kosovo-Social-Assistance-Scheme-Study-Assessment-and-Reform-Options.pdf>

<sup>39</sup> Ibid.

<sup>40</sup> Ibid.

përpara, ka një numër synimesh që do të mundohet t'i realizoj, e që rezultojnë kryesisht nga raporti i Bankës Botërore i vitit 2019:


- Heqja e filtrave të bazuar në kategori;
- Përzgjedhja e përfituesve përmes një testi të ri të varfërisë
- Futja e një shkalle më ekuivalente dhe rritja e shtesave për fëmijë nga 5 euro në 10 euro në muaj, për çdo fëmijë nën moshën 18 vjeç;
- Angazhimi i personave që janë në SNS në programe punësimi, trajnime profesionale, programe qeveritare dhe të ngjashme për t'u siguruar që ata t'i shpëtojnë ciklit të të qenurit në përfitime sociale për një periudhë të gjatë<sup>41</sup>.

Grafiku i mëposhtëm paraqet një ndarje të të ardhurave mesatare mujore të marra nga familjet si

ndihmë sociale, nga viti 2013 deri në vitin 2020. Për shembull, në vitin 2013, një familjeje që përfitonte ndihmë sociale i janë ndarë mesatarisht 74.52 euro, ndërsa në vitin 2020 ky numër ishte 158.25 euro. Ndonëse kjo është dëshmi e rritjes së shpërndarjes gjatë viteve, fakti që formula nuk e llogarit inflacionin, e bën programin e ndihmës sociale jo aq efektiv në luftën kundër varfërisë.

Veç kësaj, një studim i fundit i kryer nga Instituti Demokratik i Kosovës (IDK)<sup>42</sup>, tregon se që nga muaji korrik 2020 kanë qenë rreth 20, 876 individë (prej 3,000,000 € të ndara nga buxheti, janë shpenzuar 2,713,880 €) që kanë aplikuar për 130 € ndihmë mujore sipas masës 15 të Pakos Emergjente Fiskale. Duke e pasur parasysh këtë informacion shtesë, është thelbësore që skemat e ndihmës sociale të kenë përparësi.

Figura 1. Të ardhurat mesatare mujore (në €) të familjeve që marrin ndihmë sociale



Burimi: Për llogaritjet e autorit. Të dhënat janë marrë nga Ministria e Financave dhe Transfereve

#### 4. NJË PROPOZIM PËR REFORMIMIN E SKEMËS SË NDIHMËS SOCIALE

Në këtë situatë, ky studim parashtron një numër të politikave për të siguruar një shpërndarje, targetim dhe mbulim më të mirë për të varfërit që kanë nevojë për asistencë sociale, ndërkohë që institucionalizon programe efikase për të ndihmuar këto grupe të cenueshme që të shpëtojnë nga rreziku i varfërisë.

Këto përfshijnë rritjen e mbulimit të personave të kualifikuar, krijimin e një programi ndihme që shërben si një nxitje për t'u larguar nga asistencë sociale, shmangien nga rreziku i varfërisë nëpërmjet transfertave të kushtëzuara të parave dhe sigurimin e alokimit të duhur të fondeve.

<sup>41</sup> Ibid.

<sup>42</sup> Pakoja Fiskale Emergjente. Analize e Shkurter. KDI (2020) <https://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/2020/08/50-Analiz%C3%AB-e-Shkurt%C3%ABr-e-Pakos-Fiskale-Emergjente-ALB-02.pdf>

#### 4.1. SHUMA NUMERIKE E ALOKUAR

Duke e pasur parash situatën aktuale ekonomike dhe nivelin e çmimeve, ky studim e paraqet idenë se çdo familje duhet të ketë një sasi minimale të asistencës sociale, në varësi të kategorisë që i takon. Më poshtë është paraqitur një përshkrim i shkurtër:

- Për familjet që i përkasin Kategorisë I, ku të gjithë anëtarët e familjes konsiderohen të varur dhe të paaftë për punë, çdo anëtar i familjes duhet t'i ndahen minimalisht 3 €/ditë, për një total prej 90 €/muaj për anëtar. Nëse familja ka persona të mitur, fondet do të transferohen në llogarinë financiare të nënës.
- Për familjet që i përkasin Kategorisë II, ku të paktën një person është i aftë për të punuar, duhet të ndahen minimalisht 3 €/ditë për çdo anëtar të familjes, për një total prej 90 €/muaj për anëtar, nëse totali për familje nuk e kalon vlerën prej 220 €/muaj, me arsyetimin se ndihma duhet të jetë ende më e vogël se paga minimale. Nëse familja përbëhet nga personat e mitur, fondet duhet të transferohen në llogarinë financiare të nënës. Veç kësaj, nëse anëtari(-ët) e aftë të familjes gjejnë punë, ata megjithatë duhet të marrin ndihmë sociale nëse paga e tyre mujore është më e vogël se paga minimale, ku të ardhurat totale të garantuara si nga ndihma ashtu edhe nga punësimi janë të barabarta me një prag të Garancisë Minimale të të Ardhurave (GMA). Nëse një anëtar i familjes punësohet dhe paguhet deri në 33% mbi pagën minimale (rreth 300 €/muaj), ndihma sociale do t'i ndërpritet vetëm këtij anëtari, ndërsa ndihma duhet të vazhdojë për anëtarët e tjerë që janë të papunë.<sup>43</sup>

#### 4.2. RRITJA E MBULIMIT TË PERSONAVE QË I PLOTËSOJNË KRITERET

Në Kosovë, ka dëshmi të mospërputhjes mes popullatës që jeton në varfëri dhe atyre që marrin ndihmë sociale<sup>44</sup>. Në përgjithësi, mospërputhjet mund të shfaqen për disa arsye, duke përfshirë mungesën e informacionit në lidhje me ekzistencën e programeve të ndihmës sociale, një proces i komplikuar i aplikimit, frika nga stigmatizimi, si dhe refuzimi për të ndryshuar gjendjen aktuale (e njohur edhe si paragjykimi i status quo-së)<sup>45</sup>. Kjo bëhet edhe më e vështirë në mesin e grupeve të cënueshme pakicë në Kosovë, në të cilat mund të ketë edhe persona analfabetë.

Për të synuar këtë problem, mund të zbatohen një sërë veprimesh, siç janë dhënë më poshtë:

- Përpjekjet për të rritur ndërgjegjësimin e njerëzve për programet e asistencës. Këto mund të bëhen përmes fushatave ndërgjegjëse, veçanërisht në vendbambimet pranë komuniteteve të cënueshme, reklamave televizive, ose përmes mesazheve informuese në kuadër të faturave të shërbimeve.
- Barrë më të ulëta administrative si, ndihma me formularët e aplikimit (veçanërisht për ata me nivele të kufizuara të shkrim-leximit), orari i përshtatshëm i zyrës, qendrat mobile për aplikim të shpërndara nëpër komuna si dhe mundësi i aplikacioneve dixhitale për ata që kanë mundësi të aplikojnë online.

#### 4.3. KRIJIMI I FONDIT/TË ARDHURAVE TË SOLIDARITETIT

Për njerëzit që kanë qenë të punësuar më parë, por papritur e gjejnë veten pa punë, mund të krijohet një program - një fond solidariteti - ku sa herë që një punëtor e gjen veten të bllokuar në varfëri (të ardhura nën pagën minimale, për shembull), mund të tërheqë mjete nga fondi i solidaritetit. Për këta persona, kjo mund të konsiderohet si ndihmë kontributdhënëse.

Fondi i solidaritetit, po ashtu mund të shtrihet për të përfshirë edhe individë të cilët janë të paaftë për të punuar për shkak të ndonjë sëmundjeje terminale (çrregullime mendore, sëmundje kronike, paftësi intelektuale)<sup>46</sup>. Në këtë mënyrë, fondi mund të shërbejë si një rrjet mbrojtës për grupet më të cënueshme të shoqërisë. Për këtë kategori financimi do të ishte ndihmë jokontributdhënëse.

Për dallim nga programet e tjera të ndihmës sociale për të cilat financimi sponsorizohet kryesisht nga qeveria, fondi i solidaritetit shumicën e financimit mund ta pranojë nga skema e kontributit progresiv, ku si punëdhënësit dhe punëmarrësit mund të kontribuojnë me një përqindje progresive nga paga në këtë fond. Vëmendje e kujdesshme duhet t'i kushtohet faktit që përqindjet e alokuara për fondin duhet të jenë mjaft të vogla për të shmangur çfarëdo efekti kthyes në drejtim të rritjes së kostove të punësimit për punëdhënësit. Veç kësaj, vetëm personat që paguhen mbi pagën minimale do të konsideroheshin të pranueshëm për të kontribuar në këtë fond.

<sup>43</sup> The rationale behind the calculations is based on prior group discussions of the authors as well as supported by literature as in the following: RSA: Providing Income Security and Supporting Return to Work. Case of France. <https://www.social-protection.org/gimi/gess/RessourcePDF.action?ressource.ressourceid=53361>

<sup>44</sup> Kosovo Social Assistance Scheme Study. World Bank Group (2019) <https://documents1.worldbank.org/curated/en/994991557470271998/pdf/Kosovo-Social-Assistance-Scheme-Study-Assessment-and-Reform-Options.pdf>

<sup>45</sup> David, Ribar. How To Improve Participation in Social Assistance Programs? (2014) <https://wol.iza.org/uploads/articles/104/pdfs/how-to-improve-participation-in-social-assistance-programs.pdf>

<sup>46</sup> Social Assistance and Social Solidarity. Quebec. <https://www.quebec.ca/en/family-and-support-for-individuals/social-assistance-social-solidarity#c67410>

Për më tepër, burime të tjera financimi mund të vijnë gjithashtu nga organizimet për grumbullimin e fondeve nga masa e njerëzve dhe iniciativat bamirëse. Kontribuesit në fond (përkatesisht, ndërmarjet) mund të inkurajohen më pas që të vazhdojnë të kontribuojnë nëpërmjet skemave të mundshme të lehtësimeve tatimore ose programeve të subvencionimit për të cilat mund të aplikojnë për të ndihmuar përpërimin e biznesit të tyre.

#### 4.4. PAGESA PËR MIRËQENIE – DALLIMI SIPAS GJINISË: MUNDËSITË DHE RREZIQET

Tradicionalisht, pagesat e asistencës sociale, veçanërisht në vendet në zhvillim, i jepen kryefamiljarit, i cili sipas normave shoqërore ka qenë gjithmonë babai. Në një studim të kryer në Brazil, nga fillimi i viteve 1990, ka prova që të ardhurat e pafituara që u jepen nënave, kanë një efekt më të fortë në shpërndarjen e parave që shkojnë drejt mirëqenies dhe zhvillimit të fëmijës, duke rritur kështu probabilitetin e mbijetesës së këtij të fundit<sup>47</sup>. Qeveria braziliane ka prezantuar gjithashtu një program 10 vjeçar të parave të kushtëzuara, të quajtur Bolsa Familia, i cili transferon financat e mirëqenies te nëna e një familjeje. Kjo ndarje e orientuar nga gjinia është dëshmuar efektive në Brazil dhe ka treguar rezultate pozitive në rritjen e vijimit në shkollim dhe përmirësimin e kontrolleve të rregullta shëndetësore të fëmijëve<sup>48</sup>.

Një studim tjetër i kryer duke përdorur prova të kontrolluara të rastësishme në pjesët rurale të Burkina Faso, tregon prova se ndërsa ndarja e mirëqenies për nënat çon në regjistrimin në shkollat e larta, dhënia e parave të gatshme për babain çon në rritjen e pronësisë së bagëtive, prodhim më të lartë bujqësor dhe rritje të investimeve në pajisjet shtëpisë<sup>49</sup>.

Mirëpo, dëshmitë ekzistuese të korrelacionit pozitiv midis grave përfituese të mirëqenies dhe a) probabilitetit të përmirësuar të mbijetesës së një fëmije, b) shkallës më të lartë të vijimit të shkollimit dhe c) vizitave të kontrollit shëndetësor, mund të shërbejnë si një bazë motivuese për zbatimin e një politike përmes Skemës së Ndhmës Sociale (SNS) në Kosovë. Duke qenë se së fundmi qeveria ka krijuar një mundësi mbështetjeje përmes skemës së asistencës për nënat e reja dhe skemës së shtesave fëmijërore, kjo dëshmon se zbatimi i kësaj politike është ide e cila mund të realizohet.

Megjithatë, duhet pasur parasysh se studimet, rezultatet e të cilave janë ekstrapoluar këtu, janë zbatuar

në kultura të ndryshme dhe me norma të ndryshme shoqërore. Duhet të merren parasysh implikimet që mund të ketë një transfer i tillë i parave në njësinë/stabilitetin familjar në Kosovë. Tradicionalisht, babai në Kosovë shihet si mbajtësi i familjes dhe i tillë konsiderohet edhe nga normat kulturore. Çdo sfidim i këtij autoriteti mund të rezultojë me dhunë të mundshme në familje dhe të rezultojë në krijimin e arsyeve për paqëndrueshmëri brenda familjes. Ndonëse fuqizimi financiar i grave është një hap i madh përpara dhe që duhet inkurajuar, ia vlen të diskutohet edhe fakti se transfertat e asistencës sociale janë thjesht një e ardhur për jetesë dhe mund të mos u japin nënave autonomi të plotë financiare në vendimarrje.

Si i tillë, ky studim propozon që, duke mbajtur parasysh implikimet dhe rreziqet kulturore, është ndoshta koha që të merret në konsideratë transferimi i ndihmës sociale te nënat e familjes, me arsyetimin se përfundimisht mund të çojë në një alokim të synuar të fondeve drejt fëmijëve, shëndetit dhe edukimit të tyre.

#### 4.5. SIGURIMI I ALOKIMIT TË DUHUR TË FONDEVE - NË MALL KUNDREJT TRANSFERTAVE ME PARA TË GATSHME

Ekziston edhe një rrugë tjetër për t'u marrë parasysh kur bëhet fjalë për ndarjen e duhur të asistencës sociale. Ndërsa tradicionalisht argumentohet se ndihma sociale shpërndahet më së miri në formë të transfertave në para dhe jo në mall.<sup>50</sup>, vlen të eksplorohej transfertat në mall si një mundësi për të siguruar alokimin e duhur të fondeve.

Një mundësi mund të jetë që familjet që kualifikohen për ndihmë sociale të mund të marrin "bono" ose karta, si programi i bonove ushqimore në vende të ndryshme. Këto bono më pas mund të përdoren për të blerë vetëm mallra vendore. Qëllimi i kësaj politike do të ishte i dyfishtë: a) të sigurohet që familjet në nevojë të kenë këtë formë të sigurimit social dhe b) të inkurajojë prodhuesit vendorë dhe t'i ndihmojë ata të konkurrojnë me tregun ndërkombëtar duke nxitur kërkesën në vend.

<sup>49</sup> De Walque, Damien B. C. M. ; Akresh, Richard ; Kazianga, Harounan.

Evidence from a randomized evaluation of the household welfare impacts of conditional and unconditional cash transfers given to mothers or fathers (English). Policy Research working paper, no. WPS 7730, Impact Evaluation series, Paper is funded by the Knowledge for Change Program (KCP) Washington, D.C.: World Bank Group. <http://documents.worldbank.org/curated/en/944741467047531083/Evidence-from-a-randomized-evaluation-of-the-household-welfare-impacts-of-conditional-and-unconditional-cash-transfers-given-to-mothers-or-fathers>

<sup>50</sup> Jesse M. Cunha. Testing Paternalism: Cash vs. in-kind Transfers. American Economic Journal (2014). <https://www.aeaweb.org/articles?id=10.1257/app.6.2.195>

<sup>47</sup> Duncan Thomas. Intra-Household Resource Allocation: An Inferential Approach (1990). <https://ideas.repec.org/a/uwp/jhriss/v25y-1990i4p635-664.html>

<sup>48</sup> Olga Khazan. Brazil's Government Gives Money to Women Because 'They're More Reliable'. (2014). <https://www.theatlantic.com/international/archive/2014/04/brazils-government-gives-money-to-women-because-theyre-more-reliable/360336/>

#### 4.6. LARGIMI NGA NDIHMA SOCIALE: SHPËTIMI NGA RREZIKU I VARFËRISË

Një nga kritikant kryesore të programeve të ndihmës sociale është se njerëzit që marrin përfitime të tilla mbesin në një cikël varfërie. Për ta trajtuar këtë, duhet kuptuar arsyet e varfërisë. Varfëria kronike supozohet se rrjedh nga një kombinim i mundësive të dobëta për punësim, shtetësisë së kufizuar, pasigurisë, disavantazheve hapësinore dhe diskriminimit social<sup>51</sup>. Disa nga këto që u thanë shkojnë përtej qëllimit të këtij studimi, prandaj do të propozohen politika shtesë. Për shembull, masat aktive të punës duke përfshirë rikualifikimin dhe qendrat e punësimit që përputhen me shkathësitë e punëtorëve mund të zbatohen për të trajtuar komponentën e mundësive të dobëta të punësimit. Çdo individ i aftë për punë që merr ndihmë sociale mund t'i nënshtrohet programeve të detyrueshme të trajnimit/trajnimin profesional të rregullt për të përmirësuar aftësitë e veta profesionale.

Veç kësaj, grupet e fokusit mund të formohen për të identifikuar nevojat e kërkesës për punë për rajone specifike dhe në këmbim të ofrojnë mundësi trajnimi për qytetarët që jetojnë aty pranë, në mënyrë që të përputhen me aftësitë në rajon. Kjo jo vetëm që do të ndihmonte në tkurrjen e hendekut kërkesë-ofertë për punë, por gjithashtu do të ndihmonte në zbutjen e disavantazheve hapësinore që lindin për shkak të mungesës së mundësive për punë në zonat rurale.

Së treti, qeveria e Kosovës mund të ofrojë subvencione për punëdhënësit që janë të gatshëm dhe të aftë të punësojnë përfitues të ndihmës sociale. Ky subvencion mund të vijë në formën e pagesës së qeverisë për pjesën mujore të kontributeve të punëdhënësit për punëtorët për një periudhë deri në një vit, me mundësi vazhdimi. Në këtë mënyrë, kostot e punësimit për një punëdhënësit do të zvogëlohen dhe si rezultat, ata mund ta konsideronin më fitimprurës punësimin e njerëzve nën asistencë sociale. Kjo mund të kontribuojë më tej në reduktimin e stigmës që lidhet me punësimin e njerëzve që jetojnë me asistencë, por në të njëjtën kohë është një mënyrë ideale për të siguruar që përfituesit e ndihmës sociale të mos jenë të varur nga ndihma. Një politikë e ngjashme është miratuar në Turqi dhe deri më tani ka rezultuar të jetë e frytshme<sup>52</sup>.

Në fund, ndihma e përshtatur është gjithashtu e nevojshme që skemat e asistencës sociale të jenë të përkohshme. Përfaqësuesit që punojnë me familjet individuale për të kuptuar situatën e tyre të saktë që i ka futur në rrezik të varfërisë mund të ndihmojnë rreth identifikimit të temave të përbashkëta

të varfërisë, të cilat si rezultat mund të ndihmojnë politikëbërjen në kuptimin më të mirë të faktorëve të varfërisë në vend si dhe adresimin e tyre.

### 5. PËRFITIMET NGA PAPANËSIA

#### 5.1. CILAT JANË PËRFITIMET NGA PAPANËSIA? A JANË ATO EFEKTIVE?

Një nga llojet e mbrojtjes sociale janë edhe përfitimet nga papunësia. Në varësi të mënyrës se si i ka strukturuar shteti, këto përfitime mund të jenë kontributdhënës dhe jokontributdhënës. Nëse nuk janë kontributdhënës, ato shpesh financohen nga taksat e qytetarëve ose taksat e punëdhënësve dhe më pas rishpërndahen në familjet me të ardhura të ulëta me persona të papunë. Nëse janë kontributdhënës, janë të formës së sigurimit të papunësisë, ku personi i papunë kontribuon financiarisht në sigurimin e tij/saj për papunësinë<sup>53</sup>.

Si të tilla, përfitimet e papunësisë mund të jenë ose të formës së a) Asistencës së papunësisë - AP (ose përfitimet) synohen drejt uljes së varfërisë për familjet dhe b) Sigurimi i papunësisë - SP synohet për një individ që rishtazi ka dalë nga tregu i punës<sup>54</sup>. Për shkak se ato janë thelbësisht të ndryshme nga njëra-tjetra, ka kontraste të dalluara midis efekteve të tyre, veçanërisht në kohëzgjatjen afatshkurtër. Marrësit e SP mund të jenë fitues me të ardhura të larta, por gjithësi marrin sigurim papunësie nëse e gjejnë veten të papunë. Përfituesit e AP nga ana tjetër janë të kufizuar vetëm për familjet që konsiderohen me të ardhura të ulëta pasi kanë kaluar një test të mjeteve. Megjithatë, këto dallime prirën të shtrembërohen sa më gjatë një person mbetet i papunë. Për shkak të kësaj, zakonisht një vend zbaton AP dhe SP për të siguruar veprim kundër varfërisë<sup>55</sup>.

Përfitimet e papunësisë shërbejnë si një rrjet sigurie që shoqëria të mos bjerë në rrezikun e varfërisë. Megjithatë, duhet mbajtur parasysh se këto përfitime duhet të synohen dhe zbatohen në mënyrë të tillë që të mos rrezikohet mundësia që përfituesit të bien nën ndikimin e një periudhe të papunësisë dhe kështu të humbasin nxitjen e tyre për të punuar. Studimet vënë në dukje një grup të ndryshëm zgjidhjesh nga politikat për të siguruar përfitime efektive të papunësisë që shënjestrojnë saktësisht të varfërit.

<sup>52</sup> Fikret Adaman and Burcay Erus. New legislation in Turkey to strengthen the link between social assistance and the labour market. (2016). file:///C:/Users/dvllasaliu/Downloads/ESPN%20-%20Flash%20Report%202016-40%20-%20TR%20-%20July%202016.pdf

<sup>53</sup> Types of Social Protection. Governance and Social Development Resource Centre. <https://gsdrc.org/topic-guides/social-protection/types-of-social-protection/>

<sup>54</sup> Wayne Vroman. Unemployment Insurance and Unemployment Assistance. (2002). <https://documents1.worldbank.org/curated/en/411271468769849695/pdf/multi0page.pdf>

<sup>55</sup> Ibid.

<sup>51</sup> Chronic Poverty Research Centre. Social Assistance and the Dependency Syndrome (2011). <https://www.files.ethz.ch/isn/127203/PB%2022.pdf>

Disa prej tyre përfshijnë a) kohëzgjatjen e përfitimeve të papunësisë dhe lidhjen e tyre direkte me kohëzgjatjen e punësimit për përfituesin dhe b) normën neto të zëvendësimit të fitimeve të mëparshme gjatë rishpërndarjeve për papunësinë<sup>56</sup>.

## 5.2. TREGU I PUNËS NË KOSOVË DHE MOSEKZISTIMI I PËRFITIMEVE TË PAPUNËSISË

Kosova karakterizohet me shkallë të lartë të papunësisë, veçanërisht në mesin e të rinjve dhe grave. Krahasuar me rajonin e Ballkanit Perëndimor, Kosova ka shkallën më të ulët të pjesëmarrjes së grave (20.8%) dhe shkallën më të lartë të papunësisë tek të rinjtë (49.4%). Për më tepër, një përqindje e lartë e njerëzve që punojnë në punë të pakualifikuara dhe atyre që nuk janë në punësim, arsim ose trajnim -NAPT- (32.7%) krijon një treg pune të paqëndrueshëm dhe zhvillim të kapitalit njerëzor të kualifikuar<sup>57</sup>. Që nga fillimi i pandemisë me COVID-19, kjo situatë me siguri është përkeqësuar dhe efektet e saj përhapëse ende duhet të vëzhgohen plotësisht në tregun e punës në Kosovë.

Shteti i ka bërë disa përpjekje për të synuar grupet e cenueshme kur bëhet fjalë për nxitjen e punësimit. Për shembull, ka miratuar Planin e Veprimit për Punësimin e të Rinjve 2018-2020, i cili pjesërisht për shkak të pandemisë dhe pjesërisht për shkak të zbatimit të masave nuk ka rezultuar në asnjë masë efektive drejt uljes së papunësisë. Por, ka individë që kanë përfituar nga Politikat Aktive të Tregut të Punës (PATP)- rreth 8,694- dhe në vitin 2019 rreth 5,138 individë kanë përfituar nga Qendrat e Aftësimin Profesional (QAP) nëpërmjet programeve të tyre të praktikës<sup>58</sup>. Megjithatë, këto shifra janë të vogla për shënjestrimin e papunësisë në Kosovë dhe për të siguruar që ata që janë në rrezik nga varfëria me të vërtetë mund t'i shpëtojnë asaj.

Ajo që është edhe më shqetësuese është fakti se Kosova nuk ka masa pasive të tregut të punës – qoftë asistencë për papunësinë apo sigurim për shkak të papunësisë – për të siguruar një rrjet sigurie për ata që papritur kanë mbetur të papunë ose kanë qenë të tillë për një kohë<sup>59</sup>. Kur merren parasysh zhvillimet më të fundit në ekonomi që i atribuohen pandemisë me COVID-19 dhe masave të karantinës, mungesa e përfitimeve të papunësisë vetëm sa e ka përkeqësuar gjendjen te grupet e cenueshme të shoqërisë dhe i ka ekspozuar këto grupe edhe më shumë ndaj cenueshmërisë dhe pa ndonjë mbështetje në të ardhura<sup>60</sup>.

## 5.3. PROPOZIMI PËR FUTJEN E PËRFITIMEVE TË PAPUNËSISË NË KOSOVË

Për shkak se përfitimet e papunësisë mungojnë në vend, ky studim fillimisht propozon që të krijohet një fond i tillë për të ndihmuar të papunët e për-kohshëm (apo edhe ata afatgjatë) të arrijnë njëfarë sigurie financiare. Kjo veçanërisht pas vitit 2020 me pandeminë me COVID-19, që ka shkaktuar një rritje të shkallës së papunësisë.

Megjithatë, si hap i parë, është thelbësore të sigurohet që çdo person i papunë të regjistrohet në zyrën e punësimit përpara se të kualifikohet për përfitime.

Kjo është veçanërisht e nevojshme duke pasur parasysh dinamikën e të papunëve në Kosovë. Siç tregon Figura 1, përderisa numri i individëve të papunë në vitin 2020 arriti në 90,250, vetëm 58,488 (64.8%) janë të regjistruar si të papunë në Agjencinë e Punësimit në Kosovë. Ndërsa kjo përqindje është mjaft gjithëpërfshirëse në raport me vitet e tjera (në vitin 2019 janë regjistruar 26% e të papunëve; në vitin 2018 24,4%, në 2010 vetëm 0,08%), mirëpo ka ende vend për përmirësim.

<sup>56</sup>European Semester Thematic Factsheet. Unemployment Benefits. [https://ec.europa.eu/info/sites/default/files/file\\_import/european-semester\\_thematic-factsheet\\_unemployment-benefits\\_en\\_0.pdf](https://ec.europa.eu/info/sites/default/files/file_import/european-semester_thematic-factsheet_unemployment-benefits_en_0.pdf)


<sup>57</sup>Evelyn Viertel., Politikat për zhvillimin e kapitalit njerëzor, Kosovë. Një vlerësim i Procesit të Torinos, ETF, Torino (2020) në dispozicion në <https://www.etf.europa.eu/en/publications-andresources/publications/policies-human-capital-development-kosovo-etf-torino>.

<sup>58</sup>Artane Rizvanolli, Ardiana Gashi dhe Laurie Joshua. Masat aktive të tregut të punës: A janë ato mjete efektive për adresimin e sfidave të Kosovës për aftësi dhe punësim? Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) Prishtinë (2019). Në dispozicion në <https://yesforkosovo.org/wp-content/uploads/2019/12/Report-ENG.pdf>

<sup>59</sup> Kosovë Zhvillimet e Arsimit, Trajnimit dhe Punësimit 2020. Fondacioni Evropian i Trajnimit. <https://www.etf.europa.eu/sites/default/files/document/Country%20Fiche%202020%20Kosovo%20Education%20Training%20and%20Employment%20Developments.pdf>

<sup>60</sup> COVID-19 ka sfiduar familjet dhe bizneset e Kosovës në shumë mënyra – Vlerësimi i dytë i Ndikimit socio-ekonomik i ekipit të OKB-së në Kosovë. UNDP (2020). <https://kosovoteam.un.org/en/108425-covid-19-has-challenged-kosovos-households-and-businesses-many-ways-un-kosovo-teams-second>

Figura 1. Individët e papunë kundrejt individëve të papunë të regjistruar



Burimi: Agjencia e Punësimit e RKS

Nëse përcaktohet saktë, kjo po ashtu mund të ndihmojë të papunët që të mos qëndrojnë të papunë për një kohë të gjatë, nëpërmjet përmirësimit të aftësive të atyre që janë të regjistruar, si dhe përshtatjes së shkathtësive të punës me kërkesën e mundshme për punë. Skema e konfigurimit mund të ndjekë procedurën e mëposhtme:

- 1 Përcaktimi i kriterëve kualifikuese për përfitimin: a) kohëzgjatja e punësimit të mëparshëm dhe b) arsyeja e ndërprerjes së punës së mëparshme, duke supozuar se ishte ndërprerje e njëanshme nga ana e punëdhënësit. Lënia e punës në përgjithësi nuk duhet të kualifikohet për marrjen e përfitimeve të papunësisë, pasi mund të krijojë efekte të kundërta në stimujt për ta lënë punën.
- 2 Regjistrimi i detyrueshëm për të papunët e kualifikuar në Agjencinë e Punësimit.
- 3 Faza e përputhjes së aftësive: regjistrimi dhe ndjekja e trajnimeve profesionale nga të papunët si kusht i domosdoshëm për t'u kualifikuar për asistencë.
- 4 Zbatimi i sanksioneve nëse një person i papunë përshtatet me një punë, por refuzon punën ose nëse ai nuk merr pjesë në aktivitete/trajnime për rritjen e aftësive. Sanksionet mund të variojnë duke filluar nga ulja e përfitimeve të papunësisë e deri te mospërshtatshmëria për përfitime të mëtejshme.
- 5 Riaplikimi për asistencë nëse është e nevojshme.

Duhet theksuar se para se të bëhet alokimi duhet të merren vendime, fillimisht për shkallën e zëvendësimit - shumën e kompensimit të përfitimeve të papunësisë të marra si përqindje e pagës mesatare kur personi ka qenë i punësuar. Duhet pasur kujdes këtu kur llogariten përfitimet mujore të papunësisë - këshillohet që përfitimet e marra të jenë më të ulëta se paga minimale në Kosovë, pavarësisht nga të ardhurat e përfituesve në vendet e tyre të mëparshme të punës. Arsyetimi pas kësaj është i thjeshtë: punëtorët inkurajohen të kërkojnë punë, qoftë edhe një që paguhet me një pagë minimale, sesa të qëndrojnë të papunë nën sigurinë e përfitimeve të papunësisë.

Vëmendje duhet t'i kushtohet gjithashtu kohëzgjatjes së përfitimit të papunësisë - vlerat mesatare për vendet në zhvillim ndryshojnë prej 5.8-6.4 muaj<sup>61</sup>. Kosova mund të fillojë duke aplikuar praktikat më të mira nga vendet tjera. Financimi i përfitimeve të papunësisë mund të jetë si nga qeveria, ashtu edhe nga punëdhënësi dhe punëtori për sa i përket një sigurimi papunësie (SP), nëse punëtori gjendet ndonjëherë jashtë tregut të punës.

<sup>61</sup> Antonia Asenjo and Clemente Pignatti. Unemployment Insurance Schemes Around the World: Evidence and Policy Options. International Labour Office. (2019) <http://sarkoups.free.fr/ilo723778.pdf>

## 6. KONKLUZIONE

Ky kapitull ka elaboruar programet aktuale të asistencës sociale në Kosovë, rreziqet, si dhe ka propozuar mënyra të cilat mund të ndihmojnë për një shpërndarje më të mirë dhe më efikase të burimeve financiare për personat në nevojë. Rekomandimet e propozuara përfshijnë a) rritjen e mbulimit të përshtatshmërisë, b) vendosjen e transfertave në mall dhe në para me shpërndarjen e fondeve të synuara drejt nënës, si njësisia kryesore e familjes, dhe me transfertat në mall që përdoren për blerjen e prodhimeve vendore, c) formimi i mekanizmave të tillë si programet e rikualifikimit dhe studimi i tregut në grupe fokusi për të identifikuar zbrazëtitat në ofertën-kërkesën e punës për të siguruar që asistencën sociale të jetë një zgjidhje afatshkurtër dhe jo një zgjidhje gjatë gjithë jetës, d) krijimi i një fondi të solidaritetit përmes mekanizmave kontribues progresiv dhe donacioneve vullnetare, dhe e) një shumë e propozuar për alokimin e asistencës sociale mujore, në varësi të kriterëve kualifikuese.

Më pas, kapitulli është zgjeruar mbi nevojën për të vendosur përfitime të papunësisë për Kosovën, duke u fokusuar në praktikën më të mira nga vendet e tjera.

Kjo pjesë ka theksuar nevojën e regjistrimit të të papunëve në agjencinë e punësimit, duke u siguruar që të gjithë që marrin përfitime të papunësisë të jenë gjithashtu në kërkim aktiv të një pune dhe të ndjekin trajnime profesionale për t'u përshtatur me një punë të mundshme. Tutje, ka shtjelluar gjithashtu nevojën për t'i bërë këto përfitime një zgjidhje afatshkurtër duke zbatuar sanksione/reduktim të përfitimeve, si dhe duke i bërë ato të skadueshme (përfitimet mesatare të papunësisë në vendet në zhvillim zgjasin prej 5-7 muaj). Së fundmi, propozimi përfshin nevojën për t'u siguruar që përfitimet e papunësisë që merren çdo muaj të jenë më të ulëta se paga minimale e vendit, në mënyrë që të stimulohet kërkimi i punës në mënyrë aktive.

Në përgjithësi, studimi hedh dritë mbi mekanizmat që mund të zbatohen për të garantuar një shoqëri më të drejtë, me rritje të sigurisë të ofruar për grupet e cenueshme, teksa përpiqen të shpëtojnë nga rreziku i varfërisë në mënyrë që të shfrytëzojnë mundësitë e ofruara.



## REFERENCAT

**Administrative Instruction No.15/2012** on the Calculation of Monthly Social Assistance Amount

**Artane Rizvanolli, Ardiana Gashi, and Laurie Joshua.** Active labour market measures: Are they effective tools for addressing Kosovo's skills and employment challenges? Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) Prishtina (2019).

**Chronic Poverty Research Centre.** Social Assistance and the Dependency Syndrome (2011).

**COVID-19** has challenged Kosovo's households and businesses in many ways – UN Kosovo Team's second Socio-Economic Impact Assessment. UNDP (2020).

**David, Ribar.** How To Improve Participation in Social Assistance Programs (2014)?

**De Walque, Damien B. C. M. ; Akresh, Richard ; Kazianga, Harounan.**

**Do Social Assistance Programs Reach the Poor?** Micro-Evidence from 123 Countries. International Growth Care (2020).

**Duncan Thomas.** Intra-Household Resource Allocation: An Inferential Approach (1990).

**European Semester Thematic Factsheet.** Unemployment Benefits.

**Evelyn Viertel.,** Policies for human capital development, Kosovo. A Torino Process assessment, ETF, Turin (2020)

Evidence from a randomized evaluation of the household welfare impacts of conditional and unconditional cash transfers given to mothers or fathers (English). Policy Research working paper, no. WPS 7730, Impact Evaluation series. Paper is funded by the Knowledge for Change Program (KCP) Washington, D.C.: World Bank Group.

**Fikret Adaman and Burcay Erus.** New legislation in Turkey to strengthen the link between social assistance and the labour market. (2016).

**Jesse M. Cunha.** Testing Paternalism: Cash vs. in-kind Transfers. American Economic Journal (2014).

**Kosovo Social Assistance Scheme Study.** World Bank Group (2019)

**Kosovo.** Education, Training, and Employment Developments 2020. European Training Foundation.

**Olga Khazan.** Brazil's Government Gives Money to Women Because 'They're More Reliable'. (2014)

**Pakoja Fiskale Emergjente.** Analize e Shkurter. KDI (2020)

**RSA:** Providing Income Security and Supporting Return to Work. Case of France (2016).

**Social Assistance and Social Solidarity.** Quebec.

**Types of Social Protection.** Governance and Social Development Resource Centre.

**Wayne Vroman.** Unemployment Insurance and Unemployment Assistance. (2002).

# KAPITULLI 4. PABARAZIA NË TË ARDHURA DHE POLITIKAT FISKALE

EDISON JAKURTI

## 1. HYRJE

Rritja e pabarazisë së të ardhurave për shumë vende të botës nuk është më ndonjë lajm. Ekziston një literaturë në rritje që tregon madhësinë dhe ashpërsinë e saj dhe përpiqet të diagnostikojë shkaqet e saj. Fatkeqësisht, një debat i tillë nuk ka gjetur vend në sferën e diskutimeve publike në Kosovë. Në të vërtetë, këtu varfëria mbetet tema më e theksuar. Por, varfëria shpesh shoqërohet edhe me nivele të larta të pabarazisë ekonomike. Prandaj, është detyrë e çdo qeverie progresive të përdorë të gjitha fuqitë e saj për të trajtuar jo vetëm simptomat, por veçanërisht edhe shkaqet e pabarazisë së pasurisë dhe të ardhurave.


Në këtë kapitull, për herë të parë, ne ofrojmë një pasqyrë të detajuar të pabarazisë së të ardhurave në Kosovë. Në mënyrë të veçantë, duke pasur parasysh disponueshmërinë e të dhënave, ne fokusohemi në pabarazinë dhe shpërndarjen e të ardhurave nga puna. Më tej, ne analizojmë shkallën e progresivitetit dhe fuqinë rishpërndarëse të sistemit aktual të tatimit mbi të ardhurat personale. Duke qenë se të gjithë treguesit tregojnë se ka mjaft hapësirë për përmirësim, ne propozojmë një taksë të re mbi të ardhurat personale (si për pagamarrësit parësor ashtu edhe për ata dytësorë), një taksë të re mbi të ardhurat e korporatave (për të gjitha nivelet e të ardhurave) dhe futjen e një tatimi në dividendë.

## 1. TRENDET E PABARAZISË SË TË ARDHURAVE NË KOSOVË

Përderisa mungesa e të dhënave ose vështirësia për t'i siguruar ato mbeten sfiduese, ka pasur përpjekje për të vlerësuar trendet e pabarazisë së të ardhurave në Kosovë. Për shembull, World Inequality Database (WID), përfshin disa statistika rreth pabarazisë së të ardhurave në Kosovë. Figura 1, më poshtë tregon tendencën e pjesëve të të ardhurave para tatimit nga 10% i shkallës së lartë tatimore, 40% i shkallës së mesme tatimore dhe 50% i shkallës së ulët tatimore (e të rriturve) siç vlerësohet nga WID.

Trendet për të tria grupet kanë qenë mjaft të qëndrueshme. 50% nga grupi i ulët tatimor ka ndarë rreth 18%, 40% i grupit të mesëm ka ndarë rreth 49%, dhe 10% nga grupi i lartë tatimor ka ndarë rreth 33%. Nëse i përdorim këto tre grupe për klasa përfaqësuese, atëherë mund të shihet se klasa e mesme (d.m.th., 40%) po ecën mirë, të pasurit (10%) janë jashtëzakonisht mirë dhe të varfërit (d.m.th., 50% ose gjysma e popullsisë së rritur) nuk janë fare mirë.

Figura 1. Pjesa e të ardhurave para taksave me 10% gr. i lartë, 40% gr. i mesëm dhe 50% gr. i ulët 2003-2019



Megjithatë, këto vlerësime dhe ekstrapolime nga WID u bazuan në të dhënat e sondazhit vetëm për konsumin, madje edhe autorët japin një rezultat "Mesatarisht të ulët" në lidhje me cilësinë e tyre<sup>62</sup>. Për më tepër, për të marrë parasysh fuqinë rishpërndarëse të sistemit aktual tatimor, nevojiten edhe trendet pas taksave. Kështu, të dhënat më të mira janë thelbësore për vlerësimin e pabarazisë.

## 2. PABARAZIA NË TË ARDHURAT NGA PUNA

Për të kuptuar më mirë pabarazinë në Kosovë, ne kemi marrë të dhëna të detajuara tatimore për pagat, si për punëdhënësit primar ashtu edhe për ata sekondar nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK). Përderisa koncepti i pabarazisë në Kosovë duke marrë parasysh (d.m.th. të dhënat e administratës tatimore), mbulimin (d.m.th. rreth 300 mijë individë) dhe rëndësinë e tyre në të ardhurat e përgjithshme (d.m.th. pagat përbëjnë burimin më të lartë të të ardhurave për familjet dhe individët në Kosovë)<sup>63</sup>. Mirëpo, ana negative e kësaj është se mbulon vetëm ekonominë formale, duke e lënë jashtë ekonominë informale – e cila perceptohet të jetë një pjesë jo e papërfillshme.

Megjithatë, këto të dhëna janë vendimtare për vlerësimin jo vetëm të pabarazisë me paralajmërimin e sipërpërmendur, por edhe për të vlerësuar sistemin aktual të tatimit mbi të ardhurat personale nga këndvështrimi i progresivitetit dhe shpërndarjes.

## 3.1. SHPËRNDARJA E TË ARDHURAVE NGA PUNA

Tabela 1 më poshtë paraqet pagat mesatare dhe pagat mediane vjetore, bruto dhe neto, për periudhën 2016-2020, si dhe numrin e përfituesëve të pagave përmes ATK-së. Vëzhgimi i parë këtu është se si paga mesatare ashtu edhe paga mediane janë luhatur nga viti në vit<sup>64</sup>. Në përgjithësi, paga mesatare ka shënuar rritje, ndërsa ajo e mesme jo.

Në rastin kur paga mesatare është më e madhe se mediane, shpërndarja e pagave është e anuar pozitivisht (ose e anuar djathtas). Kjo do të thotë se ne kemi më shumë se gjysmën e punëtorëve që marrin një pagë më të vogël se mesatarja. Me fjalë të tjera, ka disa punëtorë me paga të larta që po e rrisin mesataren. Një lidhje e tillë është veçanërisht e rëndësishme për politikën tatimore, kur bëhet fjalë për progresivitetin dhe rishpërndarjen.

Tabela 1. Paga mesatare dhe mediane vjetore 2016-2020

Pagë	2016		2017		2018		2019		2020	
	Mesatare	Mediane	Mesatare	Mediane	Mesatare	Mediane	Mesatare	Mediane	Mesatare	Mediane
Bruto	€4,903	€3,636	€4,548	€3,291	€5,145	€3,675	€5,006	€3,600	€5,026	€3,507
Neto	€4,391	€3,331	€4,073	€3,018	€4,601	€3,360	€4,474	€3,299	€4,492	€3,214
N	280,722		323,600		315,857		350,353		372,607	

Burimi: Llogaritjet e autorit të bazuara në të dhënat nga ATK

Më tej, numri i përfituesëve të pagës përmes administratës tatimore është rritur. Nga një këndvështrim optimist, kjo mund të jetë për shkak të rritjes së punësimit ose formalizimit - ose të dyja. Nga një këndvështrim pesimist, këta mund të jenë më

shumë punëtorë të përkohshëm, punëtorë sezonalë ose punëtorë që punësohen shpejt, por nuk kanë kontrata afatgjata. Kjo çështje mbulohet në pjesën e kontrollit të qëndrueshmërisë.

<sup>62</sup> Shih Blanchet, Chancel dhe Gethin (2020).


<sup>63</sup> Bazuar në rezultatet e fundit të Anketës së Buxhetit të Ekonomive Familjare 2017, të realizuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, në vitin 2016 dhe 2017, pagat (si nga sektori privat ashtu edhe nga ai publik) ishin burimi më i rëndësishëm i të ardhurave për 51% dhe 52% të familjeve, respektivisht. Gjithashtu, në vitin 2017, 55% e të ardhurave të individëve përbëheshin nga pagat nga sektori publik dhe privat.

<sup>64</sup> Autori vlerëson dallimin ndërmjet rrogave dhe pagave, por për konsistencë me terminologjinë e përdorur nga Administrata Tatimore, është përdorur paga në të gjithë kapitullin.

### 3.2. NDARJA E TË ARDHURAVE NGA PUNA NGA 50% I ULËT, 40% I MESËM DHE 10% I LARTË

Më pas, ne zhvilluam një analizë tjetër për të parë pjesët e të ardhurave nga puna që shkojnë në 50% me shkallën e ulët tatimore, 40% me shkallën e mesme tatimore dhe 10% me shkallën e lartë tatimore<sup>65</sup>. Kjo është paraqitur në Figurën 2 më poshtë, e cila, përsëri, e mbulon periudhën ndërmjet 2016 dhe 2020.

Është e jashtëzakonshme se sa afër janë këto vlera me ato të marra nga World Inequality Data, e cila synon të masë pabarazinë e përgjithshme të të ardhurave. Përsëri, kjo konfirmon se pabarazia e të ardhurave nga puna është një tregues i mirë për pabarazinë e përgjithshme të të ardhurave në Kosovë.



Gjatë kësaj periudhe, mesatarisht, 50% i ulët ka ndarë 17.4% të të ardhurave bruto dhe 17.9% të të ardhurave neto nga puna. 40% i mesëm ka ndarë 48.7% të të ardhurave bruto dhe 48.8% të të ardhurave neto nga puna. Dhe 10% i lartë ka ndarë 34% të bruto dhe 33.3% të të ardhurave neto nga puna. Pra, tatimi mbi të ardhurat personale rrit të ardhurat nga puna të ndara nga 50% i ulët me 3.1%, rrit të ardhurat nga puna të ndara nga 40% i mesëm me 0.4%, dhe ul të ardhurat nga puna të ndara nga 10% i lartë me 2.1%. Përsëri, një shkallë rishpërndarjeje pritet nga çdo sistem tatimor progresiv, por përmasat e tij, në këtë rast, janë mjaft të vogla.

### 3.3. VLERËSIMI I PABARAZISË SË TË ARDHURAVE NGA PUNA - KOEFICIENTI GINI

Pas analizës së shpërndarjes, ne e masim pabarazinë duke vlerësuar koeficientin Gini, e cila është një nga metodat më të përdorura për matjen e pabarazisë së të ardhurave. Formalisht, koeficienti Gini përcaktohet si:

$$G_x = 1 - 2 \int_0^1 L_x(p) dp$$

ku  $x$  tregon të ardhurat dhe  $L$  është lakorja e Lorenz-it, e cila tregon shpërndarjen e të ardhurave, d.m.th., proporcioni i të ardhurave që shkon në përqindjen më të ulët të popullsisë e cila është e renditur nga përfituesi më të ardhura më të ulëta tek ai me të ardhurat më të larta. Koeficienti Gini mund të marrë një vlerë midis 0 dhe 1, ku i pari do të tregonte barazi perfekte dhe i dyti pabarazi perfekte. Ndërsa teorikisht është e mundur edhe në ekstreme, në praktikë, koeficientët janë midis këtyre dy vlerave me shifra më të larta që tregojnë më shumë pabarazi.

Tabela 2 më poshtë, i matë koeficientët Gini si për pagën bruto ashtu edhe për atë neto dhe diferencën në përqindje ndërmjet të dyjave për periudhën 2016-2020. Vëzhgimi i parë këtu është se pabarazia e të ardhurave nga puna ka qenë tashmë e lartë dhe përgjithësisht në rritje gjatë kësaj periudhe.

<sup>65</sup>Të ardhurat nga puna në këtë kapitull përkufizohen si shuma e pagave të fituara si nga punëdhënësit kryesorë (dmth. puna kryesore)

ashtu edhe nga ato dytësore (dmth. punë shtesë, zakonisht afatshkurtër). Të dhënat e ofruara nga Administrata Tatimore për ne nuk përfshinin informacion për ndonjë përfitim tjetër.

Së dyti, diferenca midis koeficientit Gini të të ardhurave bruto dhe neto nga puna është shumë e vogël. Siç pritej, nëse nuk është një sistem tatimor regresiv, koeficienti Gini i të ardhurave neto pritet të jetë më i

vogël se ai i të ardhurave bruto. Megjithatë, diferenca në përqindje është shumë e vogël, duke treguar se sistemi aktual i taksave personale ka qenë duke e ulur pabarazinë, por në shkallë pothuajse të papërfillshme.

Tabela 2. Koeficientët Gini të të ardhurave bruto dhe neto nga puna midis 2016-2020

Viti	Bruto	Neto	Ndryshimi në %
2016	0.4568	0.4478	-1.97%
2017	0.4967	0.4884	-1.67%
2018	0.4692	0.4603	-1.90%
2019	0.4927	0.4842	-1.73%
2020	0.492	0.4832	-1.79%

Burimi: Llogaritjet e autorit të bazuara në të dhënat nga ATK

#### 4. VLERËSIMI I PROGRESIVITETIT DHE EFEKTIT RISHPËRNDARËS TË SISTEMIT AKTUAL TË TATIMIT MBI TË ARDHURAT PERSONALE

Bazuar në analizën e deritanishme, ka disa indikacione se sistemi aktual i taksave personale nuk ka qenë shumë efektiv në uljen e pabarazisë. Këta tregues erdhën nga analiza e pabarazisë së të ardhurave nga puna, e cila krahasuar para dhe pas tatimit, zvogëlohet me përmasa të vogla. Pra, ne tani po bëjmë një analizë të drejtpërdrejtë të progresivitetit dhe efektit rishpërndarës të sistemit aktual të tatimit mbi të ardhurat personale. Për ta bërë këtë, ne përdorim dy indekse: indeksi<sup>66</sup> Kakwani dhe indeksi Reynolds-Smolensky<sup>67</sup>.

Për të matur progresivitetin e sistemit aktual të tatimit mbi të ardhurat personale, ne përdorim indeksin Kakwani i cili është përcaktuar zyrtarisht:

$$K_t = C_t - G_x = 2 \int_0^1 [L_x(p) - C_t(p)] dp$$

ku  $C$  është indeksi i përqendrimit të taksave  $t$  dhe  $G$  është koeficienti Gini i të ardhurave para tatimit  $x$ . Indeksi Kakwani mund të marrë një vlerë midis -2 dhe 1. Shenjat tregojnë llojin e sistemit tatimor: negative tregon sistem tatimor regresiv ndërsa pozitive tregon sistem tatimor progresiv. Madhësia tregon shkallën e pabarazisë dhe barrës tatimore: sa më e ulët vlera do të thotë se ka pabarazi më të lartë të të ardhurave dhe një barrë më të lartë tatimore që bie mbi më të varfërit, ndërsa sa më e lartë vlera do të thotë se ka pabarazi më të ulët të të ardhurave dhe një barrë më të lartë tatimore për më të pasurit.

Për të matur efektin rishpërndarës të sistemit aktual të tatimit mbi të ardhurat personale, ne përdorim Indeksën Reynolds-Smolensky i cili njihet edhe si efekti rishpërndarës (RE). Në thelb, është ndryshimi midis koeficientëve Gini para dhe pas taksave. Formalisht, RE është përcaktuar:

$$RE = G_x - G_{x-t} = 2 \int_0^1 [L_{x-t}(p) - L_x(p)] dp$$

ku  $G_{x-t}$  është koeficienti Gini pas tatimit. RE mund të marrë vlera midis -1 dhe 1. Vlerat negative tregojnë një sistem tatimor regresiv, ndërsa vlerat pozitive tregojnë një sistem tatimor progresiv. Madhësitë e secilit tregojnë shkallën në të cilën sistemi po rishpërndahet tek ata me të ardhura më të larta (nëse vlerat janë negative) ose tek ata me të ardhura më të ulëta (nëse vlerat janë pozitive).

Tabela 3 më poshtë, tregon indeksin Kakwani dhe indeksin Reynolds-Smolensky për periudhën 2016-2020. Së pari, indeksi Kakwani është pozitiv, i cili konfirmon se sistemi aktual i taksave personale është progresiv. Gjithashtu, indeksi Reynolds-Smolensky ripohon se është pozitiv. Megjithatë, në të dyja rastet magnitudat janë shumë të vogla. Ndërsa vlera maksimale potenciale e progresivitetit është 1, sistemi aktual i tatimit personal ka pasur një vlerë progresive që varion ndërmjet 0.0715 (më e ulëta) dhe 0.0779 (më e larta). Ndërkohë që vlera maksimale potenciale e një sistemi rishpërndarës është 1, gjatë periudhës së dhënë, sistemi aktual i tatimit mbi të ardhurat personale ka pasur një vlerë rishpërndarëse që varion ndërmjet 0.0083 dhe 0.0091. Prandaj, për të reduktuar pabarazinë, nevojitet një sistem më progresiv dhe rishpërndarës i tatimit mbi të ardhurat personale.

<sup>66</sup> Shih Kakwani (1977).

<sup>67</sup> Shih Reynolds dhe Smolensky (1977).

Tabela 3. Indekset Kakwani dhe Reynolds-Smolensky të sistemit të tatimit mbi të ardhurat personale midis 2016-2020

Viti	Indeksi Kakwani	Indeksi Reynolds-Smolensky
2016	0.0779	0.0091
2017	0.0717	0.0083
2018	0.0756	0.0089
2019	0.0715	0.0085
2020	0.0751	0.0089

Burimi: Llogaritjet e autorit të bazuara në të dhënat nga ATK

## 5. KONTROLLI I QËNDRUESHMËRISË

Për të kontrolluar qëndrueshmërinë e rezultateve tona, ne e bëjmë modifikimin e mostrës. Në analizën e mëparshme kemi përfshirë të gjithë punëtorët, siç është paraparë nga administrata tatimore. Kjo do të thotë se përfshihej edhe dikush që paguhej vetëm një herë në vit. Punëtorët sezonalë dhe ata të punësuar me afatshkurtër po ashtu mund të jenë përfshirë. Kjo do të thotë se mund të ketë një paragjykim në rezultatet tona. Për shembull, nëse do të kishte shumë punëtorë me pagë të ulët, të cilët paguheshin një ose dy herë në muaj, atëherë vlerësimet tona mund të tregojnë një pabarazi më të madhe se sa është në të vërtetë. Dhe kjo mund të rezultojë në përfundime të gabuara në lidhje me sistemin aktual të tatimit mbi të ardhurat personale.

Për të adresuar çështje të kësaj natyre, ne vendosëm të mbajmë vetëm punëtorët që ishin paguar të paktën për 9 muaj në vit. Kjo i eliminoi punëtorët sezonalë (që zakonisht punojnë për 3 muaj) dhe të tjerët që mund të ishin punësuar për një kohë të shkurtër. Tabela 4, më poshtë tregon mesataren vjetore dhe pagën e mesme (si bruto ashtu edhe neto), numrin e punëtorëve në mostër dhe pjesën e tyre në madhësinë origjinale të mostrës (d.m.th. me të gjithë fituesit e të ardhurave nga puna). Këtu shohim se mesatarisht rreth 72% e punëtorëve i plotësonin kriteret për të qenë të paguar për 9 muaj ose më shumë. Do të nevojitej më shumë informacion për të përcaktuar saktë arsyen pse pjesa tjetër prej 28% punoi vetëm 3 muaj ose më pak. Më tej, shohim që edhe mesatarja vjetore edhe ajo e mesmja janë më të larta, gjë që tregon se kemi hequr disa punëtorë me pagë më të ulët. Gjithashtu, me kalimin e viteve, tendenca e përgjithshme e të dyjave tregon rritje. Megjithatë, lidhja e tyre mbetet e njëjtë: mesatarja vjetore është ende më e lartë se e mesmja, duke treguar një shpërndarje pozitive të anuar.


Tabela 4. Paga mesatare dhe mediane vjetore e punëtorëve që paguheshin 9 muaj ose më shumë në vit

Rroga	2016		2017		2018		2019		2020	
	Mesatare	Mediane	Mesatare	Mediane	Mesatare	Mediane	Mesatare	Mediane	Mesatare	Mediane
Bruto	€6,008	€ 5,070	€ 6,056	€ 5,057	€ 6,372	€ 5,240	€ 6,526	€ 5,311	€ 6,532	€ 5,165
Neto	€ 5,376	€ 4,588	€ 5,420	€ 4,573	€ 5,693	€ 4,735	€ 5,827	€ 4,800	€ 5,832	€ 4,675
N	212,095		222,435		234,776		245,001		263,549	
%	75.55%		68.74%		74.33%		69.93%		70.73%	

Burimi: Llogaritjet e autorit të bazuara në të dhënat nga ATK

Përbërja e shpërndarjes midis 50% të ulët, 40% të mesëm dhe 10% të lartë ka mbetur gjithashtu e qëndrueshme. Siç tregohet në figurën 3 më poshtë, gjatë kësaj periudhe, mesatarisht, 50% i ulët ka ndarë 24.9% bruto dhe 25.4% të të ardhurave neto nga puna. 40% i mesëm ka ndarë 45.2% të të ardhurave bruto dhe 45.2% të të ardhurave neto nga puna; dhe 10% i lartë ka ndarë 29.9% të bruto dhe 29.4% të të

ardhurave neto nga puna. Pra, tatimi mbi të ardhurat personale rrit pjesën e të ardhurave nga puna e 50% më të ulët me 2,1% (ishte 3,1% në mostrën e plotë), nuk ndikon shumë në të ardhurat nga puna të ndara nga 40% i mesëm (ajo u rrit me 0,4% në mostrën e plotë), dhe i ulë të ardhurat nga puna të ndara nga 10% i lartë me 1.3% (ajo u ul me 2.1% në mostrën e plotë).



Pra, me të vërtetë pjesa e 50% i lartë është rritur, por ndryshimi në të ardhurat neto është ulur, kjo ndodhi për shkak të largimit të disa punëtorëve me pagë më të ulët. Nga ana tjetër, pjesa e zotëruar nga 10% i lartë është ulur, por gjithashtu është ulur diferenca midis të ardhurave të tyre bruto dhe neto. Këto rezultate tregojnë edhe një herë se shkalla e progresivitetit dhe efekti rishpërndarës i sistemit aktual të tatimit mbi të ardhurat personale janë të ulëta.

Më tej, një tregues tjetër është që kemi hequr disa vlera ekstreme që mund të shihen në koeficientët Gini. Siç tregohet në Tabelën 5 më poshtë, si koeficientët bruto ashtu edhe neto janë më të ulët. Përderisa diferenca në përqindje mes të dyjave është rritur në krahasim me analizën e mëparshme, ajo mbetet ende e ulët. Përsëri duke treguar se ka vend për të rritur fuqinë rishpërndarëse të sistemit aktual të taksave personale.

Tabela 5. Koeficientët Gini të të ardhurave bruto dhe neto nga puna e punëtorëve që janë paguar 9 muaj ose më shumë në vit

Viti	Bruto	Neto	Diferenca
2016	0.3666	0.3561	-2.86%
2017	0.3687	0.3582	-2.85%
2018	0.3812	0.3708	-2.73%
2019	0.3816	0.3713	-2.70%
2020	0.3854	0.3748	-2.75%

Burimi: Llogaritjet e autorit të bazuara në të dhënat nga ATK

Së fundi, Tabela 6, më poshtë tregon indekset Kakwani dhe Reynolds-Smolensky. Duke pasur parasysh kontrollet e mëparshme, të dy indekset kanë shënuar një rritje të lehtë. Ato tregojnë një sistem tatimor pak më të lartë progresiv dhe rishpërndarës.

Megjithatë, përmasat e vogla tregojnë ende se, nëse dikush synon të reduktojë pabarazinë e të ardhurave nga puna, atëherë ka shumë hapësirë për të rritur progresivitetin dhe efektin rishpërndarës të sistemit të tatimit mbi të ardhurat personale.

Tabela. 6 Indekset Kakwani dhe Reynolds-Smolensky të sistemit të tatimit mbi të ardhurat personale midis 2016-2020

Viti	Indeksi Kakwani	Indeksi Reynolds-Smolensky
2016	0.0898	0.0105
2017	0.0891	0.0104
2018	0.0873	0.0104
2019	0.0862	0.0103
2020	0.0886	0.0106

Burimi: Llogaritjet e autorit të bazuara në të dhënat nga ATK

## 6. NJË POLITIKË E RE FISKALE

Ulja e pabarazisë dhe e përqendrimit të të ardhurave duhet të jetë një politikë fiskale kyçe e çdo qeverie progresive. Nga analiza jonë, bazuar në të dhënat e ATK-së, kemi vlerësuar pabarazinë dhe shpërndarjen e të ardhurave nga puna, si dhe kemi vlerësuar shkallën e progresivitetit dhe fuqinë rishpërndarëse të politikës aktuale të tatimit në të ardhurat personale.

Dallimet midis koeficientëve Gini të të ardhurave bruto kundrejt të ardhurave neto tregojnë një sistem jo shumë efektiv për sa i përket reduktimit të pabarazisë. Një tregues i tillë bëhet më i dukshëm kur analizojmë shkallën e progresivitetit të matur nga Indeksi Kakwani dhe fuqinë rishpërndarëse të matur nga Indeksi Reynolds-Smolensky. Megjithëse skema e taksave është progresive, shkalla e progresivitetit është relativisht e ulët dhe fuqia e rishpërndarjes edhe më e ulët.

Më tej, analiza që përfshin të gjithë fituesit e të ardhurave nga puna tregon se, ndërkohë që pjesa e të ardhurave bruto me 40% të mesëm është e fuqishme, të ardhurat e ndara nga 10% i lartë janë rreth dyfishi i pjesës së zotëruar nga 50% i ulët. Struktura pas taksave tregon ndryshime të vogla, me një shkallë të vogël rritjeje të pjesës që zotërohet nga 50% i ulët, një rritje e vogël e pjesës që zotërohet nga 40% i mesëm dhe një rënie e papërfillshme e pjesës që zotërohet nga 10 % i lartë.

Për të reduktuar nivele kaq të larta të pabarazisë dhe përqendrimit të të ardhurave në krye, ne propozojmë një politikë të re të tatimit mbi të ardhurat personale, e cila është më progresive, më efektive në uljen e pabarazisë dhe që është më rishpërndarëse. Për të ofruar një qasje gjithëpërfshirëse, ne propozojmë një politikë të re të tatimit mbi të ardhurat e korporatave së bashku me futjen e një tatimi mbi dividendën.



## 6.1. NJË TAKSË E RE MBI TË ARDHURAT PERSONALE

Tatimi aktual në të ardhurat personale në Kosovë, me disa përjashtime, vlen për të gjitha burimet e të ardhurave, ku pagat janë ndër kryesoret. Për këtë arsye, dhe duke pasur parasysh të dhënat e ofruara nga ATK-ja, ne fokusohemi këtu në të ardhurat nga puna.

Ka disa detaje të thjeshta që e bëjnë të gjithë sistemin mjaft të lehtë për t'u kuptuar. Të ardhurat bruto përbëhen nga kontributi pensional 5% i bërë nga

punëdhënësi dhe nga kontributi pensional 5% i bërë nga punëtori. Pjesa e mbetur pas një zbritjeje prej 5% nga të ardhurat bruto konsiderohet më pas e ardhur e tatueshme. Për pagat nga punëdhënësit kryesorë, p.sh., punët kryesore, zbatohet një taksë progresive me kllapa dhe margjina siç tregohet në Tabelën 7. Për pagat nga punëdhënësit dytësorë, p.sh., punë shtesë, kryesisht afatshkurtra, zbatohet një taksë proporcionale prej 10%.

Tabela 7 Skema e Tatimit mbi të Ardhurat Personale


Të ardhurat mujore të tatueshme nga puna	Shkalla tatimore
€0 – €80	0%
> €80 – €250	4%
> €250 – €450	8%
> €450	10%

Burimi: Administrata Tatimore

Figura 4, më poshtë tregon shpërndarjen dhe shpërndarjen kumulative të pagave që bien brenda çdo grupi tatimor. Ka dy vështrime të rëndësishme në lidhje me ekstremet. Nga njëra anë, tatimi aktual mbi të ardhurat personale përjashton vetëm 16.6% të pagave primare, që përbëhet nga punëtorë që fitojnë deri në 80 € në muaj – prag shumë i ulët.

Nga ana tjetër, norma më e lartë marxhinale, e cila është 10%, vlen për 31.7% të pagamarrësve parësorë që fitojnë një pagë prej më shumë se 450 € në muaj – përsëri, një prag shumë i ulët. Këto janë indikacione shtesë se ky plan tatimor nuk është krijuar për të reduktuar pabarazinë, pasi ai përjashton shumë pak persona me fitime shumë të ulëta dhe poashtu vendos normën më të lartë marxhinale mbi një prag shumë të ulët.

Figura 4. Shpërndarja e pagave primare brenda çdo grupi tatimor 2016-2020



Siç kanë treguar të gjitha analizat e deritanishme, politika aktuale tatimore nuk ka qenë shumë efektive në uljen e pabarazisë dhe përqendrimit të të ardhurave. Prandaj, ne vendosëm një numër objektivash që duhet të përmbushen nga një taksë e re. Një taksë e re mbi të ardhurat personale duhet:

1. Të jetë më progresive për pagat nga punëdhënësit kryesorë dhe progresive (në vend të proporcionalit) për pagat nga punëdhënësit sekundarë;
2. Të ulë pabarazinë e të ardhurave më shumë se taksat aktuale;
3. Të ulë përqendrimin/rritjen e rishpërndarjes më shumë (d.m.th., pjesa e të ardhurave pas taksave rritet për të varfërit dhe klasën e mesme dhe zvogëlohet për të pasurit);

4. Të mos i reduktojë të ardhurat;
5. Të rezultojë në një fitim neto (dmth, "fituesit" >50%).

Një plan tatimor që i përshtatet të gjitha këtyre objektivave është paraqitur në Tabelën 8. Ky është propozimi ynë për pagat nga punëdhënësit primar. Siç mund të vihet re, ka dallime të mëdha në numrin dhe gjerësinë e shkallës tatimore, dhe normat marginale. Ndërsa skema e "e vjetër" e taksave është progresive, kryesisht në gjysmën e poshtme të shpërndarjes, ajo lejon që gjysma e sipërme të "gëzojë" pjesën më të madhe të të ardhurave të tyre nga puna përmes një takse proporcionale prej 10%. Skema "e re" e taksave ndjek logjikën e kundërt: gjysma e poshtme e fituesve të të ardhurave nga puna përjashtohen plotësisht nga taksat dhe progresiviteti fillon afërsisht në gjysmën e sipërme të shpërndarjes.

Tabela 8 Skema e re e tatimit mbi të ardhurat personale për pagat nga punëdhënësit kryesorë

Të ardhurat mujore të tatueshme nga puna	Shkalla tatimore
€0 – €300	0%
> €300 – €550	8%
> €550 – €800	14%
> €800 – €1,050	20%
> €1,050 – €1,300	26%
> €1,300 – €1,800	32%
> €1,800	38%

Burimi: Llogaritjet e autorit të bazuara në të dhënat nga ATK

Siç u shpjegua më herët, pagat nga punëdhënësit dytësorë aktualisht taten proporcionalisht me 10%. Ne propozojmë një taksë të re që është progresive. Për shkak se ka shumë më pak fitues të këtyre pagave – vetëm 8% e fituesve në 5 vitet e fundit, dhe për

shkak se këto janë të ardhura dytësore, ne propozojmë shkallë më të ngushtë tatimore dhe norma më të larta. Përsëri, ne përjashtojmë nga taksat shumicën dërrmuese dhe synojmë fituesit me të ardhura shumë të larta.

Tabela 9 Skema e re e tatimit mbi të ardhurat personale për pagat nga punëdhënësit kryesorë

Të ardhurat mujore të tatueshme nga puna	Shkalla tatimore
€0 – €100	0%
> €100 – €250	9%
> €250 – €400	15%
> €400 – €550	21%
> €550 – €700	27%
> €700 – €850	33%
> €850	39%

Burimi: Llogaritjet e autorit të bazuara në të dhënat nga ATK

Një shembull se çfarë do të thotë kjo në aspektin praktik, është dhënë më poshtë në Tabelën 10. Kolona e parë tregon tarifën. E dyta tregon grupet e të ardhurave bruto. E treta tregon të ardhurat para tatimit (d.m.th, të ardhurat e tatueshme) që janë të ardhura bruto minus kontributet e punëdhënësit. Kolona e pestë tregon të ardhurat neto nga puna të fituesit më të lartë (d.m.th, kllapa e sipërme) në skemën tatimore "të vjetër".

Kolona e gjashtë tregon se çfarë do të fitonte i njëjti person sipas skemës "së re" të taksave. Kolona e shtatë tregon diferencën midis të ardhurave neto nga puna nga tatimi "i ri" minus atë nga tatimi "i vjetër". Dhe kolona e tetë tregon shpërndarjen kumulative të fituesve të të ardhurave nga puna në çdo grup për periudhën 2016-2020.

Tabela 10 Efektet e taksës së re në të ardhurat nga pagat primare

Shkalla tatimore	Bruto		Para tatimit	Neto PARA	Neto PAS	Diferenca në Neto	Shpërndarja Kumulative
0%	€ -	€ 315.8	€ 300.0	€ 289.2	€ 300.0	€ 10.8	53.3%
8%	€ 315.8	€ 579.0	€ 550.0	€ 517.2	€ 530.0	€ 12.8	80.5%
14%	€ 579.0	€ 842.1	€ 800.0	€ 742.2	€ 745.0	€ 2.8	91.8%
20%	€ 842.1	€ 1,105.3	€ 1,050.0	€ 967.2	€ 945.0	€ (22.2)	95.9%
26%	€ 1,105.3	€ 1,368.4	€ 1,300.0	€ 1,192.2	€ 1,130.0	€ (62.2)	97.5%
32%	€ 1,368.4	€ 1,894.7	€ 1,800.0	€ 1,642.2	€ 1,470.0	€ (172.2)	98.9%
38%	€ 1,894.7	€ -	€ -	€ -	€ -	€ -	100.0%

Burimi: Llogaritjet e autorit të bazuara në të dhënat nga ATK

Dy kolonat e fundit tregojnë statistikat më të rëndësishme të kësaj table. Së pari, me propozimin tonë, mbi gjysma (53.3%) e fituesve të të ardhurave nga puna do të liroheshin nga taksat. Së dyti, fituesit e pagave bruto deri në 842.1 € do të merrnin një pagë neto më të lartë se në skemën e taksave "të vjetra". Me fjalë të tjera, 91.8% e fituesve të të ardhurave nga puna do të merrnin paga neto më të larta sesa aktualisht. Pastaj, 4.1% tjerë do të merrnin një pagë neto që do të mund të jetë maksimumi prej 20.2 € më e ulët se ajo që marrin aktualisht. Dhe do të ishin 4.1% i lartë, d.m.th. paga mujore bruto e të cilëve

fillon me 1,368.4 € të cilët do të mbanin një barrë më të rëndë të kësaj politike të re tatimore.

Tabela 11, më poshtë imiton atë të mëparshmen, por tani me statistika për pagat e fituara nga punëdhënësit sekondarë. Përsëri, dy kolonat e fundit tregojnë shifrat më të rëndësishme. Këtu, 99.1% e shpërndarjes do të fitonte një pagë neto më të lartë sesa aktualisht. Do të ishin vetëm 0.9% i lartë ose paga dytësore mujore e të cilëve është 421.1 € ose më e lartë që do të merrnin një pagë neto më të ulët sesa aktualisht.

Tabela 11 Efektet e taksës së re në të ardhurat nga pagat sekondare

Shkalla tatimore	Bruto		Para tatimit	Neto PARA	Neto PAS	Diferenca në Neto	Shpërndarja Kumulative
	€ -	€					
0%	€ -	€ 105.3	€ 100	€ 90	€ 100.0	€ 10.0	97.1%
9%	€ 105.3	€ 263.2	€ 250	€ 225	€ 250.0	€ 11.5	98.5%
15%	€ 263.2	€ 421.1	€ 400	€ 360	€ 400.0	€ 4.0	99.1%
21%	€ 421.1	€ 579.0	€ 550	€ 495	€ 550.0	€ (12.5)	99.4%
27%	€ 579.0	€ 736.8	€ 700	€ 630	€ 700.0	€ (38.0)	99.6%
33%	€ 736.8	€ 894.7	€ 850	€ 765	€ 850.0	€ (72.5)	99.7%
39%	€ 894.7	€ -	€ -	€ -	€ -	€ -	100.0%

Burimi: Llogaritjet e autorit të bazuara në të dhënat nga ATK

Cili është efekti i kësaj takse të re në të ardhura në pabarazinë e të ardhurave? Për t'iu përgjigjur kësaj, ne kemi vlerësuar empirikisht koeficientët Gini për të ardhurat bruto nga puna, të ardhurat para tatimit d.m.th., të ardhurat e tatueshme, neto para dhe neto pas zbatimit të tatimit të ri, siç tregohet në Tabelën 12. Dy kolonat e fundit tregojnë ndryshimet në përqindje të koeficientëve Gini ndërmjet para tatimit dhe neto para, dhe para tatimit dhe neto pas.

Dallimi është i dukshëm: dallimet midis të ardhurave neto nga puna para dhe pas tregojnë se tatimi i ri është shumë më efektiv në uljen e pabarazisë së të ardhurave sesa tatimi aktual. Nëse pjesëtojmë ndryshimin në përqindje të koeficientit Gini pas taksës së re me ndryshimin e koeficientit para taksës së re, shohim se taksa e re është 3 herë më efektive në uljen e pabarazisë.

Tabela 12 Krahasimi i koeficientëve Gini para dhe pas tatimit të ri

Viti	Bruto	Para tatimit	Neto PARA	Neto PAS	Ndryshimi Para	Ndryshimi Pas
2016	0.4568	0.4573	0.4478	0.4302	-2.1%	-5.9%
2017	0.4967	0.4973	0.4884	0.4716	-1.8%	-5.2%
2018	0.4692	0.4699	0.4603	0.4401	-2.0%	-6.3%
2019	0.4927	0.4932	0.4842	0.4646	-1.8%	-5.8%
2020	0.492	0.4925	0.4832	0.4643	-1.9%	-5.7%
Overall	0.4832	0.4837	0.4744	0.4557	-1.9%	-5.8%

Burimi: Llogaritjet e autorit të bazuara në të dhënat nga ATK

Për më tepër, ne vlerësojmë Indeksin Kakwani dhe Indeksin Reynolds-Smolensky të taksës aktuale kundrejt taksës së re. Raporti i Indekseve Kakwani tregon se taksa e re është rreth 3 herë më progresive se ajo aktuale. Gjithashtu, raporti i indkseve Reynolds-Smolensky tregon se taksa e re është pothuajse 3 herë më rishpërndarëse sesa ajo aktuale.

Tabela 13. Krahasimi i shkallës progresive dhe fuqisë rishpërndarëse të taksës së vjetër dhe asaj të re

Viti	Para		Pas		Shkalla	
	Indeksi Kakwani	Indeksi Reynolds-Smolensky	Indeksi Kakwani	Indeksi Reynolds-Smolensky	Kakw i ri. / Kakw i vjetër.	Shkalla e re/ Shkalla e vjetër
2016	0.1542	0.0096	0.4016	0.0271	2.6	2.8
2017	0.1425	0.0088	0.3755	0.0257	2.6	2.9
2018	0.1491	0.0095	0.3934	0.0297	2.6	3.1
2019	0.1396	0.009	0.3735	0.0286	2.7	3.2
2020	0.1456	0.0093	0.3709	0.0282	2.5	3.0
Në Tërësi	0.146	0.0093	0.382	0.028	2.6	3.0

Burimi: Llogaritjet e autorit të bazuara në të dhënat nga ATK

Pasi konfirmojmë se taksa e re është më progresive dhe më rishpërndarëse se ajo e vjetra, ne vlerësojmë ndryshimet në përqendrimin e të ardhurave. Kjo është një mënyrë tjetër për të parë fuqinë rishpërndarëse të taksës. Përsëri, qëllimi ynë është të zvogëlojmë përqendrimin e të ardhurave të larta duke i rishpërndarë ato te personat me të ardhura më të ulëta.

Tabela 14, më poshtë tregon të ardhurat para taksave, neto (aktuale) dhe neto (përpara) të ndara nga 50% i poshtëm, 40% i mesëm dhe 10% i lartë - si tre tregues për të ardhura të ulëta, me të ardhura mesatare dhe me të ardhura të larta. Siç tregohet në kolonën e katërt, taksa aktuale zvogëlon të ardhurat

e ndara nga 10% i shkallës së lartë me 2.3% dhe rrit të ardhurat e 40% të shkallës së mesme dhe 50% i shkallës së ulët me 0.5% dhe 3.2%. Nga ana tjetër, taksa e re, siç tregohet në kolonën e pestë, zvogëlon të ardhurat e ndara nga 10% i shkallës së lartë me 9.2%, dhe rrit të ardhurat e 40% të shkallës së mesme dhe 50% shkallës së ulët, përkatësisht me 3.9% dhe 7.3%. Së fundi, kolona e fundit tregon ndryshimin midis dy politikave tatimore. Taksa e re rrit pjesën e të ardhurave të 50% të shkallës së ulët me 3.9% më shumë se taksa aktuale; ajo rrit të ardhurat e 40% të shkallës së mesme me 3.4% më shumë se taksa aktuale; dhe ul të ardhurat e 10% e shkallës së lartë me 7% më shumë se taksa aktuale.

Tabela 14. Krahasimi i ndryshimeve në përqendrimin e të ardhurave sipas grupeve të ndryshme të të ardhurave

Shkalla e tatimit	Para tatimit	Neto PARA	Neto PAS	Ndryshimi në përqindje		
	(A)	(B)	(C)	(B-A)/A	(C-A)/A	(C-B)/B
50% i ulët	17.3%	17.8%	18.5%	3.2%	7.3%	3.9%
i mesëm 40%	48.6%	48.8%	50.4%	0.5%	3.9%	3.4%
10% i lartë	34.2%	33.4%	31.0%	-2.3%	-9.2%	-7.0%

Burimi: Llogaritjet e autorit të bazuara në të dhënat nga ATK

Kriteri i fundit për vlerësimin e politikës sonë tatimore është përcaktimi i efekteve të saj në të ardhura. Kur e aplikojmë këtë sistem për çdo vit nga viti 2016 deri në vitin 2020, konstatojmë se të ardhurat në fakt do të ishin rritur po të ishte vendosur ky sistem. Për çdo vit, të ardhurat do të ishin 7.6%, 8.9%, 16.2%, 16.6%

dhe 17.1%, më të larta se sa ishin me grafikun aktual tatimor. Pra, mund të konkludojmë se propozimi ynë i politikës tatimore përveçse do të ishte më progresiv, duke ulur pabarazinë dhe duke rritur rishpërndarjen më shumë se sistemi aktual, do të rriste edhe të ardhurat edhe më shumë.

## 6.2. NJË TAKSË E RE MBI TË ARDHURAT E KORPORATAVE

Në propozimin tonë, normat kryesore të taksave marxhinale për të ardhurat primare rriten nga 10% në 38% - që është 3.8 herë më e lartë. Për të ardhurat dytësore, të cilat kanë një taksë proporcionale prej 10%, ne e ndryshojmë atë në një taksë progresive me një normë maksimale margjinale prej 39% - që është 3.9 herë më e lartë. Norma mesatare e taksave rritet nga rreth 6% në rreth 6.8%, ndërsa tatimi mesatar ligjor rritet nga 5.5% në rreth 19.7%.

Tatimi aktual mbi të Ardhurat e Korporatave është 10% për bizneset me të ardhura vjetore mbi 50,000€; 3% dhe 9% (në varësi të sektorit) për ata me të ardhura prej 50,000 € ose më të ulëta. Ndryshimet në tatimin mbi të ardhurat e korporatave duhet të reflektojnë edhe ndryshimet e propozuara për tatimin mbi të ardhurat personale.

Prandaj, ne sugjerojmë që niveli kryesor i tatimit mbi korporatat nuk duhet të jetë më i ulët se norma mesatare e tatimit mbi të ardhurat personale. Në këtë rast, tatimi mbi të ardhurat e korporatave do të rritet nga 10% në 20%. Duke qenë se dy tarifat e tjera vlejné për bizneset më të vogla, rritja duhet të jetë më e ulët. Pra, ne sugjerojmë një rritje prej 50% të normës së lartë për normën më të ulët dhe afërsisht 75% për normën e mesme. Kjo do të thotë se norma më e ulët do të rritet në 4.5% dhe ajo e mesme do të rritet në 16%.

## 6.3. PREZANTIMI I NJË TATIMI MBI DIVIDENDËN

Aktualisht në Kosovë nuk ka tatim mbi dividendën. Dy shtetet e vetme që nuk kanë taksë mbi dividendën në BE janë Estonia dhe Letonia<sup>68</sup>. Të gjitha vendet e tjera evropiane anëtare të OECD-së dhe të gjitha vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor (6) e kanë një taksë mbi dividendën. Siç u cek më herët, pabarazia e të ardhurave nga puna në Kosovë ka qenë vazhdimisht e lartë. Dhe pabarazia e përgjithshme e të ardhurave, e cila përfshin lloje të tjera të ardhurash si kapitali, mund të jetë edhe më e lartë duke ditur se këto lloje të tjera zakonisht përqendrohen në më pak duar krahasuar me ato të pagave. Pra, si nga shembujt e vendeve të tjera, ashtu edhe nga këndvështrimi egalitar, duke qenë se edhe personat me të ardhura të ulëta dhe biznesi i vogël kanë paguar taksa, por aksionerët super të pasur janë përjashtuar, duhet vendosur një taksë mbi dividendën. Përsëri, ajo nuk duhet të jetë më e ulët se tatimi mesatar ligjor mbi të ardhurat personale, që do të thotë se as nga tatimi mbi të ardhurat e korporatave. Si i tillë, ne sugjerojmë që tatimi mbi dividendën të jetë 50% më i lartë se tatimi mbi të ardhurat e korporatave, që do ta bënte atë 30%.

E kombinuar me tatimin mbi të ardhurat e korporatave që propozuam, kjo normë siguron që një fitues i dividendës do të pagujë më shumë taksa sesa një pagafitues.

## 7. KONKLUZIONE

Ndryshimet e vogla në koeficientët Gini ndërmjet të ardhurave bruto dhe neto të punës janë një tregues se tatimi aktual mbi të ardhurat personale nuk është një mekanizëm adekuat për reduktimin e pabarazisë. Për më tepër, raporti i ndarjeve të të ardhurave midis të pasurve (p.sh., 10% shkalla e lartë) dhe të varfërve (p.sh., 50% shkalla e ulët) është rreth dy, duke treguar një përqendrim të lartë të të ardhurave nga puna në shkallën e lartë. Indekset Kakwani dhe Reynolds-Smolensky konfirmojnë më tej shkallën e ulët progresive dhe pafuqinë e sistemit aktual të tatimit mbi të ardhurat personale për t'u rishpërndarë.

Për të reduktuar pabarazinë e të ardhurave nga puna dhe për të rritur rishpërndarjen, pa dëmtuar të ardhurat dhe duke rezultuar në një fitim neto, ne propozuam një taksë të re mbi të ardhurat personale që ndjek një logjikë të ndryshme, përdor shkallë tatiimore të ndryshme dhe aplikon norma marxhinale të ndryshme nga ajo aktuale. Më tej, ne kemi siguruar që këto ndryshime në tatimin mbi të ardhurat personale të jenë paralele me ndryshimet në tatimin mbi të ardhurat e korporatave. Prandaj, ne propozuam një rritje 100%. Së fundi, si bazuar në praktikën në pothuajse të gjitha vendet përreth, ashtu edhe nga një perspektivë egalitare, ne propozuam futjen e një tatimi mbi dividendën, i cili do të ndihmonte në uljen e pabarazisë së përgjithshme dhe do të gjeneronte një rrjedhë të re të ardhurash për qeverinë.

<sup>68</sup> Shih Elke (2021).

## REFERENCAT

- Blanchet, T., Chancel, L., & Gethin, A. (2020).** Why is Europe more equal than the United States? PSE Working Papers halshs-03022133. HAL.
- Blanchet, T., Chancel, L., & Gethin, A. (2020).** Why is Europe more equal than the United States? PSE Working Papers halshs-03022133. HAL.
- Elke, A. (2021).** Dividend Tax Rates in Europe. Retrieved from Tax Foundation Web site: <https://tax-foundation.org/dividend-tax-rates-europe-2021/>
- Kakwani, N. C. (1977).** Measurement of Tax Progressivity: An International Comparison. *The Economic Journal*, 87(345), 71-80.
- Kosovo Agency of Statistics (KAS). (2018).** Results of the Household Budget Survey 2017. Prishtina: Kosovo Agency of Statistics (KAS).
- Reynolds, M., & Smolensky, E. (1977).** Public Expenditures, Taxes, and the Distribution of Income: The United States, 1950, 1961, 1970. Academic Press.
- World Inequality Lab. (2021).** World Inequality Database (WID). Retrieved from <https://wid.world/>

# PJESA III: STRUKTURA EKONOMIKE DHE POLITIKAT INDUSTRIALE

## KAPITULLI 5. BPV DHE PASQYRA E STRUKTURËS SË BILANCIT TREGTAR

LULE BAHTIRI

### 1. HYRJE

Bruto Prodhimi Vendor (BPV) konsiderohet si një nga masat më të rëndësishme sa i përket performancës së ekonomisë në Kosovë. BPV-ja<sup>69</sup> përmban vlerën e tregut të të gjitha mallrave dhe shërbimeve përfundimtare të prodhuara brenda një vendi për një periudhë të caktuar, zakonisht një vit. Edhe pse ka shumë mangësi që mund t'i adresohen BPV-së në lidhje me paraqitjen reale të një ekonomie, BPV është një nga të vetmit matës gjithëpërfshirës të prodhimit nacional.


Ekzistojnë tre mënyra të ndryshme për llogaritjen e BPV-së: qasja e shpenzimeve, qasja e vlerës së shtuar dhe qasja e të ardhurave. Për qëllimet e këtij kapitulli, do të shtjellohen vetëm dy qasjet e para. Të dy qasjet ofrojnë një kuptim më të thellë

të bilancit të industrisë dhe tregtisë në Kosovë, i cili mbetet negativ gjatë viteve. Një faktor i rëndësishëm në ekonominë e Kosovës janë shpenzimet agregate, të cilat do të mundësojnë që të kuptojmë rëndësinë e diasporës dhe remitencave të saj.

### 2. QASJA E SHPENZIMEVE NDAJ BPV-SË

Qasja e shpenzimeve<sup>70</sup> për llogaritjen e BPV-së përbëhet nga blerjet e përgjithshme në një ekonomi rezidente për një periudhë të caktuar, zakonisht një vit. Në mënyrë të veçantë, ai përfshin konsumin e mallrave dhe shërbimeve, formimin e kapitalit bruto, shpenzimet qeveritare dhe eksportet neto. Për shkak të disponueshmërisë së të dhënave, kjo është qasja më e zakonshme e përdorur në Kosovë.

Figura 1. Bruto Prodhimi Vendor në çmime aktuale sipas variablove dhe vitit, në milionë



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

BPV në çmime aktuale    Shpenzimi HH    Eksporti Neto  
Shpenzimet qeveritare    /Formimi i kapitalit bruto/

Figura 1, tregon vlerat e serive kohore për BPV-në<sup>71</sup> të matura përmes qasjes së shpenzimeve. Siç sugjeron teoria, konsumi është komponenti më i madh në BPV në Kosovë. Megjithatë, edhe pse konsumi final

mbetet kategoria dominuese, ai ka përjetuar një trajektore në rënie përgjatë viteve 2010-2019. Komponenti i dytë janë shpenzimet qeveritare që kanë mbetur të qëndrueshme gjatë periudhës, me luhajtje shumë të vogla.

<sup>69</sup> BPV gjithmonë përfshin BPV nominale, përveç nëse përcaktohet ndryshe.

<sup>70</sup> See more detailed explanation on GDP measurement approaches at Lumen Boundless Economics <https://courses.lumenlearning.com/boundless-economics/chapter/measuring-output-using-gdp/>


<sup>71</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës, Bruto Produkti Vendor me çmime aktuale sipas variablove dhe viteve, 2008-2020, <https://ask.rks-gov.net/en/kosovo-agency-of-statistics/add-news/gross-domestic-product-by-economic-activities-and-expensionure-approach-2008-2020>



Së fundi, bilanci i eksporteve neto është vazhdimisht negativ në Kosovë, duke nënkuptuar se për një periudhë njëvjeçare, importet e mallrave dhe shërbimeve të Kosovës janë më të mëdha se vlera e eksporteve. Edhe pse figura tregon përmirësim për periudhën 2010-2017, ka një rënie tjetër që fillon në vitin 2018. Kjo nënkupton një varësi të fortë të Kosovës nga produktet e huaja dhe e bën tregun tonë veçanërisht të cenueshëm ndaj çdo krize ndërkombëtare.

Qasja e shpenzimeve ofron një pamje të përgjithshme të ekonomisë së një vendi dhe shkon deri në sigurimin e një vlere mesatare të shpenzimeve për çdo qytetar në vend (BPV për kokë banori<sup>72</sup>, treguar në Figurën 2). Megjithatë, ai nuk jep ndikimin real të rritjes apo rënies së BPV-së ndër vite. Komponentët e tjerë si norma reale e rritjes, do të ofrojnë një pasqyrë të ndryshme sa i përket standardit të jetesës në Kosovë.

Figura 2. Bruto Prodhimi Vendor për kokë banori, 2008-2020




Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

Rritja e BPV-së për kokë banori ka qenë e qëndrueshme ndër vite, duke përfunduar vitin 2020. Bazuar në këto të dhëna dhe sipas klasifikimeve të Bankës Botërore, Kosova tani është një vend me të ardhura të mesme të larta. Megjithatë, këto vlera paraqiten në vlera nominale dhe nuk përfaqësojnë

rritjen reale apo efektin real të vlerave të BPV-së në jetën e njerëzve. Sipas shifrave të publikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), trajektorja reale e rritjes ndjek një rrugë më pak lineare, madje ndonjëherë edhe zvogëlohet.

Figure 3. Shkalla reale e rritjes, 2008-2020



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

<sup>72</sup>Agjencia e Statistikave të Kosovës, Bruto Produkti Vendor me çmime aktuale sipas variablave dhe viteve, 2008-2020, <https://ask.rks-gov.net/en/kosovo-agency-of-statistics/add-news/gross-domestic-product-by-economic-activities-and-expensionure-approach-2008-2020>

Ndryshimet në BPV<sup>73</sup> tregojnë se edhe pse në terma nominalë BPV-ja në Kosovë u rrit në mënyrë të qëndrueshme, rritja reale pati mjaft goditje gjatë viteve, që do të thotë se cilësia e jetës në Kosovë u përkeqësua gjatë kësaj periudhe.

### 3. QASJA E VLERËS SË SHTUAR NDAJ BPV-SË

Qasja e vlerës së shtuar<sup>74</sup> në matjen e BPV-së përfshin shumën e vlerës së shtuar bruto për të gjithë aktivitetin ekonomik dhe të llogaritur me çmimet bazë, plus taksat, minus subvencionet e produktit<sup>75</sup>. Me fjalë tjera, qasja e vlerës së shtuar e matë vlerën e prodhimit të një industrie minus konsumin e ndërmjetëm. Kjo është një qasje e rëndësishme për politikën e ardhshme në Kosovë për zhvillimin e industrisë. Shifrat tregojnë se sa të mëdha janë industritë e ndryshme në Kosovë sa i përket BPV-së. Në këtë mënyrë, në kohë krize, industritë me përmasa më të mëdha do të kenë një ndikim më të madh në krahasim me ato më të voglat. Megjithatë, industritë më të vogla janë gjithashtu vendimtare dhe duhet të mbështeten në rritje.

Sipas të dhënave të ASK-së, tre industritë/sectorët më të mëdhenj në Kosovë janë industria përpunuese dhe tregtia me shumicë dhe pakicë, si dhe bujqësia, gjuetia, pylltaria dhe peshkimi. Megjithëse, tendenca për këto industri duket e qëndrueshme, prodhimi në këto industri bie ngadalë me kalimin e viteve.

Për më tepër, sipas një studimi të fundit që matë ndikimin e pandemisë me COVID-19 në sektorin privat, dy industritë e para janë goditur më rëndë nga pandemia (Jakurti et al., 2020), duke lënë të kuptohet se ndikimi në BPV-së do të jetë i rëndësishëm. Për qëllime politike, është e rëndësishme të dihet nëse këto industri po zëvendësohen dhe nëse po, me çfarë dhe si mund të balancojmë rritjen e industrive të tjera pa i dëmtuar ato ekzistuese.

### 4. REMITANCAT

Remitancat e punëtorëve kosovarë që jetojnë jashtë vendit konsiderohen si flukse financiare për familjet e tyre në Kosovë. Megjithëse remitancat nuk llogariten drejtpërdrejt në BPV, ato kanë një rëndësi të konsiderueshme në ekonomi. Kategoria e konsumit në formulën e BPV-së ndikohet ndjeshëm nga remitancat. Në fakt, fluksi mesatar vjetor i remitancave në Kosovë i afrohet 15% të BPV-së totale. Krahasuar me vendet e rajonit gjatë vitit 2019, Kosova kryeson listën, e ndjekur nga Bosnja dhe Hercegovina (11.2%),

Mali i Zi (10.54%), Shqipëria (9.63%), Serbia (8.23%), Kroacia (6.64%) dhe Maqedonia e Veriut (2.53%)<sup>76</sup>. Gjatë vitit 2020, remitancat arritën vlera rekorde në Kosovë. Për herë të parë, vlera mujore e hyrjeve nga diaspora ka kaluar 100 milionë euro në prill 2020. Një pjesë e konsiderueshme e kësaj vlere u siguroi për të ndihmuar familjet të kapërcejnë krizën e shkaktuar nga pandemia me COVID-19. Megjithatë, remitancat shpenzohen kryesisht për konsum dhe pasuri të paluajtshme, me pak ose aspak përpjekje paraprake institucionale për të ndryshuar këtë sjellje, që paratë e diasporës i drejtojnë në investime të tjera që nxisin rritjen reale.

### 5. INVESTIMET E HUAJA DIREKTE

Investimet e Huaja Direkte (IHD) luhaten më shumë se kategoritë e tjera të shtjelluara në seksionet e mëparshme. Shumë shpesh, veçanërisht për vendet në zhvillim, teoritë sugjerojnë se IHD-të ndikojnë pozitivisht në rritjen ekonomike. Së bashku me fluksin hyrës të kapitalit, IHD-të sjellin edhe njohuri të menaxhimit dhe inovacion teknologjik. Në Kosovë, sa i përket flukseve, pasuritë e paluajtshme dominojnë IHD-të që përbëjnë më shumë se gjysmën e vlerës totale. Për më tepër, të dhënat e Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) tregojnë se Gjermania dhe Zvicra janë partnerët më të mëdhenj që investojnë në Kosovë. Kjo nxjerr në pah rëndësinë shtesë të diasporës kosovare, e cila investon në vendin e saj. Ndërsa është e rëndësishme të investosh në pasuri të paluajtshme, fakti që ajo dominon IHD-të e zvogëlon rolin e saj në krijimin e vendeve të qëndrueshme të punës, ndarjen e njohurive të menaxhimit ose sjelljen e risive. Kategoria e pasurive të paluajtshme ndiqet nga shërbimet financiare si dhe minierat dhe veprimtaritë e gurëthyesve. Në anën tjetër, investimi i kosovarëve jashtë vendit, asnjëherë nuk kalon 20% e investimeve në Kosovë. Prandaj, ndikimi real i IHD-ve në Kosovë është më i vogël se vlera e tyre.

### 6. BILANCI TREGTAR

Bilanci i llogarisë rrjedhëse në Kosovë është negativ nga viti 2004, kur shteti filloi ta kuantifikojë atë. Llogaria rrjedhëse përbëhet nga mallrat, shërbimet, të ardhurat primare dhe sekondare (të ardhura nga qeveria e përgjithshme dhe korporatat financiare dhe jofinanciare, familjet, etj.). Megjithatë, kontribuesi kryesor i vlerës negative në bilancin e llogarisë rrjedhëse mbetet bilanci në mallra. Edhe pse eksportet janë më pak se importet, çdo vit që nga viti 2004, ato nuk janë rritur me një ritëm shumë më të lartë se importet.

<sup>73</sup> Agjencia e Statistikave në Kosovë Rishikimi i Llogarive Kombëtare 2008-2020, <https://ask.rks-gov.net/media/6311/bpv-2008-2020.pdf>

<sup>74</sup> Shihni shpjegim më të detajuar mbi qasjet e matjes së BPV-së në Lumen Boundless Economics <https://courses.lumenlearning.com/boundless-economics/chapter/measuring-output-using-gdp/>


<sup>75</sup> Agjencia e Statistikave në Kosovë Rishikimi i Llogarive Kombëtare 2008-2019, <https://ask.rks-gov.net/media/6003/publikimi-i-revidimit-te-2008-2019.pdf>

<sup>76</sup> Ekonomia Globale. (të dhënat e 2019). Remitancat, përqindja e BPV-së - Renditja e vendeve, [https://www.theglobaleconomy.com/rankings/remittances\\_percent\\_gdp/](https://www.theglobaleconomy.com/rankings/remittances_percent_gdp/)

Një ndërprerje e lehtë në cikël ka ndodhur gjatë vitit 2020, kur eksportet u rritën më shumë se zakonisht. Për shembull, ndërsa eksportet mbulonin vetëm 12 ose 13% të importeve deri në vitin 2019, në vitin 2020 eksportet mbulonin rreth 17% të importeve. Për më tepër, një analizë e shkurtër të vendeve partnere

tregon një rritje të madhe të eksporteve në Shtetet e Bashkuara (644%), Kinë (444%), Egjipt (185%) dhe Hungari (98%). Me kusht që rritja e eksporteve të ketë ndodhur gjatë vitit të pandemisë, mbetet për t'u parë nëse kjo ishte një gjë e njëhershme apo një trend i qëndrueshëm dhe pozitiv.

Figura 4. Transaksionet e llogarisë rrjedhëse, 2008-2019<sup>77</sup>



Bilanci tregtar i shërbimeve ka qenë pozitiv që nga viti 2006, duke nënkuptuar një trend në rritje të eksportit të shërbimeve. Përfundimisht për kohëzgjatë nga analiza vitin 2020, për shkak të masave kufizuese me COVID-19, të cilat ndikuan menjëherë në uljen e kategorisë së udhëtimit dhe nuk jep një tregues real të një modeli të përsëritur në eksportet e shërbimeve. Hulimtimet e fundit të Bankës Botërore tregojnë se për vendet në zhvillim, investimet në shërbime janë pozitive drejt rritjes, pasi shërbimet mund të ndihmojnë në zhvillimin e prodhimit, si dhe përmes teknologjisë dhe njohurive të përmirësuar<sup>78</sup>.

## 6.1. NDIKIMI I COVID-19 NË BILANCIN TREGTAR

Ndërsa efekti i COVID-19 në përgjithësi duket të jetë negativ, të dhënat mbi bilancin tregtar tregojnë një histori disi të ndryshme. Duke folur në terma të BPV-së, Kosova duket se është kthyer prapa gati për 3 vite, ndërsa sektori privat raporton humbje të konsiderueshme në qarkullim dhe fitime vjetore, si dhe pushime të konsiderueshme nga puna (Jakurti et al., 2020). Nga ana tjetër, bilanci tregtar i mallrave është përmirësuar. Sipas statistikave zyrtare, eksportet

e mallrave janë rritur për 21%<sup>79</sup> gjatë vitit 2020- një nga rritjet më të mëdha në këtë kategori; ndërsa importi i mallrave është ulur për 6% - rënia më e madhe e importeve në më shumë se gjashtë vitet e fundit. Ndërkohë kategoria e shërbimeve pësoi një rënie rekord prej 60%. Ndërsa pothuajse të gjithë artikujt në kategorinë e shërbimeve ranë paksa, shërbimet e udhëtimit duket se janë goditur më së rëndi me rënie prej 60%. Kjo është brenda arsyes, pasi gjatë tremujorit të dytë Kosova ishte tërësisht ose pjesërisht e izoluar. Një nga kategoritë e vetme që pësoi një rritje të ndjeshme prej 155% janë shërbimet e telekomunikacionit, ato kompjuterike dhe të informacionit. Kjo u dëshmuar në mbarë botën, pasi izolimi nxiti përdorimin e platformave online. Lajmi i mirë është se Kosova vazhdon të eksportojë shërbime që mbështeten në fuqi punëtore të kualifikuara, mirëpo duhet ta shfrytëzojë atë edhe për ekonominë e vendit.

## 6.2. LLOJET E EKSPORTEVE DHE IMPORTEVE

Për të kuptuar modelin e rritjes së një vendi, duhet parë përtej shifrave në lidhje me eksportet apo importet. Ajo që është gjithashtu thelbësore është struktura e eksportit dhe importit. Në hulumtimin e kryer nga Instituti Levy, vendet më të pasura eksportojnë kryesisht produkte "të mira", të cilat përfshijnë mallra që janë kryesisht të prodhuara nga njeriu dhe kërkojnë punë me shkathtësi të kualifikuara; ndërsa vendet më të varfra eksportojnë kryesisht produkte "të këqija", të cilat përfshijnë mallra që janë kryesisht

<sup>77</sup> Banka Qendrore e Kosovës (2020). Llogaria rrjedhëse e bilancit të pagesave, <https://bqk-kos.org/statistics/time-series/?lang=en>

<sup>78</sup> Nayar, Gaurav; Hallward-Driemeier, Mary; Davies, Elwyn (2021).- Në shërbimin tuaj. Premtimi i Zhvillimit të udhëhequr nga Shërbimet. Uashington, DC: Banka Botërore. © Banka Botërore. <https://openknowledge.worldbank.org/handle/10986/35599>

<sup>79</sup> Përfshinë riekportet

të prodhuara në mënyrë natyrale dhe kërkojnë shkathtësi të thjeshta pune<sup>80</sup>. Sipas hulumtimit, këto të fundit e kanë shumë të vështirë të arrijnë një rritje të qëndrueshme dhe afatgjatë dhe mbeten të bllokuar në kurthin e të ardhurave mesatare. Përgjatë këtij kapitulli, ne do të shqyrtojmë natyrën e eksporteve dhe do të kuptojmë se shporta kryesore e mallrave të eksportit të Kosovës përbëhet nga produktet “e këqija”, me një numër më të vogël mallrave të eksportuara që i përkasin kategorisë së produkteve “të mira”. Ne gjithashtu eksplorojmë produktet “e mira” që Kosova importon si dhe partnerët kryesorë tregtarë.

### 6.2.1. KLASIFIKIMI I EKSPORTEVE DHE IMPORTEVE

Sipas të dhënave të publikuara nga Banka Qendrore e Kosovës dhe bazuar në kategorizimin e BE-së, janë 11 kategori kryesore të eksporteve. Kategoritë më të mëdha të eksportit në Kosovë përfshijnë (i) metalet bazë dhe artikujt prej metali bazë, (ii) plastika, goma dhe artikujt prej tyre, (iii) ushqime të përgatitura, pije dhe duhan. Me fjalë të tjera, Kosova kryesisht eksporton lëndë të parë, ose mallra pa vlerë të shtuar. Është e rëndësishme të theksohet se lëndët e para shiten me çmimin e tyre më të ulët; partnerët tregtarë që importojnë këto mallra më pas i përpunojnë dhe i shesin me një çmim shumë më të lartë.

Sa i përket partnerëve tregtarë, Bashkimi Evropian është partneri më i madh eksportues i Kosovës, bazuar në vlerën totale të shitur çdo vit. Konkretisht, Gjermania, Italia dhe Mbretëria e Bashkuar janë vendet ku ne i shesim më shumë mallrat tona, të ndjekura nga rajoni i Ballkanit Perëndimor. Partnerët tanë kryesorë janë Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Serbia. Së fundi, nga vendet jo-evropiane Kosova eksporton më së shumti në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Indi.

Sa i përket shërbimeve, kategoritë kryesore që kontribuojnë në eksportet e Kosovës janë udhëtimet, telekomunikacioni, shërbimet kompjuterike dhe informative, si dhe mallrat dhe shërbimet qeveritare. Me fjalë të tjera, është kryesisht diaspora e Kosovës përmes shpenzimeve të udhëtimit së bashku me turistët e tjerë dhe të rinjtë që ofrojnë shërbime kompjuterike jashtë vendit që kanë vazhduar t'i mbajnë shërbimet në tepricë për vite me radhë. Politikëbërësit kosovarë duhet të rishikojnë mundësinë për të investuar më shumë në kategorinë e dytë<sup>81</sup> dhe të gjejnë po ashtu mënyra për të përdorur zhvillimin e kësaj fuqie punëtore shumë të kualifikuar për të ndihmuar edhe sektorin e prodhimit.

Kategoritë kryesore të mallrave që importon Kosova përfshijnë (i) ushqime të përgatitura, pije dhe duhan, (ii) makineri, pajisje, etj., dhe (iii) produkte minerare. Praktikisht shumica e ushqimeve dhe pijeve që konsumojnë kosovarët janë të huaja. Në krahasim, Kosova eksporton vetëm rreth 10% të asaj që importon në mallra të konsumit.

Partnerët kryesorë tregtarë të Kosovës përfshijnë BE-në, vendet e CEFTA-s dhe Azinë. Në BE, partnerët kryesorë janë Gjermania, Greqia dhe Italia; në CEFTA, partnerët kryesorë përfshijnë Serbinë, Shqipërinë, Maqedoninë e Veriut; Ndërsa vendi që eksportojmë më pak në rajon është Serbia, ndërsa ajo mbetet vendi nga i cili importojmë më shumë. Prej vendeve tjera evropiane, Turqia është një partner i fortë, ndërsa prej vendeve joevropiane, Kina dominon tregun tonë.

## 7. KONKLUZIONE

Sipas klasifikimeve të Bankës Botërore, Kosova është një vend me të ardhura të mesme të larta, i cili ka pasur një rritje të qëndrueshme ekonomike gjatë 10 viteve të fundit. Përderisa BPV-ja i Kosovës është rritur në mënyrë të qëndrueshme gjatë viteve, shkalla reale e rritjes ka qenë më pak lineare me ndryshueshmëri të konsiderueshme gjatë viteve, duke nënkuptuar se standardi i jetesës nuk është përmirësuar shumë. Ndërkohë që edhe eksportet kanë pësuar një tendencë disi pozitive, kategoritë kryesore eksportuese nuk tregojnë premtime për rritje të qëndrueshme. Megjithatë, ka potencial për rritje në industrinë e shërbimeve, dhe të mbështetur nga kërkimet e fundit, investimet në shërbime mund të ndihmojnë në krijimin e rritjes së qëndrueshme ekonomike. Për më tepër, kontributi i diasporës është më i madhi në rajon; megjithatë, pjesa më e madhe e kësaj vlere shpenzohet për konsum ose pasuri të paluajtshme. Vendimi i sivjetshëm i Ministrisë së Financave për të ofruar mundësi për diasporën për të investuar në bono thesari ishte një lëvizje e rëndësishme në ndryshimin e drejtimit të kontributeve të diasporës nga konsumi në investime. Edhe pse vlera e investimit ishte relativisht e vogël (10 milionë euro), ai është vendimtar në ndryshimin e sjelljes në të ardhmen, siç do të duhej të bënte çdo politikë e mirë.

<sup>80</sup> Felipe, J. et al. 2010 Si u pasuruan vendet e pasura dhe pse vendet e varfra mbeten të varfra: Kjo është struktura ekonomike...Ore! Banka Aziatike për Zhvillim, [https://www.levyinstitute.org/pubs/wp\\_644.pdf](https://www.levyinstitute.org/pubs/wp_644.pdf)

<sup>81</sup> Duke supozuar se kompjuteri dhe shërbimet e informacionit janë pika dominuese në këtë kategori.

## REFERENCAT

- Kosovo Agency of Statistics.** (2021). Gross Domestic Product in current prices by variables and year, from 2008-2020, <https://ask.rks-gov.net/en/kosovo-agency-of-statistics/add-news/gross-domestic-product-by-economic-activities-and-expenditure-approach-2008-2020>
- Kosovo Agency of Statistics.** (2021). Review of National Accounts 2008-2020, <https://ask.rks-gov.net/media/6311/bpv-2008-2020.pdf>
- Kosovo Agency of Statistics.** (2021). Review of National Accounts 2008-2019, <https://ask.rks-gov.net/media/6003/publikimi-i-revidimit-te-2008-2019.pdf>
- The Global Economy.** (2019). Remittances, percent of GDP - Country rankings, [https://www.theglobaleconomy.com/rankings/remittances\\_percent\\_gdp/](https://www.theglobaleconomy.com/rankings/remittances_percent_gdp/)
- Central Bank of Kosovo.** (2020). Balance of Payments Current Account, <https://bqk-kos.org/statistics/time-series/?lang=en>
- Nayyar, Gaurav; Hallward-Driemeier, Mary; Davies, Elwyn** (2021). At Your Service? The Promise of Services-Led Development. Washington, DC: World Bank. © World Bank. <https://openknowledge.worldbank.org/handle/10986/35599>
- Felipe, J. et al.** (2010). How Rich Countries Became Rich and Why Poor Countries Remain Poor: It's the Economic Structure . . . Duh! Asian Development Bank, [https://www.levyinstitute.org/pubs/wp\\_644.pdf](https://www.levyinstitute.org/pubs/wp_644.pdf)

# KAPITULLI 6. FILLET E NJË POLITIKE TË RE INDUSTRIALE

EDISON JAKURTI

## 1. HYRJE

Deficitet e mëdha tregtare tregojnë një ndryshim që duhet të ndodhë në politikën industriale, veçanërisht kur ka shkallë të lartë të papunësisë, siç është rasti në Kosovë. Duke pasur parasysh madhësinë e vogël të ekonomisë dhe historinë e deindustrializimit, është e pamundur për Kosovën – apo për ndonjë vend tjetër – të specializohet në të gjitha mallrat. Kështu, një strategji specifike e specializimit në mallra dhe shërbime me kostot më të ulëta oportune është shumë e nevojshme.

Në këtë kapitull, ne vlerësojmë përparësinë krahasuese të zbuluar për mallrat e eksportuara të Kosovës në 11 vitet e fundit. Ka modele të rëndësishme që mund të shërbejnë si fillim për një politikë të re industriale që në fakt bazohet në analizat ekonomike – dhe jo masa ad hoc ose nëpërmjet favorizimit. Për më tepër, ne vlerësojmë produktivitetin e lidhur me çdo mall të eksportuar së bashku me produktivitetin e përgjithshëm të shportës së eksporteve. Ndërsa e para tregon disa industri prodhuese që mund të rriten dhe përparojnë më tej, kjo e fundit tregon se përveç planifikimit strategjik, rritja e komponentëve të tjerë si kapitali njerëzor janë vendimtare për përmirësimin e kapaciteteve të përgjithshme industriale.

## 2. PËRPARËSIA KRAHASUESE E ZBULUAR

Një vend i mirë për të filluar është duke vlerësuar përparësinë krahasuese, e cila është një nocion që i atribuohet David Ricardos, një ekonomist politik klasik, i cili e diskutoi këtë koncept në librin e tij të vitit 1817 “Mbi Parimet e Ekonomisë Politike dhe Tati-meve”. Në thelb, një vend thuhet se ka një përparësi krahasuese në prodhimin e një malli ose një shërbimi kur ai prodhim bëhet me një kosto oportune më të ulët se në vendet e tjera.

Përparësia krahasuese është një nocion shumë i përmendur në diskutimet për çështjet ekonomike të Kosovës, por nuk ka statistika zyrtare që e zbulojnë atë. Ky është një nocion relativisht i lehtë për t’u kuptuar, por nuk është kështu kur bëhet fjalë për vlerësimin.

Megjithatë, ka mënyra se si kjo mund të bëhet, veçanërisht duke pasur parasysh rëndësinë e saj si hap i parë për rivlerësimin e tendencave aktuale dhe të kaluara në këtë drejtim.

Një mënyrë e zakonshme dhe mjaft e thjeshtë për ta bërë këtë është duke e vlerësuar indeksin e avantazhit krahasues të zbuluar (RCA) të sugjeruar nga Balassa (1965)<sup>82</sup>. RCA e vendit k për mallin i përkufizohet si,

$$RCA_k^i = \frac{X_k^i / X^i}{X_k / X}$$

ku  $X_k^i$  tregon eksportet e mallrave k sipas vendit i,  $X^i$  tregon vlerën e përgjithshme të eksporteve të vendit i,  $X_k$  është totali i eksporteve botërore të mallrave k, dhe  $X$  është vlera e përgjithshme e eksporteve botërore (d.m.th. e të gjitha mallrave). Me fjalë tjera, ai është një raport i eksporteve të një malli të caktuar të vendit, ndaj pjesës botërore të eksporteve të po të njëjtit mall.

Kufiri që përcakton nëse një vend ka një përparësi krahasuese të zbuluar për eksportimin e një malli të caktuar është 1. Nëse  $RCA > 1$ , atëherë për këtë mall thuhet se ka një përparësi krahasuese të zbuluar. Megjithatë, një pengesë e këtij indeksi është se ai është i pakufizuar në skajin e sipërm (d.m.th., për mallrat ku ka përparësi krahasuese), por kufiri i poshtëm (d.m.th., për mallrat me një mospërparësi krahasuese) është 0. Për këtë arsye, dhe për një qasje më intuitive kur krahasohen mallra ose sektorë të ndryshëm, RCA mund të normalizohet siç sugjerohet nga Laursen (2000)<sup>83</sup> dhe është përdorur në botimet e Organizatës Botërore për Tregti (WTO)<sup>84</sup>. Pra, RCA e Normalizuar (NRCA) është:

$$NRCA_k^i = \frac{RCA_k^i - 1}{RCA_k^i + 1}$$

Kufiri tani është 0, kufiri i poshtëm është -1 dhe kufiri i sipërm është 1. Me fjalë të tjera, mallrat për të cilat  $NRCA > 0$  thuhet se kanë një përparësi krahasuese, ndërsa ato ku  $NRCA < 0$ , kanë një mospërparësi krahasuese.

<sup>82</sup> Shih Balassa (1965).

<sup>83</sup> Shih Laursen (2000).

<sup>84</sup> See World Trade Organization (2012).

## 2.1. TË DHËNAT

Për të vlerësuar NRCA për Kosovën, ne përdorim të dhënat e eksportit të mallrave për periudhën 2010-2020. Eksportet janë të strukturuar përmes kodeve të Sistemit të Harmonizuar (SH) dhe ne përdorim nivelin e ndarjes 2-shifrore (HS-2), d.m.th., Kapitulli 1 deri në 99. Këto të dhëna janë marrë nga databaza publike e Agjencisë së Statistikave të Kosovës. Të njëjtat të dhëna, për të njëjtën periudhë dhe nivel zberthimi, për pjesën tjetër të botës u morën nga Baza e të dhënave UN Comtrade, e cila është gjithashtu e disponueshme për publikun. Për shkak se të dhënat nga UN Comtrade ishin në dollarë të Shteteve të Bashkuara, vlerat e eksportit u konvertuan në euro duke përdorur kurset mesatare vjetore të këmbimit, të listuara nga Banka Qendrore Evropiane<sup>85</sup>.

## 2.2. REZULTATET

Figura 1 më poshtë, tregon 5 kapitujt kryesorë të mallrave me përparësinë krahasuese më të lartë, të zbuluar për çdo vit midis 2010 dhe 2020. Një listë shteruese e të gjitha mallrave me një përparësi (dhe mospërparësi) krahasuese të zbuluar mund të gjendet në Shtojcën A. Kolona e parë është kodi i kapitullit të mallrave sipas klasifikimit SH me 2 shifra, kolona e dytë përshkruan grupin e mallrave të përfshira në kapitull dhe kolona e fundit tregon përparësinë krahasues të normalizuar të zbuluar. Përsëri, siç u përshkrua më parë, përparësitë krahasuese të zbuluara u normalizuan në mënyrë që indekset të kufizohen si në anën e poshtme ashtu edhe në atë të sipërme. Si i tillë, diapazoni i vlerave qëndron ndërmjet -1 dhe 1, dhe 0 është kufiri, d.m.th., duke treguar përparësinë krahasuese të zbuluar të atij malli.

Figura 1. Top-5 mallrat me përparësinë më të lartë krahasuese 2010-2020

### 2010

Nr.	Mall	NRCA
72	Hekur dhe çelik	0.93
41	Lëkurat dhe lëkurat e papërpunuara (përveç lëkurave të gëzofit) dhe lëkura	0.91
11	Produktet e industrisë së mullirit; malt, niseshte, inulinë, gluten gruri	0.90
78	Plumbi dhe artikujt prej tij	0.87
26	Xehe, skorje dhe hi	0.82

### 2011

Nr.	Mall	NRCA
11	Produktet e industrisë së mullirit; malt, niseshte, inulinë, gluten gruri	0.91
72	Hekur dhe çelik	0.90
41	Lëkurat dhe lëkurat e papërpunuara (përveç lëkurave të gëzofit) dhe lëkura	0.88
55	Fijet kryesore të bëra nga njeriu	0.75
51	Lesh, qime të imta ose të trasha të kafshëve; fije kali dhe pëlhura të endura	0.75

### 2012

Nr.	Mall	NRCA
11	Produktet e industrisë së mullirit; malt, niseshte, inulinë, gluten gruri	0.93
41	Lëkurat dhe lëkurat e papërpunuara (përveç lëkurave të gëzofit) dhe lëkura	0.91
78	Plumbi dhe artikujt prej tij	0.90
72	Hekur dhe çelik	0.89
55	Fijet kryesore të bëra nga njeriu	0.84

### 2013

Nr.	Mall	NRCA
11	Produktet e industrisë së mullirit; malt, niseshte, inulinë, gluten gruri	0.93
41	Lëkurat dhe lëkurat e papërpunuara (përveç lëkurave të gëzofit) dhe lëkura	0.91
72	Hekur dhe çelik	0.90
55	Fijet kryesore të bëra nga njeriu	0.85
78	Plumbi dhe artikujt prej tij	0.83

<sup>85</sup>Shih "Euro foreign exchange reference rates" as part of the "ECB/ Eurosystem policy and exchange rates" section in the Statistics tab of the European Central Bank website: [https://www.ecb.europa.eu/stats/policy\\_and\\_exchange\\_rates/euro\\_reference\\_exchange\\_rates/html/eurofxref-graph-usd.en.html](https://www.ecb.europa.eu/stats/policy_and_exchange_rates/euro_reference_exchange_rates/html/eurofxref-graph-usd.en.html)

**2014**

Nr.	Mall	NRCA
11	Produktet e industrisë së mullirit; malt, niseshte, inulinë, gluten gruri	0.90
72	Hekur dhe çelik	0.90
41	Lëkurat dhe lëkurat e papërpunuara (përveç lëkurave të gëzofit) dhe lëkura	0.89
55	Fijet kryesore të bëra nga njeriu	0.84
26	Xehe, skorje dhe hi	0.73

**2015**

Nr.	Mall	NRCA
72	Hekur dhe çelik	0.89
41	Lëkurat dhe lëkurat e papërpunuara (përveç lëkurave të gëzofit) dhe lëkura	0.89
78	Plumbi dhe artikujt prej tij	0.88
11	Produktet e industrisë së mullirit; malt, niseshte, inulinë, gluten gruri	0.84
22	Pije, pije alkoolike dhe uthull	0.77

**2016**

Nr.	Mall	NRCA
41	Lëkurat dhe lëkurat e papërpunuara (përveç lëkurave të gëzofit) dhe lëkura	0.90
76	Alumini dhe artikujt prej tij	0.87
11	Produktet e industrisë së mullirit; malt, niseshte, inulinë, gluten gruri	0.85
26	Xehe, skorje dhe hi	0.81
22	Pije, pije alkoolike dhe uthull	0.78

**2017**

Nr.	Mall	NRCA
41	Lëkurat dhe lëkurat e papërpunuara (përveç lëkurave të gëzofit) dhe lëkura	0.90
11	Produktet e industrisë së mullirit; malt, niseshte, inulinë, gluten gruri	0.83
72	Hekur dhe çelik	0.82
78	Plumbi dhe artikujt prej tij	0.81
22	Pije, pije alkoolike dhe uthull	0.81

**2018**

Nr.	Mall	NRCA
41	Lëkurat dhe lëkurat e papërpunuara (përveç lëkurave të gëzofit) dhe lëkura	0.91
78	Plumbi dhe artikujt prej tij	0.84
22	Pije, pije alkoolike dhe uthull	0.84
72	Hekur dhe çelik	0.77
26	Xehe, skorje dhe hi	0.73

**2019**

Nr.	Mall	NRCA
41	Lëkurat dhe lëkurat e papërpunuara (përveç lëkurave të gëzofit) dhe lëkura	0.87
78	Plumbi dhe artikujt prej tij	0.84
22	Pije, pije alkoolike dhe uthull	0.83
72	Hekur dhe çelik	0.82
73	Artikujt prej hekuri ose çeliku	0.68

**2020**

Nr.	Mall	NRCA
78	Plumbi dhe artikujt prej tij	0.92
72	Hekur dhe çelik	0.87
41	Lëkurat dhe lëkurat e papërpunuara (përveç lëkurave të gëzofit) dhe lëkura	0.85
22	Pije, pije alkoolike dhe uthull	0.83
26	Sapun, agjentë organikë sipërfaqësorë aktivë; preparate për larje, lubrifikim, lustrim ose pastrim; dyll artificialë ose të përgatitur, qirinj dhe artikujt të ngjashëm, pasta për modelim, dyll dentar dhe preparate dentare me bazë allçie	0.77

Burimi: Llogaritjet e autorit bazuar në të dhënat nga ASK dhe UN Comtrade



Siç tregohet në Figurën 1 dhe tabelat në Shtojcën A, ka disa kapituj të mallrave që shfaqen vit pas viti. Nëse indeksi i avantazhit krahasues të zbuluar nga e kaluara merret si një tregues fillestar për të menduar për sektorët që duhet të merren parasysh, kur mendohet për mbështetjen dhe promovimin e eksporteve, atëherë është parësore të bëhet një analizë më e thellë mbi mallrat me nivelin më të lartë të NRCA dhe ato që kanë qenë vazhdimisht në listë. Në mënyrë të veçantë, mallrat që kanë pasur një avantazh krahasues çdo vit në dekadën e kaluar përfshijnë (të renditura në një rend zbritës bazuar në kodin e tyre dhe jo në NRCA të tyre):

- 7. Perime ushqimore dhe disa rrënjë dhe zhardhokë;
- 8. Fruta dhe arra të ngrënshme; lëvozhga e agrumeve ose pjepit;
- 9. Kafe, çaj, mate dhe erëza;
- 11. Produktet e industrisë së mullirit; malt, niseshte, inulinë, gluten gruri;
- 18. Kakao dhe përgatitjet e kakaos;
- 20. Përgatitjet e perimeve, frutave, arrave ose pjesëve të tjera të bimëve;
- Pije, pije alkoolike dhe uthull;
- 26. Xehe, skorje dhe hi;
- 41. Lëkurat dhe lëkurat e papërpunuara (përveç lëkurave të gëzofit) dhe lëkura;
- 59. Pëlhura tekstili të ngopura, të veshura, të mbuluara ose të laminuara; artikuj tekstili të një lloji të përshtatshëm për përdorim industrial;
- 72. Hekur dhe çelik;
- 73. Artikuj prej hekuri ose çeliku;
- 74. Bakri dhe artikujt prej tij;
- 76. Alumini dhe artikujt prej tij;
- Plumbi dhe artikujt prej tij;
- 79. Zinku dhe artikujt prej tij;

### 3. PËRCAKTIMI I PRODUKTIVITETIT TË EKSPORTEVE

RCA është një indeks i rëndësishëm, por pengesa e tij është se nuk informon për sektorët më produktivë që kanë eksportuar. Për të përcaktuar nivelin e produktivitetit të lidhur me një produkt, Hausmann, Hwang dhe Rodrik (2007) propozojnë ndërtimin e PRODY dhe EXPY<sup>86</sup>. Në thelb, PRODY është niveli i produktivitetit i lidhur me një mall dhe është një produkt i RCA të vendit j dhe PBB për kokë banori të atij vendi të shënuar me  $Y_j$ . Formalisht, ajo përkufizohet si:

$$PRODY_k = \sum_j \frac{(x_{jk}/x_j)}{\sum_j (x_{jk}/x_j)} Y_j$$

Me fjalë të tjera, është mesatarja e peshuar e BPV-së për kokë banori, ku peshat përcaktohen nga RCA e secilit vend. Në këtë mënyrë, PRODY përfaqëson nivelin e të ardhurave të eksporteve. Më pas, për të përcaktuar nivelin e produktivitetit të lidhur me shportën e eksporteve, Hausmann, Hwang dhe Rodrik (2007) sugjerojnë EXPY e cila përkufizohet zyrtarisht si:

$$EXPY_i = I \left( \frac{x_{ii}}{x_i} \right) PRODY_i$$

ku indeksi PRODY shumëzohet me peshën e secilit eksport në totalin e eksporteve të vendit i. Ndërsa PRODY dhe EXPY zakonisht përdoren për të krahasuar produktivitetin e eksporteve të vendeve të ndryshme, ato ende mund të zbulojnë disa informacione të rëndësishme në lidhje me modelet dhe tendencat në vende të veçanta. Hausmann, Hwang dhe Rodrik (2007) tregojnë se ekziston një korrelacion i lartë midis rritjes ekonomike dhe EXPY.

### 3.1. REZULTATET

Për të vlerësuar PRODY ne përdorim indekset RCA të llogaritura më herët dhe BPV-në për kokë banori (konstante, në euro) nga baza e të dhënave publike të ASK-së. Më pas, siç tregon formula, vlerat PRODY shumëzohen me pjesët e eksportit, duke përdorur gjithashtu të njëjtat të dhëna që janë përdorur për të ndërtuar indekset RCA, për të nxjerrë indekset EXPY.

Tabela 1 më poshtë, tregon top-5 eksportet më të mëdha dhe më të vogla të renditura nga mesatarja PRODY nga periudha 2010-2020. Tre vlerat e para më të ulëta janë zero sepse Kosova nuk ka eksportuar asnjë mall në këta kapituj. Më pas, disa sasi të papërfillshme regjistrohen në "aeroplanët, anijet kozmike dhe pjesët e tyre" dhe "armët dhe municionet - pjesë dhe aksesorët e tyre". Është mjaft e pritshme duke qenë se Kosova nuk i prodhon këto lloje të mallrave. Pastaj, vlera më e lartë e PRODY shoqërohet me disa kategori që nuk janë as befasuese. Megjithatë, ndërsa metalet dhe mineralet kanë qenë eksportet thelbësore – kryesisht si lëndë e parë – për shumë vite, është optimiste të shihet industria e pijeve – e cila përfshin përpunimin dhe shtimin e vlerës – në listë.

<sup>86</sup> Shih Hausmann, Hwang dhe Rodrik (2007).

Tabela 1. Vlerat më të vogla dhe më të mëdha PRODY për periudhën 2010-2020


	Kodi	Mall	Mesatarja PRODY 2010-2020	
Më e vogla	43	Lëkura gëzofi dhe gëzofi artificial; prodhime prej tyre	€	-
	45	Tapa dhe artikujt prej tape	€	-
	50	Mëndafshi	€	-
	88	Avionë, anije kozmike dhe pjesë e tyre	€	2.69
	93	Armë dhe municione; pjesët dhe aksesorët e tyre	€	3.51
Më i madhi	41	Lëkurat dhe lëkurat e papërpunuara (përveç lëkurave të gëzofit) dhe lëkura	€	59,862
	72	Hekur dhe çelik	€	47,702
	11	Produktet e industrisë së mullirit; malt, niseshte, inulinë, gluten gruri	€	44,911
	78	Plumbi dhe artikujt prej tij	€	39,043
	22	Pije, pije alkoolike dhe uthull	€	27,349

Burimi: Llogaritjet e autorit bazuar në të dhënat nga ASK dhe UN Comtrade

Megjithatë, ajo që është më shqetësuese është se vlerat EXPY tregojnë një prirje për rënie midis vitit 2010 dhe 2019, dhe më pas një pikë kthese në 2020, siç

tregohet në Figurën 2 më poshtë. Kjo tregon se produktiviteti i përgjithshëm i eksporteve ka shënuar rënie.

Figura 2. Produktiviteti i shportës së eksporteve 2010-2020



Burimi: Llogaritjet e autorit bazuar në të dhënat nga ASK dhe UN Comtrade

Më shumë të dhëna dhe analiza nevojiten për të përcaktuar arsyen pse, por, Hausmann, Hwang dhe Rodrik (2007) sugjerojnë teorikisht dhe ofrojnë dëshmi empirike për kapitalin njerëzor dhe madhësinë e tregut të punës si përcaktues kyç për nivelin e EXPY të një vendi. Ndërsa ata tregojnë për çështje të mundshme të endogjenitetit kur bëhet fjalë për lidhjen midis kapitalit njerëzor dhe EXPY, ata

pranojnë se një marrëdhënie kauzale midis madhësisë së vendit dhe EXPY është më e besueshme. Kuptimi i korrelacionit të lartë midis EXPY dhe rritjes që e gjejnë Hausmann, Hwang dhe Rodrik (2007) ne konstatojmë, dhe duke pasur parasysh deficitet e mëdha tregtare të Kosovës, se është e domosdoshme të trajtohet çështja e rritjes së produktivitetit të eksporteve gjatë hartimit të politikës industriale.

#### 4. KONKLUZIONE

Deficitet e vazhdueshme tregtare janë një tregues se politika industriale, krahas politikave të tjera, ka nevojë për një reformë të madhe. Një reformë e tillë duhet të ndjekë një qasje shkencore në vend që të krijojë përgjigjet ad hoc ose duke i konsideruar të gjitha industritë si strategjike dhe po aq të rëndësishme. Ndërsa është thelbësore që kjo politikë e re industriale të fokusohet edhe në zëvendësimet e importit, ne kemi ofruar këtu një fillim për fokusim në promovimin e eksporteve. Analiza të mëtejshme nevojiten për të kuptuar vështirësitë dhe pikat e forta të secilës industri, megjithatë indeksi i avantazhit krahasues i zbuluar është një mënyrë për të filluar.

Për më tepër, përveç njohjes së kostos oportune më të ulët, është e rëndësishme të njihet edhe niveli i produktivitetit në çdo industri. Prandaj, ne përdorëm PRODY dhe EXPY si metoda të cilat mund të informojnë politikën industriale në lidhje me industritë individuale dhe tendencat e përgjithshme. Ndonëse, ka disa sektorë që kanë lulëzuar, tendenca e përgjithshme e produktivitetit ka qenë në rënie. Kjo duhet të alarmojë qeverinë që të shqyrtojë seriozisht hartimin e një politike industriale shumë më të plotë dhe më të fokusuar që do të rriste produktivitetin e përgjithshëm në industritë eksportuese.

#### REFERENCAT

- Balassa, B. (1965). Trade Liberalisation and "Revealed" Comparative Advantage. *The Manchester School*, 33(2), 99-123.
- Hausmann, R., Hwang, J., & Rodrik, D. (2007). What you export matters. *Journal of Economic Growth*, 12(1), 1-25.
- Kosovo Agency of Statistics. (2021). *Statistikat e Tregtisë së Jashtme 2020*. 2021: Kosovo Agency of Statistics (KAS).
- Laursen, K. (2000). *Trade Specialisation, Technology and Economic Growth: Theory and Evidence from Advanced Countries*. Cheltenham: Edward Elgar Publishing.
- United Nations. (2021). UN Comtrade Database. Retrieved from <https://comtrade.un.org/>
- World Trade Organization. (2012). *A Practical Guide to Trade Policy Analysis*. World Trade Organization (WTO) and United Nations Conference on Trade and Development (UNCTAD).

## SHTOJCA A

Figura A.1 Përparesia Krahasuese e Normalizuar e Zbuluar e Kosovës 2010-2020

Nr.	Malli	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
1.	Kafshët; të gjalla	0.20	-0.56	-0.67	-1.00	-1.00	-1.00	-1.00	-1.00	-0.93	-1.00	-1.00
2.	Mishi dhe të brendshmet e mishit të ngrënshtëm	-0.94	-0.99	-0.99	-0.98	-0.91	-0.86	-0.80	-0.87	-0.90	-0.79	-0.81
3.	Peshqit dhe krustacet, molusqet dhe jovertebrorët e tjerë ujorë	-0.97	-0.97	-0.85	-1.00	-1.00	-0.97	-0.97	-0.87	-0.91	-0.92	-0.90
4.	Prodhimet e qumështit; vezë zogjsh; mjaltë natyral; produkte ushqimore me origjinë shtazore, të paspecifikuara apo të përfshira diku tjetër	-0.36	-0.68	-0.79	-0.83	-0.79	-0.54	-0.49	-0.59	-0.57	-0.42	-0.43
5.	Produkte me origjinë shtazore; jo të specifikuar apo të përfshira diku tjetër	-1.00	-1.00	-1.00	-1.00	-1.00	-1.00	-1.00	-1.00	-1.00	-0.27	-0.97
6.	Pemë dhe bimë të tjera, të gjalla; qepujka, rrënjë dhe të ngjashme; lulet e prera dhe gjetnja zbukuruese	-0.57	-0.96	-0.92	-0.56	-0.89	-0.80	-0.74	-0.46	-0.31	0.43	0.53
7.	Perimet dhe rrënjët dhe zhardhokët e caktuar; i ngrënshtëm	0.64	0.41	0.53	0.44	0.62	0.41	0.55	0.51	0.61	0.56	0.68
8.	Fruta dhe arra, të ngrënshtëme; lëvozhga e a grumeve ose pjeprit	-0.24	0.05	0.09	0.16	0.17	0.17	0.28	0.54	0.57	0.49	0.58
9.	Kafja, çaji, mate dhe erëza	0.31	-0.20	0.01	0.34	0.54	0.54	0.40	0.54	0.63	0.63	0.69
10.	Drithërat	-0.78	-0.89	-0.92	-0.97	-0.67	-0.49	-0.70	-0.79	-0.70	-0.90	-0.67
Nova Scotia, pjesa e BRE - së në konsumin e energjisë elektrike është më e ulët. Ky nuk është rasti për Albertën pasi në vitin 2017 afërsisht 59% e energjisë elektrike prodhohej nga thëngjillit<sup>125</sup>. Që nga viti 2018, numri i termocentraleve të thëngjillit dhe minierave termike të thëngjillit në të gjitha këto provinca së bashku, ishte 24, me 11 që ndodheshin në Alberta<sup>126</sup>. Numri total i vlerësuar i të punësuarve në sektorin e thëngjillit (miniera dhe termocentrale të thëngjillit) varion ndërmjet: 3,080-3,900<sup>127</sup>. Në përgjigje të krizës së përgjithshme globale të klimës, qeveria federale ka vendosur të përfundojë fazën e largimit të thëngjillit për prodhimin e energjisë elektrike deri në vitin 2030. Në provincën e Albertës, tranzicioni tashmë është duke u zhvilluar për shkak të vendimeve specifike të marra nga qeveria lokale, ndaj në këtë provincë pritet të mbyllen të gjitha termocentralet me thëngjill deri në vitin 2023<sup>128</sup>.

### 5.1.1. POLITIKAT E PLANIFIKUARA/ZBATUARA PËR TË SIGURUAR NJË TRANZICION TË DREJTË ENERGJETIK

Në dritën e vendimit për një ndërprerje të plotë të shfrytëzimit të thëngjillit për prodhimin e energjisë elektrike deri në vitin 2030, qeveria federale si dhe qeveritë provinciale kanë ndërmarrë hapa konkretë për të siguruar që kostoja e tranzicionit të mos përballohet në mënyrë disproporcionale nga punëtorët e thëngjillit dhe nga komunitetet ku ndodhen minierat e thëngjillit dhe termocentralet. Një Task Forcë për Tranzicionin e Drejtë për Punëtorët Kanadezë të Thëngjillit u formua në nivel federal me qëllim identifikimin e çështjeve kryesore dhe ofrimin e rekomandimeve për sigurimin e një tranzicioni të drejtë energjetik. Gjatë vitit 2018, Task Forca vizitoi të gjitha provincat përkatëse, mbajti disa takime me punëtorët e thëngjillit dhe palët tjera të prekura dhe vizitoi disa komunitete të prekura. Bazuar në këto angazhime, ajo ka dhënë rekomandime për qeverinë për të ofruar mbështetje të drejtë tranzicionit<sup>129</sup>. Shumica e këtyre rekomandimeve sillleshin rreth zhvillimit të skemave të ndryshme mbështetëse për punëtorët e ndikuar të thëngjillit. Këto skema lidheshin ose me daljen në pension të parakohshëm ose me ofrimin e mbështetjes financiare dhe arsimore për ata që janë mjaft të rinj për të qëndruar në tregun e punës. Për komunitetet e thëngjillit, Task Forca rekomandoi krijimin e një programi financimi të tranzicionit të drejtë dhe investimin në

projektet e infrastrukturës lokale për të nxitur rritjen ekonomike. Qeveria u këshillua gjithashtu që të zhvillojë një plan gjithëpërfshirës të tranzicionit të drejtë, t'i kushtojë fonde kërkimit të ndikimeve të tranzicionit dhe të përfshijë dispozitat e tranzicionit të drejtë në legjislacionin e punës dhe mjedisit.

Në Alberta tranzicioni filloi më herët për shkak të një vendimi të marrë nga qeveria provinciale për të përshpejtuar fazën e largimit të thëngjillit dhe për të rritur pjesën e BRE në konsumin e përgjithshëm të energjisë elektrike<sup>130</sup>. Fillimisht, qeveria provinciale nuk arriti t'i përfshijë punëtorët dhe komunitetet e prekura. Paneli këshillëdhënës i cili kishte për detyrë të identifikonte ndikimin e largimit të përdorimit të thëngjillit tek punëtorët dhe komunitetet u formua një vit pas marrjes së vendimit për përshpejtimin e largimit nga thëngjilli. Paneli u angazhua në diskutime me të gjitha palët e prekura dhe dha rekomandime të shumta për qeverinë provinciale për mbështetjen e punëtorëve dhe komuniteteve të prekura. Përveç kësaj, sindikatat e punëtorëve në Alberta formuan Koalicionin e tyre të Tranzicionit të Thëngjillit për të mbrojtur të drejtat e punëtorëve të ndikuar dhe ata gjithashtu dhanë rekomandime të cilat u morën parasysh<sup>131</sup>.

Duke marrë parasysh rekomandimet që dolën nga organet e sipërpërmendura, qeveria federale dhe provinciale në Kanada hartuan dhe filluan të zbatojnë projekte konkrete me synimin për të ulur barrën e punëtorëve dhe komuniteteve të thëngjillit.

Si e tillë, në vitin 2018 qeveria federale ndau 35 milionë dollarë për zhvillimin e aftësive dhe projekteve të diversifikimit ekonomik<sup>132</sup>. Një vit më vonë, 105 milionë dollarë u ndanë për financimin e nevojave të infrastrukturës në komunitetet e prekura nga qymyri përmes të ashtuquajturës Iniciativa e Tranzicionit të Thëngjillit në Kanada<sup>133</sup>. Në Alberta, qeveria provinciale ndau një fond tranzicioni prej 40 milionë dollarësh për të financuar programet mbështetëse për punëtorët e thëngjillit të Albertës. Fondi ofron mbështetje për punëtorët e thëngjillit në mënyra të ndryshme duke filluar nga financimi i trajnimeve të ndryshme e deri te ofrimi i shërbimeve të këshillimit për karrierë dhe përputhjes së punës me shkathtësitë. Më konkretisht, fondi ofron mbështetje në format e mëposhtme<sup>134</sup>.

1. Punëtorët që kërkojnë ripunësim kanë të drejtë për financim të ripunësimit në masën 75% të të ardhurave javore kur kombinohen me përfitimet e sigurimit të punësimit. Kjo mbështetje është e disponueshme deri në 45 javë ose derisa punëtori të gjejë një punë të re me orar të plotë;
2. Punëtorët që janë afër pensionimit, por që ende nuk kanë të drejtë për pension, kanë të drejtë për një grant që mbulon 75% të të ardhurave të tyre të mëparshme javore derisa të fitojnë të drejtën për pension;

<sup>125</sup> Task Force on Just Transition for Canadian Coal Workers 2018). A Just and Fair Transition for Canadian Coal Workers and Communities. Government of Canada.

<sup>126</sup> Ibid.

<sup>127</sup> Ibid.

<sup>128</sup> Ibid.

<sup>129</sup> Ibid.

<sup>130</sup> Labour Education Centre (2020). Just Transition: Exactly What's in it for Workers? Alberta: Labour Education Centre.

<sup>131</sup> Ibid.

<sup>132</sup> Jackson, E., & Hussey, I. (2019). Alberta's Coal Phase-Out: A Just Transition? . Alberta: Parkland Institute.

<sup>133</sup> Ibid.

<sup>134</sup> Ibid.

3. Punëtorët që detyrohen të lëvizin më shumë se 40 km për t'u ripunësuar, kanë të drejtën e një shume prej 5,000 dollarë për shpenzimet e tyre të zhvendosjes;
4. Punëtorët që dëshirojnë të hyjnë në programet e trajnimit kanë të drejtën e mbulimit të shkollimit deri në 12,000 dollarë;
5. Këshillim për karrierë dhe shërbime të tjera punësimi për punëtorët e thëngjillit;
6. Lehtësues të kualifikuar që mund të angazhohen për të ndihmuar punëdhënësit, punëtorët dhe sindikatat me ngritjen e një komiteti për përshtatjen e fuqisë punëtore për të krijuar një plan të përshtatur tranzicioni për vendpunishtet individuale duke përdorur hulumtimin e tregut të punës.

Fondi u bë funksional në vitin 2018 dhe përveç tij, Alberta ndau gjithashtu 35 milionë dollarë për të mbështetur komunitetet e prekura përmes zbatimit të projekteve të ndryshme që do të çojnë në diversifikimin ekonomik në zonat ku ndodheshin minierat e thëngjillit dhe termocentralet e thëngjillit<sup>135</sup>. Kjo u bë nëpërmjet Fondit të Tranzicionit të Thëngjillit dhe nëpërmjet një programi ekonomik rajonal. Ndërsa Fondi i Tranzicionit të thëngjillit u fokusua kryesisht në financimin e studimeve dhe planeve për diversifikimin ekonomik, qeveria e Albertës vendosi gjithashtu të ndërtojë dy autostrada të reja të cilat do të hapin perspektiva të reja ekonomike dhe do të çojnë në punësimin e rreth 800 njerëzve<sup>136</sup>. Krahas programeve të nxjerra nga qeveria provinciale, ka raste kur vetë pushtetet vendore kanë nisur studime për potencialin ekonomik të fushave të ndryshme si, zhvillimi i bujqësisë dhe kanë filluar të punojnë për tërheqjen e investimeve të reja private për të mbuluar humbjet e pritshme të vendeve të punës në teritoret e tyre<sup>137</sup>.

## 5.2. ZONA E RUHRIT, GJERMANI

Gjermania është mbështetur tradicionalisht në dy lloje të thëngjillit: thëngjilli i fortë dhe thëngjilli i kafe, i njohur edhe si linjit. Ndërsa i pari ishte nxjerrë në zona të rënda industriale, linjiti gjendej kryesisht në zonat rurale me popullsi të ulët, duke e bërë energjinë dhe minierat industri kryesore atje<sup>138</sup>.

Megjithatë, në vitin 2018, minierave të thëngjillit në Gjermani u erdhi fundi. Ky nuk ishte një vendim i papritur, por një rrugë e planifikuar nga viti 2007. Arsyeimi për këtë veprim është kryesisht i dyfishtë: a) për shkak të thëngjillit më të lirë në rajon, nuk kishte kuptim që vendi të mbështetej te thëngjilli i fortë,

dhe b) për shkak të premtimeve të Gjermanisë për diversifikimin e kombinimit të energjisë, mbështetja në qymyrin e fortë do të përbënte një pengesë për përmbytjen e traktateve ndërkombëtare<sup>139</sup>. Gjermania është zotuar gjithashtu të heqë gradualisht linjitin dhe të gjithë prodhimin e energjisë me thëngjill, përmes një Komisioni "Largimi nga Thëngjilli" për të monitoruar të gjithë procesin<sup>140</sup>. Kombinimi energjetik i vendit tani përbëhet nga burimet si nafta, linjiti, gazi natyror, centrali bërthamor, biokarburantet dhe mbetjet, si dhe energjia e erës dhe diellit<sup>141</sup>.

### 5.2.1. ZONA E RUHR-IT DHE MËSIMET E NXJERRA

Nëse ka një mësim gjithëpërfshirës që duhet hequr nga rasti i Ruhr-it është se një tranzicion i drejtë është një proces i gjatë që kërkon bashkëpunimin e akterëve shumë dimenzionalë, që del nga a) roli i institucioneve arsimore, b) roli i qeverisë, dhe c) roli i sindikatave, bizneseve, komuniteteve lokale dhe OJQ-ve. Më poshtë janë fushat kryesore të fokusit që duhen pasur parasysh për të siguruar një tranzicion të drejtë.

**Humbja e vendeve të punës dhe rikualifikimi përmes reformave arsimore:** Shqetësimi kryesor për heqjen graduale të thëngjillit në çdo vend ka të bëjë padyshim me punëtorët e sektorit të thëngjillit dhe çfarë do të ndodhë me ta. Mësimet e nxjerra nga zona e Ruhr-it përfshijnë sa vijon:

- Në varësi të moshës së punëtorëve, vendi mund të mbështetet si në pensionet e parakohshme, nëse një gjë e tillë konsiderohet e realizueshme, ashtu edhe në ripërdorimin e aftësive në sektorë të tjerë për ata punëtorë që janë relativisht të rinj dhe që mbeten në tregun e punës. Për shembull, kur thëngjilli u hoq nga përdorimi në zonën e Ruhr-it, njerëzit u ripunësuan në sektorë të tjerë, duke përfshirë sektorin e burimeve të ripërtitshme si dhe atë të metalit.
- Për të ndihmuar kalimin nga një industri në tjetrën, mund të synohen edhe politikatat arsimore ose a) të sigurojnë rikualifikim të hershëm profesional në punë për ata që janë të punësuar në sektorin e thëngjillit dhe b) investime publike në shkollë të gjerë për të zhvilluar universite të fuqishme dhe sistemet arsimore teknike<sup>142</sup>.
- Fokusi i madh në financimin e kërkimit dhe zhvillimit brenda universiteteve - një faktor që i ka mundësuar Ruhr-it të kalojë nga një shoqëri industriale në një shoqëri të bazuar në njohuri e cila e ka rritur kërkesën për mbajtjen dhe tërheqjen e punëtorëve të kualifikuar.

<sup>135</sup> Ibid.

<sup>136</sup> Ibid.

<sup>137</sup> Ibid.

<sup>138</sup> National Economic and Social Council. (2020). Four Case Studies on Just Transition. Lessons for Ireland

<sup>139</sup> European Commission (2019a), Coal Regions in Transition. [https://ec.europa.eu/en\\_ergy/en/topics/oil-gasand-coal/EU-coalregions/coal-regionstransition](https://ec.europa.eu/en_ergy/en/topics/oil-gasand-coal/EU-coalregions/coal-regionstransition) 12/12/19..

<sup>140</sup> National Economic and Social Council. (2020). Four Case Studies on Just Transition. Lessons for Ireland

<sup>141</sup> IEA. (2021). Germany. Retrieved from <https://www.iea.org/countries/germany>

<sup>142</sup> Cooke, P. (1995a), 'Introduction' in P. Cooke (Ed.), The Rise of the Rustbelt, London: University College London. 1-19.

**Reformat ekonomike dhe industriale:** Pavarësia ekonomike dhe industriale e Ruhr-it nga thëngjilli ka qenë një proces i gjatë, veçanërisht për shkak të subvencioneve të dhëna për kompanitë e minierave dhe të thëngjillit, të cilat bllokuan zhvillimin e sektorëve të rinj:

- në vend të synimit të subvencioneve dhe sistemeve të tjera mbështetëse drejt financimit të sektorëve me bazë thëngjilli, i njëjti financim mund të përdoret për të forcuar kompanitë dhe sektorët që duket se janë "udhëheqës" në treg për sa i përket përparësisë krahasuese.
- identifikimi, monitorimi dhe shpërndarja e fondeve është menaxhuar në mënyrë efektive sepse sistemi i qeverisjes që udhëhoqi me tranzicionin ka qenë në nivel rajonal dhe jo federal.

**Problemi financiar dhe siguria e fondeve:** Në shembullin e Ruhr-it, për shkak se heqja graduale e thëngjillit ishte një vendim qeveritar që rezultoi nga shqetësimet e ndryshimeve klimatike, tranzicioni është financuar kryesisht nga niveli kombëtar, në vend që të bazohet në donatorë dhe financime afatshkurtra nga të tjerët.

**Vendosmëria për një datë të largimit dhe bashkëpunimi i të gjithë akterëve kryesorë:** Përcaktimi i një date të largimit në fazat e hershme rezultoi të jetë vendimtar për zonën e Ruhr-it dhe duhet pasur parasysh se kur përcaktohen afate të ngjashme për Kosovën - afate të cilat nuk do të varen nga ciklet e biznesit miopik politik, por shtrihen në një perspektivë më afatgjatë. Për më tepër, nëse Kosova dekarbonizohet sa më mirë që të jetë e mundur, është e nevojshme që të jenë të gjithë akterët në bord, nga qeveria te shoqëria civile, e deri tek qytetari.

### 5.3. REPUBLIKA ÇEKE

Republika Çeke, në mënyrë të konsiderueshme varet nga thëngjilli me 35.43% të të gjithë energjisë dhe 39.74% të energjisë elektrike që prodhohet nga ky burim<sup>143</sup>. Përafërsisht 50% e të gjithë prodhimit të energjisë elektrike në vend bazohet në lëndët djegëse fosile<sup>144</sup>. Aktiviteti i minierave të thëngjillit zhvillohet në tre rajone të thëngjilli: Ústecký, Karlovarský dhe Moravskoslezský. Gjatë 15 viteve të fundit prodhimi i thëngjillit ka qenë në rënie dhe numri i të punësuarve është ulur ndjeshëm për shkak të importeve më të lira të thëngjillit nga jashtë dhe kufijve të minierave

të vendosura si pjesë e legjislacionit mjedisor<sup>145</sup>. Strategjia aktuale e energjisë parashikon zëvendësim gradual të thëngjillit me energji bërthamore dhe burime të ripërtrishme në sektorin e energjisë elektrike deri në vitin 2040<sup>146</sup>. Republika Çeke nuk ka një datë përfundimtare të përfundimit të fazës së thëngjillit. Fillimisht vendi po shqyrtonte përfundimin e largimit deri në vitin 2038, megjithatë, datat e mëparshme po rikonsiderohen në dritën e rritjeve të pritshme të çmimeve që rezultojnë nga kufijtë e lejimit të emetimeve<sup>147</sup>. Me Marrëveshjen e Gjelbër në fuqi dhe me angazhimet e reja për të reduktuar emetimet e GS deri në vitin 2030, vendi po përballlet me presionin për të përsheptuar kalimin në një sistem me energji të pastër.

#### 5.3.1. POLITIKA TË PLANIFIKUARA/ZBATUARA PËR TË SIGURUAR NJË TRANZICION TË DREJTË ENERGJETIK

Edhe pse qeveria nuk ka vendosur ende një datë përfundimtare të përfundimit të fazës së thëngjillit, Republika Çeke ka zhvilluar tashmë një strategji tranzicioni për rajonet e saj të thëngjillit. Strategjia, e referuar si RE:START u zhvillua si një përgjigje ndaj rënies së prodhimit të thëngjillit dhe vendeve të punës me thëngjill<sup>148</sup>. Zhvillimi i strategjisë u drejtua nga Ministria e Zhvillimit Rajonal, megjithatë, në informimin e strategjisë dhe masave specifike, niveli kombëtar bashkëpunoi ngushtë me palët e interesuara lokale për të mbledhur të dhëna dhe për të hartuar zgjidhje të përshtatura me nevojat e rajoneve në tranzicion<sup>149</sup>. Përveç autoriteteve rajonale dhe lokale, pjesë e ekipit kontribues në zhvillimin e RE:START janë edhe sektori i biznesit, zyrat e punës dhe OJQ-të. RE:START mbështetet nga një kombinim fondesh kombëtare dhe të BE-së dhe deri në vitin 2030 parashikon të shpërndajë 1.5 miliardë euro për zhvillimin e projekteve të ndryshme<sup>150</sup>. Përveç kësaj, tre rajonet e thëngjillit në vend tashmë po zbatojnë aktivitete si: ngritja e qendrave të inovacionit për stimulimin e zhvillimit të biznesit lokal, zhvillimi i programeve arsimore për popullatën vendase dhe zhvillimi i platformave për zhvillimin e modeleve të transformimit rajonal.<sup>151</sup>

<sup>143</sup> Ritchie, H., & Roser, M. (n.d.). Czechia: Energy Country Profile. Retrieved from <https://ourworldindata.org/energy/country/czech-republic>

<sup>144</sup> ibid

<sup>145</sup> European Commission (2019). Re-Start: Strategy for economic restructuring of Czech coal regions. [https://ec.europa.eu/energy/sites/default/files/documents/restartstrategy\\_for\\_economic\\_restructuring\\_of\\_czech\\_coal\\_regions.pdf](https://ec.europa.eu/energy/sites/default/files/documents/restartstrategy_for_economic_restructuring_of_czech_coal_regions.pdf)

<sup>146</sup> ibid

<sup>147</sup> ibid

<sup>148</sup> ibid

<sup>149</sup> ibid

<sup>150</sup> ibid

<sup>151</sup> R. Dudcu, G. G.-Y.-C. (2019). Transformation Experiences of Coal Regions: Recommendations for Ukraine and other European countries. Center for Environmental Initiatives Ecoaction.

<sup>152</sup> European Commission. (2020). The Just Transition Mechanism: making sure no one is left behind [https://ec.europa.eu/info/strategy/priorities-2019-2024/european-green-deal/finance-and-green-deal/just-transition-mechanism\\_en](https://ec.europa.eu/info/strategy/priorities-2019-2024/european-green-deal/finance-and-green-deal/just-transition-mechanism_en)

<sup>153</sup> ibid



## 5.4. TRANZICION I DREJTË NË NIVEL TË BE-SË

Në dritën e synimit të miratuar për t'u bërë neutral ndaj klimës deri në vitin 2050, BE-ja ka krijuar Mekanizmin e Tranzicionit të Drejtë (MTD) i cili do të shërbejë si mjeti kryesor për të ulur barrën e tranzicionit në rajonet më të prekura të BE-së. MTD pritet të mobilizojë deri në 65-75 miliardë euro gjatë periudhës 2021-2027<sup>152</sup>. Fondet do të sigurohen në formën e granteve, garancive buxhetore dhe kredive nga Banka Evropiane e Investimeve (EIB). Shtetet anëtare do të duhet të përcaktojnë rajonet e tyre më të prekura dhe të hartojnë plane të tranzicionit të drejtë territorial për të qenë në gjendje të përfitojnë nga mekanizmi. MTD pritet të ofrojë ndihmë në format e mëposhtme<sup>153</sup>

- Njerëzit dhe qytetarët e cenueshëm do të mbështeten në lehtësimin e ripunësim-it, rikualifikimin, përmirësimin e bane-save me efikasitet energjetike, luftimin e varfërisë energjetike dhe lehtësimin e aksesit në energji të pastër dhe të përballueshme;
- Kompanitë dhe sektorët aktivë në industrinë intensive të karbonit do të mbështeten në tranzicion drejt teknologjive me karbon të ulët dhe diversifikimit ekonomik, bazuar në investime dhe vende pune rezistente ndaj klimës, duke krijuar kushte tërheqëse për investitorët publikë dhe privatë, duke ofruar qasje më të lehtë në kredi dhe mbështetje financiare, duke investuar në krijimin e firmave të reja, NVM-ve dhe bizneseve fillestare, dhe investimin në aktivitete kërkimore dhe inovative.
- Rajonet shumë të varura nga lëndët djegëse fosile dhe industrinë intensive të karbonit do të mbështeten në tranzicion drejt aktiviteteve me karbon të ulët dhe rezistent ndaj klimës, duke krijuar vende të reja pune në ekonominë e gjelbër, duke investuar në transportin publik dhe të qëndrueshëm, duke ofruar asistencë teknike, duke investuar në burimet e ripërtritshme të energjisë, përmirësimin e lidhjes dixhitale, sigurimin e kredive të përballueshme për autoritetet publike lokale, përmirësimin e infrastrukturës energjetike, rrjeteve të ngrohjes qendrore dhe transportit.

## 5.5. ÇFARË MUND TË MARRIM PREJ KËTYRE TRI RASTEVE

Tranzicionet e energjisë ndryshojnë nga një rast në tjetrin pasi kapacitetet teknike, por edhe situatat ekonomike dhe sociale janë unike për zonën e

caktuar në fjalë. Megjithatë, në përgjithësi, ekzistojnë disa modele të ngjashme se si vendet në fjalë po i trajtojnë këto transformime.

### Strategjitë dhe objektivat e qarta të miratuara nga Qeveria

Kanadaja dhe Gjermania kanë vendosur paraprakisht datat e largimit nga thëngjilli dhe kanë miratuar strategji që përcaktojnë kombinimet e pritshme të energjisë në të ardhmen. Republika Çeke ende nuk ka miratuar datën e përfundimit të fazës së thëngjillit, megjithatë ekziston strategjia për diversifikimin e energjisë. Marrja e këtyre vendimeve dhe komunikimi i tyre me publikun sa më shpejt që të jetë e mundur është i nevojshëm sepse palët e interesuara do të kenë një kuptim më të qartë se kah po shkon ky sektor.

### Krijimi i organeve specifike për tranzicion të drejtë

Në të tria rastet qeveritë ishin të gatshme të siguronin një tranzicion të drejtë energjetik. Duke qenë kështu, të gjithë ata formuan organe specifike, të cilët kishin për detyrë të skanonin situatën në terren, të analizonin të dhënat dhe t'u ofronin rekomandime të përshtatura qeverive për t'u siguruar që askush të mos mbetet pas.

### Përfshirja e të gjitha palëve të prekura në fillim të procesit të planifikimit

Kontributi nga punëtorët e thëngjillit, komunitetet e qymyrit, sindikatat dhe agjencitë e punës, sektori i biznesit dhe OJQ-të, ishte me rëndësi qendrore kur bëhej fjalë për hartimin e politikave dhe ndërhyrjeve specifike. Nëpërmjet kësaj, Kanadaja dhe Republika Çeke ishin në gjendje të përshtatnin programe për nevojat e njerëzve në terren.

### Synimi i nevojave të punëtorëve të pushuar nga puna si dhe nevojave të rajoneve të prekura

Si Kanadaja ashtu edhe Gjermania kanë bërë shumë përpjekje në identifikimin e nevojave të punëtorëve të prekur të thëngjillit, si dhe nevojave të rajoneve të thëngjillit. Qeveritë formuan fonde specifike përmes të cilave ato ofruan mbështetje për punëtorët e pushuar nga puna në formën e përfitimeve të punësimit, pensionimit të parakohshëm, rialokimit dhe rikualifikimit. Gjithashtu, shumica të mëdha fondesh u ndanë në rajonet e thëngjillit me qëllim të diversifikimit ekonomik të tyre. Një faktor i rëndësishëm që duhet përmendur këtu është se këto ndërhyrje nuk erdhën gjithmonë nga lart, ka pasur raste kur vetë rajonet e prekura kanë marrë masa konkrete për diversifikimin ekonomik. Në rastin e Gjermanisë, politikat konkrete arsimore, si dhe financimi i kërkimit dhe zhvillimit, lehtësuan kalimin e zonës së Ruhrit nga një rajon i thëngjillit në një ekonomi të bazuar në njohuri.

<sup>152</sup> European Commission. (2020). The Just Transition Mechanism: making sure no one is left behind <https://ec.europa.eu/info/strategy/priorities-2019-2024/european-green-deal/finance-and-green-deal/just-transition->

<sup>153</sup> Ibid

## 6. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Gati e gjithë energjia elektrike në Kosovë prodhohet nga dy termocentralet e vjetëruara me thëngjill, njërit prej të cilëve i ka kaluar afati i dekomisionimit. Kjo paraqet kërcënime të mëdha mjedisore dhe shëndetësore. Përveç kësaj, energjia në Kosovë është përgjegjëse për mbi 80% të emetimeve të GS. Kosova nuk është nënshkruese e Marrëveshjes së Parisit, megjithatë është pjesë e Komunitetit të Energjisë dhe synon të integrohet në Bashkimin Evropian. Për këtë arsye, zhvillimet në BE në lidhje me energjinë kanë implikime të drejtpërdrejta për vendin. Në përgjigje të krizës së përgjithshme globale të klimës, BE-ja ka vendosur të bëhet neutrale ndaj karbonit deri në vitin 2050. Vendet e Ballkanit Perëndimor e kanë miratuar Deklaratën e Sofjes, përmes së cilës u zotuan t'i bashkohen BE-së në përpjekjet e saj për dekarbonizimin e ekonomisë deri në mesin e shekullit. Kosova ka një potencial të konsiderueshëm të BRE-ve, i cili mund të shfrytëzohet, veçanërisht për energjinë diellore dhe atë të erës. Megjithatë, ka sfida që vendi duhet t'i zgjidhë. Në nivel teknik, sfidat kryesore për rritjen e pjesës së BRE-ve në konsumin final të energjisë janë mungesa e integritetit të tregut rajonal të energjisë si dhe mungesa e kapaciteteve akumuluese dhe atyre rezervë. Në aspektin financiar, ekziston nevoja për krijimin e një mekanizmi mbështetës financiar të bazuar në treg për të nxitur investimet në këtë fushë. Së fundi, në përfundimin e një tranzicioni të suksesshëm energjetik, Kosova duhet të sigurojë që barra të ndahet në mënyrë të barabartë dhe të merren parasysh nevojat e grupeve dhe komuniteteve të cenueshme. Bazuar në përvojën e vendeve të cilat tashmë janë duke kaluar në një sistem të energjisë së pastër, Kosova do të duhej të:

1. Vendoset një objektiv të qartë afatgjatë të dekarbonizimit. Ky do të jetë hapi i parë i cili do të përcaktojë çështjet kyçe si kombinimet e pritshme të prodhimit të energjisë dhe datat e pritshme për largimin e përdorimit të thëngjillit. Përvojat nga vendet e tjera tregojnë se planifikimi i hershëm do të jetë kyç për uljen e çdo ndikimi të mundshëm negativ në grupet e cenueshme, si punëtorët e thëngjillit dhe komunitetet e tjera. Përcaktimi i kombinimit të ardhshëm të prodhimit të energjisë duhet të paraprihet nga një analizë strikte teknike dhe financiare. Mirëpo, veprimet për të cilat nuk do të ketë pendim, e të cilat mund të ndërmerren menjëherë përfshijnë investime në eficientësi të energjisë dhe investimet në zgjerimin e sistemeve të ngrohjes qendrore. Më herët është thënë se shumë qytetarë në Kosovë për ngrohje përdorin rrymën elektrike, veçanërisht në zonat urbane. Ndërtesat e banimit po ashtu ndikojnë me një pjesë të madhe të konsumit të energjisë. Qeveria qendrore dhe komunat duhet të fokusohen në zgjerimin e rrjeteve të ngrohjes qendrore dhe në futjen e stimujve financiarë për eficientësi të energjisë në

sektorin e banimit. Investimet në këta sektorë do të sjellin edhe ndikime ekonomike pozitive.

2. Punohet për krijimin e një mjedisi të favorshëm për përfshirjen e sektorit privat për tranzicionin drejt një sistemi me energji të pastër. Meqenëse, lëndët djegëse fosile do të zëvendësohen gradualisht me burimet e ripërtrishme të energjisë, kërkesat për produkte të energjisë së ripërtrishme dhe shërbimeve të lidhura me energjinë e ripërtrishme do të rriten. Kompania e parë që prodhon dhe eksporton panele diellore në rajon është themeluar në Kosovë. Duke pasur parasysh të ardhmen e sistemit energjetik, vendi duhet të fokusohet në ofrimin e mbështetjes së nevojshme për bizneset e ngjashme për të përmirësuar përparësitë e tyre krahasues. Kjo mbështetje mund të ofrohet në formën e stimujve financiarë ose në formën e ndërhyrjeve të tjera të politikave si, krijimi i qendrave të inovacionit për të stimuluar zhvillimin e ndërmarrësisë në këtë sektor. Si hap i parë, qeveria duhet të përpikët të vlerësojë nevojat e bizneseve që operojnë në këtë fushë në bazë të të cilave mund të përcaktojë një pako të përshtatur ndërhyrjesh që synojnë të ndihmojnë këto biznese në përmirësimin e performancës së tyre.

Kur bëhet fjalë për sektorin privat, një ndërhyrje e rëndësishme është përshtetimi i krijimit të një skeme mbështetëse me bazë të theksuar (në formën e ankandeve të energjisë së rinovueshme) për të inkurajuar investime me kosto efektive në prodhimin e energjisë së rinovueshme.

3. Intervenohet në sistemin arsimor për të reduktuar mospërputhjen midis aftësive të fituara në shkollë dhe atyre të kërkuara nga tregu i punës. Këto intervenime mund të përqendrohen në krijimin e programeve të reja të trajnimit të ofruara në qendrat për arsim dhe aftësim profesional, duke pasur parasysh se kërkesa për profesionistë në fushën e energjisë së ripërtrishme do të rritet me heqjen e përdorimit të thëngjillit në rrafshin global. Kjo është veçanërisht e rëndësishme kur merret parasysh përparësia krahasuese që ka Kosova për shkak të popullatës së saj të re. Intervenime të ngjashme mund të bëhen edhe në nivelet e arsimit të lartë, ku vendi mund të fokusohet në përmirësimin e humltimeve dhe inovacionit në fushën e burimeve të ripërtrishme. Hapi i parë në arritjen e këtij transformimi është vlerësimi i situatës në terren. Një vlerësim i zbrastirave mund të kryhet për të vlerësuar mospërputhjen midis aftësive të fituara dhe kërkesës së tregut të punës (përfshirë kërkesën e parashikuar). Në bazë të kësaj, qeveria mund të hartojë intervenime specifike në sistemin arsimor.

4. Zhvillohen tani strategjitë për diversifikimin ekonomik për të luftuar humbjet ekonomike të parashikuara nga mbyllja e termocentraleve me thëngjill dhe minierave të thëngjillit, duke minimizuar kështu goditjet ekonomike që i atribuohen tranzicionit. Kjo vlen veçanërisht për rajonet me thëngjill si komuna e Obiliqit. Qeveria, si në rastin e Kanadasë, mund të bëjë vlerësime mbi potencialin ekonomik të rajonit.
5. Në varësi të vendimit lidhur me datën e përfundimit të përdorimit të thëngjillit, Kosova duhet të fillojë të punojë në identifikimin e numrit të individëve të prekur që janë të punësuar drejt-përdrejt në sektorin e thëngjillit dhe karakteristikat e tyre kryesore si arsimimi, mosha dhe shkathtësitë. Në varësi të këtyre karakteristikeve mund të kryhen përshtatje të ndryshme. Për punëtorët që do të jenë afër pensionit, pensioni i parakohshëm mund të konsiderohet si një opsion. Për ata që janë relativisht më të rinj, ka nevojë për programe specifike trajnimi ose rikualifikimi për t'u mundësuar kalimin në profesione të tjera. Në këtë proces tranzicioni punëtorëve duhet t'u ofrohen përfitimet e punësimit. Në hartimin e këtyre politikave, integrimi i kontributit të qytetarëve të ndikuar është i një rëndësie të madhe.
6. Angazhimi në dialog të ngushtë me donatorët për të siguruar mbështetje financiare dhe transferimin e njohurive në mënyrë që të zbusni procesin e tranzicionit. Si një kandidate e mundshme për anëtarësim në BE, Kosova ka të drejtë të marrë fonde sipas Instrumentit për Asistencën e Para-Anëtarësimit (IPA III ). Me miratimin e Deklaratës së Sofjes, IPA III (e cila mbulon periudhën 2021-2027) pritet të ketë një fokus shumë më të zgjeruar në ndryshimet klimatike dhe në kalimin në një ekonomi me karbon të ulët. Prandaj, është e domosdoshme që Kosova të punojë në zhvillimin e projekt propozimeve të qarta të cilat mund të mbështeten nga ky instrument. Kosova mund të përdorë IPA-në për financimin e projekteve të infrastrukturës si dhe për ndërtimin e kapaciteteve dhe bartjen e njohurive. Fondet e IPA-s po ashtu mund të kombinohen me kredi të buta nga institucionet e ndryshme ndërkombëtare financiare (IFI) nën Kornizën e Investimeve të Ballkanit Perëndimor (WBIF) për të financuar projekte të mëdha infrastrukturore të cilat janë prioritet për vendin. Gjithashtu, vendi duhet të punojë edhe në identifikimin e mundësive të bashkëpunimit me donatorë të tjerë bilateral që janë aktivë në sektorin e energjisë.

## REFERENCAT

- Labour Education Centre** (2020). Just Transition: Exactly What's in it for Workers? Alberta: Labour Education Centre.
- Cooke, P.** (1995a), 'Introduction' in P. Cooke (Ed.), *The Rise of the Rustbelt*, London: University College London. 1-19.
- Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ)**. (2018). Kosovo Energy Efficiency Project. Retrieved from [www.giz.de](http://www.giz.de): [https://www.giz.de/en/downloads/Factsheet%20KEEP\\_EN\\_final.pdf](https://www.giz.de/en/downloads/Factsheet%20KEEP_EN_final.pdf)
- Emden, J., Ahmad, H., Murphy, L., & Cameron, C.** (2020). LESSONS LEARNED: JUST TRANSITIONS FROM AROUND THE WORLD. Institute for Public Policy Research (IPPR). <http://www.jstor.org/stable/resrep32562>
- ERO** (2020). Electricity and Thermal Energy Balance 2020. Prishtina: ERO. Retrieved from <http://ero-ks.org/2020/Sektoret/ELECTRICITY%20AND%20THERMAL%20ENERGY%20ANNUAL%20BALANCE%202020.pdf>
- European Commission** (2018). Proposal for the Regulation of the European Parliament and of the Council Establishing the Instrument for Pre-Accession Assistance (IPA III). Retrieved from [eur-lex.europa.eu](http://eur-lex.europa.eu): [https://eur-lex.europa.eu/resource.html?uri=cellar:827c66b8-6fb3-11e8-9483-01aa75ed71a1.0002.03/DOC\\_1&format=PDF01aa75ed71a1.0002.03/DOC\\_1&format=PDF](https://eur-lex.europa.eu/resource.html?uri=cellar:827c66b8-6fb3-11e8-9483-01aa75ed71a1.0002.03/DOC_1&format=PDF01aa75ed71a1.0002.03/DOC_1&format=PDF)
- European Commission** (2019). Re-Start: Strategy for economic restructuring of Czech coal regions. [https://ec.europa.eu/energy/sites/default/files/documents/re-startstrategy\\_for\\_economic\\_restructuring\\_of\\_czech\\_coal\\_regions.pdf](https://ec.europa.eu/energy/sites/default/files/documents/re-startstrategy_for_economic_restructuring_of_czech_coal_regions.pdf)
- European Commission** (2019a), Coal Regions in Transition. <https://ec.europa.eu/energy/en/topics/oil-gas-and-coal/EU-coalregions/coal-regionstransition12/12/19>.
- European Commission**. (2020). Kosovo 2020 Report. Brussels: European Commission.
- European Commission**. (2020). The Just Transition Mechanism: making sure no one is left behind [https://ec.europa.eu/info/strategy/priorities-2019-2024/european-green-deal/finance-and-green-deal/just-transition-mechanism\\_en](https://ec.europa.eu/info/strategy/priorities-2019-2024/european-green-deal/finance-and-green-deal/just-transition-mechanism_en)
- Government of Canada** (2021). Provinces and territories. Retrieved from [www.canada.ca](http://www.canada.ca): <https://www.canada.ca/en/intergovernmental-affairs/services/provinces-territories.html>
- Harvey, F.** (2020, December). UN secretary general urges all countries to declare climate emergencies. Retrieved from [theguardian.com](http://theguardian.com): <https://www.theguardian.com/environment/2020/dec/12/un-secretary-general-all-countries-declare-climate-emergencies-antonio-guterres-climate-ambition-summit>
- IEA**. (2021). Germany. Retrieved from <https://www.iea.org/countries/germany>
- ILO**. (2015). Guidelines for a just transition towards environmentally sustainable economies and societies for all. Geneva: ILO
- IRENA**. (2017). Renewable Energy and Jobs – Annual Review 2017. Retrieved from [www.irena.org](http://www.irena.org): <https://www.irena.org/publications/2017/may/renewable-energy-and-jobs--annual-review-2017>
- Jackson, E., & Hussey, I.** (2019). Alberta's Coal Phase-Out: A Just Transition? . Alberta: Parkland Institute.
- Kosovo Energy Efficiency Agency** (2019). National Energy Efficiency Action Plan 2019 - 2021. Prishtina: Kosovo Energy Efficiency Agency.
- Kosovo Energy Efficiency Agency** (2019). National Energy Efficiency Action Plan 2019 - 2021. Prishtina: Kosovo Energy Efficiency Agency.
- Kosovo Environmental Protection Agency**. (2020). Annual Report on the State of Air 2019. Prishtina : Kosovo Environmental Protection Agency.
- Krejci, M., & Božidar Radovic, A. G.** (2020). Assessment of the potential to deliver utility-scale dispatchable renewable power to Kosovo.
- Lajqi, S., Durin, B., Berisha, X., & Plantak, L.** (2020). Analysis of the Potential for Renewable Utilization in Kosovo Power Sector. *Environments*. doi:10.3390/environments7060049
- Matthias Buck, K. G.** (2018). Phasing in Renewables Towards a prosperous and sustainable energy future in Kosovo: challenges and possible solutions. Bonn: Germanwatch e.V.
- Ministry of Economy** (2013). National Renewable Action Plan of Kosovo. Retrieved from <https://www.energy-community.org/implementation/Kosovo/reporting.html>
- Ministry of Economy**. (2017). Energy Strategy of the Republic of Kosovo. Retrieved from [me.rks-gov.net](http://me.rks-gov.net): [https://me.rks-gov.net/repository/docs/Energy\\_Strategy\\_of\\_the\\_Republic\\_of\\_Kosovo\\_2017\\_-\\_2026.pdf](https://me.rks-gov.net/repository/docs/Energy_Strategy_of_the_Republic_of_Kosovo_2017_-_2026.pdf)

- Ministry of Economy.** (2021). Kosovo's Fourth Progress Report on promotion and use of energy from renewable energy sources, 2018-2019. Retrieved from [www.energy-community.org](http://www.energy-community.org): <https://www.energy-community.org/implementation/Kosovo/reporting.html>
- National Economic and Social Council.** (2020). Four Case Studies on Just Transition. Lessons for Ireland
- National Economic and Social Council.** (2020). Four Case Studies on Just Transition. Lessons for Ireland
- R. Dudu, G. G.-Y.-C. (2019).** Transformation Experiences of Coal Regions: Recommendations for Ukraine and other European countries. Center for Environmental Initiatives Ecoaction.
- Ritchie, H., & Roser, M. (n.d.).** Czechia: Energy Country Profile. Retrieved from <https://ourworldindata.org/energy/country/czech-republic>
- Smith, S. (2017).** Just Transition: A report for the OECD. Just Transition Centre.
- Sofia Declaration on the Green Agenda for Western Balkans.** (2020). Retrieved from [berlinprocess.info](http://berlinprocess.info): <https://berlinprocess.info/wp-content/uploads/2021/02/Leaders-Declaration-on-the-Green-Agenda-for-the-WB.pdf>
- Spasi, V. (2019).** KOSTT, OST sign deal to establish Kosovo-Albania regulatory block. Retrieved from [balkangreenenergynews.com](http://balkangreenenergynews.com): <https://balkangreenenergynews.com/kostt-ost-sign-deal-to-establish-kosovo-albania-regulatory-block/>
- Task Force on Just Transition for Canadian Coal Workers 2018). A Just and Fair Transition for Canadian Coal Workers and Communities. Government of Canada.
- Techene, F. (2017, June).** Next to KEK, a toxic blue lake that could spell disaster. Retrieved from [prishtinainsight.com](http://prishtinainsight.com): <https://prishtinainsight.com/next-kek-toxic-blue-lake-spell-disaster-mag/>
- The World Bank (2018).** Energy in Kosovo. Retrieved from [worldbank.org](http://worldbank.org): <https://www.worldbank.org/en/country/kosovo/brief/energy-in-kosovo>
- The World Bank (2020).** Energy Efficiency and Renewable Energy Project. Support for Grid Integrated Renewable Energy Generation. The World Bank.
- The World Bank.** (2019). Air Pollution Management in Kosovo. Washington DC: The World Bank.
- The World Bank.** (2019). Energy Efficiency in Kosovo. Retrieved from [www.worldbank.org](http://www.worldbank.org): <https://www.worldbank.org/en/country/kosovo/brief/ee-in-kosovo>



# BIOGRAFI E SHKURTËR E AUTORËVE



**Edison Jakurti** është kandidat për doktoraturë në fushën e ekonomisë në Universitetin e Leipzig-ut, Gjermani. Më herët, ai ka marrë titullin Master i Politikave të Zhvillimit Ndërkombëtar, me përqendrim në Ekonomi të Aplikuar, nga Universiteti Duke, dhe diplomën BSc në lëndët Ekonomi dhe Statistikë, nga R.I.T. Së fundi, ka shërbyer si Zëvendësministër për Ekonomi, Ndërmarrësi dhe Investime Strategjike në Kosovë. Ai gjithashtu ka punuar si asistent kërkimor dhe mësimdhënës në Universitetin Duke, dhe si konsulent në Bankën Botërore në Washington, DC.

**Dita Dobranja** është ekonomiste me ekspertizë në ekonominë e tregut të punës, ekonominë gjinore dhe ekonominë e inovacionit. Dita aktualisht është duke punuar si Eksperte për Zhvillimin Njerëzor në UNICEF në hartimin e Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit të Kosovës. Gjithashtu, në kuadër të shtyllës së UNICEF-it për Monitorimin e të Drejtave të Fëmijëve në Kosovë, ajo punon në zhvillimin e sistemeve të monitorimit dhe vlerësimit të programeve të të rinjve dhe adoleshentëve. Për më tepër, Dita aktualisht ligjëron edhe në fakultetin për Ekonomi në RIT, Kosovë. Para kësaj, Dita ka qenë e angazhuar në kërkime dhe sigurimin e provave empirike për zgjidhjet e politikave në rrafshin ekonomik. Dita ka punuar me organizata ndërkombëtare, si dhe me disa think-tank vendas. Ajo ka përfunduar studimet Master në Ekonomi Ndërkombëtare në Universitetin Amerikan në Washington DC, si përfituese e Bursës së USAID-it për Udhëheqje Transformuese në Kosovë. Dita ka botuar publikime të politikave publike dhe hulumtime akademike, të fokusuara kryesisht në ekonominë e Kosovës dhe tregun e punës. Publikimet më të fundit të politikave përfshijnë analizën e ndikimit të COVID-19 në ekonominë e Kosovës, si dhe ndikimin e pandemisë në tregun e punës në Kosovë.



**Dina Vlasaliu** ka diplomë Bachelor në Arte dhe Shkenca të Aplikuara nga Instituti i Teknologjisë në Rochester, Kosovë dhe diplomë MSc në Ekonominë e Burimeve dhe Politikave nga Universiteti i Maine. Dina e filloi karrierën e saj duke punuar në KOSID si Asistente Hulumtuuese ku ishte e përfshirë në hulumtimin e potencialit të energjisë së ripërtitshme të Kosovës dhe politikave të eficiencës së energjisë. Ajo vazhdoi të punojë si asistente kërkimore dhe asistente e mësimdhënies në Universitetin e Maine nga viti 2016 deri në 2018, duke hulumtuar konsumerizmin e gjelbër dhe faktorët që ndikojnë tek konsumatorët nga Main për të blerë energji të gjelbër dhe për t'u angazhuar në sjellje miqësore me mjedisin.

Dina aktualisht punon si mësimdhënëse në lëndët e Statistikës dhe Ekonomisë, në Shkollën e Mesme të Prishtinës dhe kohë pas kohe jep mësim për testet e standardizuara të TOEFL dhe SAT. Dina ka botuar punimin e saj universitar "Faktorët që ndikojnë në pagesën e faturave të energjisë elektrike në Hajvali"; është autore e "Faktorët që ndikojnë në preferencat e konsumatorëve të Maine për Burimet e Ripërtitshme të Energjisë dhe Masat e Eficiencës së Energjisë" dhe bashkëautore në "Ku po shkojmë pas Marrëveshjes COP-21 në Paris". Ky punim shqyrton pozitën e Kosovës në kuptim të bazës së saj legjislativë dhe pengesave të zbatimit kur bëhet fjalë për përmbushjen e Agjendës së Gjelbër të Parisit 2015. Së fundi, Dina u përfshi në "Efektet ekonomike të COVID-19: Një analizë e sektorit privat në Kosovë" me qëllim të vlerësimit të situatës ekonomike në Kosovë gjatë pandemisë me COVID-19.

**Lule Bahtiri** punon si statisticiante në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës. Ajo ka një diplomë Bachelor në Ekonomi dhe Statistikë nga Instituti i Teknologjisë në Rochester dhe një diplomë Master në Zhvillim Ekonomik nga Universiteti Vanderbilt. Punimet e saj më të fundit përfshijnë një punim hulumtues që mat ndikimin e COVID-19 në sektorin privat në Kosovë, një punim që vlerëson perceptimet e të rinjve kosovarë në lidhje me situatën mjedisore në Kosovë, si dhe një raport të analizës së ndikimit për 800 përfitues të granteve në fushën e bujqësisë, zejtarisë dhe të shërbimeve.

Përvoja e saj e mëparshme e punës përfshinë OJQ-të si dhe sektorin privat. Ajo është gjithashtu e angazhuar si anëtare e bordit për Shoqatën e Alumni të Programit të Leadershipit Transformues.



---

**Mimozë Veliu** është specialiste e asistencës zhvillimore me më shumë se tre vjet përvojë pune në sektorin publik. Ajo përfundoi studimet bachelor në Rochester Institute of Technology, me fokus në ekonomi dhe menaxhim. Në vitin 2016 ajo u zgjodh si një nga përfitueset e bursës Young Cell Scheme përmes së cilës ajo ndoqi masterin në studimet e zhvillimit në Universitetin Sussex. Fushat e saj të interesit përfshijnë mjedisin dhe energjinë. Përveç përvojës së saj në sektorin publik, Mimoza ka punuar edhe me OJQ të ndryshme dhe ka shërbyer si kryetare e European Young Cell Scheme Association. Aktualisht ajo mban pozitën e Zyrtares për Asistencë Zhvillimore, në Zyrën e Kryeministrit.





## PERSPEKTIVA E PËRGJITHSHME: AGJENDA EKONOMIKE PROGRESIVE PËR KOSOVËN



Një sistem dual dhe krijimi i këshillave për shkathtësi sektoriale mund të përmirësojë mospërshtatjet aktuale në tregun e punës dhe mungesa e bashkëpunimit në mes të sektorit privat dhe atij publik për adresimin e këtyre mangësive. Themelimi i sindikatave të punës dhe të punëtorëve në sektorin privat, e përmirëson dialogun social dhe i përmirëson të drejtat e punëtorëve. Korniza ligjore për rregullimin e tregut të punës ka nevojë që të sigurojë punë fleksibile, punë të përkohshme, si dhe punë të përbashkët, në profesionet ku kjo është e mundur, si skemat për rritjen e punësimit dhe përmirësimin të pjesëmarrjes, në veçanti të të rinjve dhe grave. Përmes mbledhjes së synuar të të dhënave, qeveria mund t'i identifikojë sektorët me potencial zhvillimor dhe për krijimin e kapaciteteve për krijimin e vendeve të punës.



Për të kompletuar me sukses tranzicionin në sektorin e energjisë, Kosova duhet të sigurojë që barra për këtë të ndahet në mënyrë të barabartë, dhe të merren parasysh nevojat e grupeve dhe komuniteteve të cënueshme. Definicionit të kombinimit të ardhshëm të burimeve të energjisë duhet t'i paraprijë një analizë teknike dhe financiare rigoroze. Mbështetja përmes intervenimeve të politikave duhet t'u ofrohet kompanive të BRE-ve nga sektori privat, me qëllim të përmirësimit të përparësive të tyre krahasuese. Kjo mbështetje mund të ofrohet në formë të stimujve financiarë ose ndërhyrjeve përmes politikave, si themelimit të qendrave për inovacion me qëllim të stimulimit të zhvillimit të ndërmarrësisë në këtë sektor.